Konrad Adenauer Stiftung

IDSCS | Institute for Democracy Societas Civilis -Skopje



# MANUAL PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2016

EDICIONI I DYTË I PËRDITËSUAR

POLITIKË

# MANUAL PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2016

EDICIONI I DYTË I PËRDITËSUAR

# Impresum:

**Titulli:**

Manual për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2016

**Editor:**

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë
Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup

**Autor:**

Hristina Veljanova

**Koordinimi:**

Davor Pashoski

Johannes D. Rey

**Përkthimi:**

Blerina Starova Zllatku

**Diesejni dhe përgatitja:**

Vinsent Grafika

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

http://www.kas.de/mazedonien/mk
http://www.idscs.org.mk

**Vërejtje:**

**Qëndrimet e prezantuara në këtë publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Institutit për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, por janë pikëpamje personale të autorit.**

# Përmbajtja:


**1. Hyrje në Zgjedhjet Parlamentare 2016 — 6**
- Përgatitjet për zgjedhjet e parakohshme parlamentare — 12
- Ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor — 14

**2. Historiku i zgjedhjeve parlamentare në Maqedoni (1990 – 2014) — 20**
- Zgjedhjet parlamentare të vitit 1990 — 21
- Zgjedhjet parlamentare të vitit 1994 — 23
- Zgjedhjet parlamentare të vitit 1998 — 25
- Zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 — 26
- Zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 — 28
- Zgjedhjet parlamentare të vitit 2008 — 30
- Zgjedhjet parlamentare të vitit 2011 — 32
- Zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 — 34
- Jehona e zgjedhjeve parlamentare (1990 – 2014) — 37

**3. Sistemi zgjedhor i republikës së Maqedonisë për zgjedhje parlamentare — 38**
- Organe zgjedhore — 41
- E drejta e zgjedhjes aktive dhe pasive, procedura e paraqitjes së kandidaturave — 43
- Kufizimi i funksionarëve aktualë — 46
- Fushata zgjedhore — 48
- Roli i mediave publike — 50
- Vëzhgimi i zgjedhjeve — 53

**4. Njësitë zgjedhore — 54**

**5. Pasqyra e pjesëmarrësve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2016 — 62**
- VMRO-DPMNE — 64
- Partia Demokratike Shqiptare — 69
- Bashkimi Demokratik për Integrim — 72
- Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë — 75
- Koalicioni për ndryshime dhe drejtësi – blloku i tretë (Lidhja Demokratike, FRODEM, DEMOS DHE MORO-PP) — 80
- Partia për Prosperitet Demokratik — 81
- Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët” (LR-PDSH, Uniteti, RDK) — 82
- Partia Liberale — 83
- Koalicioni VMRO për Maqedoninë — 84
- Lëvizja BESA — 85
- Levica — 86

**6. Zgjedhje të parakohshme parlamentare në republikën e maqedonisë 2016 – rezultate, fushata, vlerësime — 88**
- Hyrje — 89
- Fushata zgjedhore — 90
- Financimi i fushatës zgjedhore — 97
- Mediat — 101
- Rezultatet e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të vitit 2016 — 114
- Mbrojtja e të drejtës së zgjedhjes — 118
- Vlerësimi i zgjedhjeve nga vëzhguesit — 121
- Vlerësimi i zgjedhjeve nga partitë politike — 126
- Konkluzione — 130

**7. Arkivi Zgjedhor i zgjedhjeve në Maqedoni nga viti 1990 deri më sot — 134**

**8. Burime — 138**

# HYRJE NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2016

## HYRJE NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2016

Zgjedhjet parlamentare të tetat me radhë nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë, ndërsa zgjedhjet e parakohshme të katërta me radhë, do të mbahen më datë 11 dhjetor 2016. Më datë 17 tetor 2016, në seancën e 125-të, me 110 vota "PRO", me asnjë votë "Kundër" ose "Abstenim", Kuvendi e miratoi njëzëri vendimin për shpërndarjen e Kuvendit. Ditën e ardhshme, më datë 18 tetor, kryetari i Kuvendit, Trajko Veljanoski, në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore i shpalli zgjedhjet[1]. Këto zgjedhje të parakohshme parlamentare do të organizohet në gjashtë njësi zgjedhore (NJZ) në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në një njësi zgjedhore (NJZ 7) jashtë vendit, e cila i përfshinë të gjithë shtetasit maqedonas të cilët jetojnë jashtë shtetit. Në përfaqësitë diplomatike konsullore (PDK) të Republikës së Maqedonisë votimi do të mbahet një ditë më herët, përkatësisht më datë 10 dhjetor 2016.

Këtyre zgjedhjeve u parapriu një periudhë turbulente dhe dinamike përplot me kthesa, ngjarje dhe tensione politike. Kriza politike, e cila e përfshiu Maqedoninë viteve të fundit, kulminoi në vitin 2015 me "aferën e përgjimeve"[2]. Kjo ishte baza për një sërë ngjarjesh dhe protesta masive të cilat në mënyrë plotësuese kontribuuan në drejtim të destabilizimit të gjendjes edhe ashtu sensitive politike. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Përzhinos[3] më 2 qershor dhe të Protokollit më 15

---

1 Vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Vendimi është shkarkuar nga faqja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/predvremeni-izbori-za-pratenici-2016/ (vizita e fundit: 7 nëntor 2016).

2 Në muajin shkurt të vitit 2015 partia më e madhe opozitare LSDM filloi të publikojë biseda të përgjuara nga vitet e kaluara (në publikë të njohura si "bomba") për të cilat pohonte se kinse e vënë në dukje përfshirjen e nëpunësve të lartë qeveritarë dhe nëpunësve publikë në mashtrime zgjedhore, korrupsion, abuzim të pushtetit, presion mbi mediat. Kryetari i LSDM Zoran Zaev vuri në dukje se bëhet fjalë për më shumë se 20. 000 qytetarë të përgjuar në mënyrë të paligjshme. Sa i përket këtij numri, më 18 nëntor të vitit 2016 Prokuroria Speciale Publike në një konferencë për shtyp njoftoi se ka në dispozicion materiale dhe prova të cilat vënë në dukje se në periudhën kohore prej vitit 2008 deri në vitin 2015 në mënyrë të drejtpërdrejt janë përgjuar më së paku 5.827 numra telefonik. Për më shumë informacione shih: www.jonsk.mk/2016/11/18/deklaratë nga pres-konferenca (vizita e fundit: 22 nëntor 2016).

3 Shih: Marrëveshja e Përzhinos. E aksesshme në: http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_agreement.pdf dhe Protokolli. I akseshëm në: http://europa.eu/rapid/press-release_STATEMENT-15-5372_en.htm (vizita e fundit: 7 nëntor 2016).

korrik 2015 patën për qëllim zgjidhjen e krizës politike.[4] Marrëveshja u nënshkrua nga katër partitë më të mëdha politike – Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) dhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), ndërkaq me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të Komisionit Evropian, të Parlamentit Evropian dhe SHBA. Njëra nga masat e parashikuara me Marrëveshjen ishte edhe mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, fillimisht të caktuara për 24 prill 2016. Si pjesë e Marrëveshjes, më 11 nëntor 2015 u formua Qeveria kalimtare, ndërsa më 15 janar të vitit 2016 Kryeministri i atëhershëm Nikolla Gruevski dha dorëheqje. Në pozitën e Kryeministrit u caktua Sekretari i Përgjithshëm i VMRO-DPMNE, Emill Dimitriev, i cili në njëqind ditët deri në zgjedhje duhej të ishte në krye të Qeverisë. Megjithatë, në janar të vitit 2016, LSDM paralajmëroi se nuk do të merr pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, ndërsa si shkak u theksua mospërmbushja e kushteve të Marrëveshjes së Përzhinos, veçanërisht mosazhurnimi i Listët së Zgjedhësve dhe pjesa e reformave në media.[5] Konform Marrëveshjes së Përzhinos, BE dhe SHBA datën 20 shkurt e caktuan si afat brenda të cilës do të vlerësohet se sa janë përmbushur kushtet e mbajtjes së zgjedhjeve të besueshme më 24 prill.[6] Midis kushteve të parashikuara ishte pastrimi i Listës së Zgjedhësve, reformat në media, ndarja e shtetit nga aktivitetet partiake. Pas skadimit të këtij afati, ambasadorët e BE dhe SHBA në Maqedoni para publikut dolën me qëndrim se edhe përkrah asaj që është arritur një progres i caktuar, megjithatë, nuk ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve kredibile.[7] Rrethanat e këtilla rezultuan me shtyrjen e

---

4 Me Marrëveshjen e Përzhinos dhe Protokollin u parashikua një spektër i gjerë masash për zgjidhjen e krizës politike, në mesin e të cilave emërimi i përbërjes së re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, kthimi i LSDM në Kuvend, formimi i Prokurorisë Speciale Publike për shqyrtimin e regjistrimeve të përgjuara, formimi i "Qeverisë kalimtare" në të cilën do të përfshihen edhe ministrat dhe zëvendësministrat e caktuar nga LSDM dhe dorëheqja e Kryeministrit. LSDM me këtë Marrëveshje e fitoi pozitën e ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit për Punë dhe Politikë Sociale dhe të zëvendësministrave në resorin e Bujqësisë dhe Financave.

5 "LSDM – Bojkot në 24 prill dhe datë e re për zgjedhje", Radio Evropa e Lirë, 20 janar 2016. I aksesshëm në: http://www.slobodnaevropa.mk/a/27499957.html (vizita e fundit: 14 tetor 2016)

6 BE dhe SHBA e përcaktuan afatin: deri më 20 shkurt do ta bëjnë vlerësimin se a ka kushte për zgjedhje, Telegraf, 29 janar 2016. I aksesshëm në: http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-340495-eu-i-sad-si-zadadoa-rok-do-20-fevruari-ke-ocenuvaat-dali-ima-uslovi-za-izbori.nspx (vizita e fundit: 21 nëntor 2016).

7 BE dhe SHBA me vlerësim, nuk ka kushte për zgjedhje më 24 prill, 24 Vesti, 21 shkurt 2016. I aksesshëm në: http://24vesti.mk/eu-i-sad-so-procenka-nema-uslovi-za-izbori-na-24-april (vizita e fundit: 14 tetor 2016).



zgjedhjeve dhe me ndryshimin e vendimit sipas të cilit Kuvendi duhej të shpërndahej më 18 janar të vitit 2016. Më datë 23 shkurt, Kuvendi e miratoi kërkesën e BDI-së për shtyrjen e shpërndarjes së Kuvendit, me ç'rast kryetari i Kuvendit, Trajko Veljanoski, më 15 prill edhe zyrtarisht i ricaktoi zgjedhjet për 5 qershor të vitit 2016.[8]

Së këtejmi, data e caktuar e re duhej të ofronte kohë plotësuese për tejkalimin e sfidave ekzistuese, por, ngjarjet të cilat pasuan në mënyrë plotësuese e vështirësuan atmosferën politike. Para ricaktimit zyrtar të zgjedhjeve, më 9 prill, LSDM dhe 17 parti më të vogla politike e nënshkruan platformën për Maqedoni Demokratike me të cilën përsëri u theksuan parakushtet e nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve të drejta, të ndershme dhe demokratike, megjithatë u paralajmërua edhe bojkotimi i zgjedhjeve.[9] Disa ditë pas kësaj, Presidenti Gjorge Ivanov mori vendim t'u bëjë abolicion[10] 56 personave prej të cilëve një pjesë politikanë të lartë nga pushteti dhe opozita të përfshirë në aferën e përgjimit. Vendimi shkaktoi një sërë protestash dhe kundër-protestash në periudhën në vijim. Njëri grup i protestuesve të organizuar me iniciativën "Protestoj" kërkonin dorëheqje nga Presidenti dhe shtyrje të zgjedhjeve, ndërsa grupi tjetër, i bashkuar nga LQMM (Lëvizja Qytetare për Mbrojtjen e Maqedonisë) e mbështesnin qëndrimin e Qeverisë dhe idenë për mbajtjen e zgjedhjeve më datë 5 qershor. Në periudhën që pasoi, dy partitë më të mëdha politike dhe nënshkruese të Marrëveshjes së Përzhinos edhe më tutje kishin divergjenca në qëndrimet e tyre lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve të cilat u ricaktuan për 5 qershor të vitit 2016. VMRO-DPMNE e mbante qëndrim se zgjedhjet e parakohshme

---

8 Me 83 vota "PRO", 3 vota "Kundër" dhe asnjë "Abstenim", VMRO-DPMNE, BDI dhe PDSH i votuan ndryshimet e Kodit Zgjedhor me të cilat u përcaktua datë e re e zgjedhjeve, 5 qershori, dhe shpërndarja e Kuvendit më 7 prill. LSDM nuk mori pjesë në këtë seancë.

9 Partitë opozitare nënshkruan Platformë për Maqedoni Demokratike, Telegraf, 9 prill 2016. I aksesshëm në: http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-opoziciskite-partii-potpisaa-platforma-za-demokratska-makedonija.nspx (vizita e fundit: 10 nëntor 2016).

10 Më 12 prill, Presidenti Ivanov mori vendim për abolicion me të cilin u përfshinë 56 persona në mesin e të cilëve politikanë të rëndësishëm, duke i përfshirë edhe liderët e VMRO-DPMNE dhe LSDM-së, ish funksionarë qeveritarë, kryetarë të komunave, gjyqtarë, nëpunës, drejtorë. Pas këtij vendimi pasuan reagime të shumta dhe presion nga publiku vendor por edhe nga bashkësia ndërkombëtare, me ç'rast më 27 maj, Presidenti Ivanov vendosi pjesërisht ta revokoj abolicionin, përkatësisht ta revokojë faljen e 22 politikanëve të cilëve u kishte bërë abolicion, ndërsa 34 personave të tjerë të cilëve u kishte bërë abolicion të cilët nuk janë eksponentë politikë iu dha mundësia që ata vet të paraqesin kërkesë për revokimin e abolicionit. Dhjetë ditë më vonë, më 6 qershor, Presidenti Ivanov e revokoi tërësisht abolicionin pasi që asnjëri nga personat e tjerë nuk kërkuan revokim të vendimit.

janë çelësi për dalje nga kriza e gjatë politike. LSDM konsideronte se është i nevojshëm zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Përzhinos, si garanci e vetme për mbajtjen e zgjedhjeve të ndershme dhe kredibile. Meqë kushtet e Marrëveshjes nuk u plotësuan, LSDM e mbajti qëndrimin e vet për t'i bojkotuar zgjedhjet, ndërsa BDI dhe PDSH dolën me qëndrim se janë të pranueshme vetëm zgjedhje inkluzive në të cilat do të merrnin pjesë të gjitha partitë politike.[11] Pas përpjekjeve të pasuksesshme që partitë të arrijnë marrëveshje, më 11 maj VMRO-DPMNE e vetmja nga katër partitë nënshkruese të Marrëveshjes së Përzhinos paraqiti lista të kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje. LSDM, BDI dhe PDSH u tërhoqën dhe nuk paraqitën lista të tyre. Mundësia për mbajtjen e zgjedhjeve vetëm me një parti është në kundërthënie me vet konceptin e pluralizmit politik dhe pas kësaj më 16 maj erdhi kritika e Komisionit Evropian për mosekzistimin e kushteve minimale për mbajtjen e zgjedhjeve të besueshme dhe demokratike më 5 qershor.[12] Ngjarjet e këtilla kulminuan me nismën e BDI-së të paraqitur më 15 maj, e cila kishte për qëllim të rishikohet aspekti kushtetues i vendimit për shpërndarjen e Kuvendit, me ç'rast më 18 maj, Gjykata Kushtetuese miratoi masë të përkohshme për ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve zgjedhore deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Po atë ditë, kryetari i Kuvendit Veljanoski caktoi seancë, e thirri përbërjen paraprake dhe pas kësaj pasoi ndryshimi i Kodit Zgjedhor, me të cilin 5 qershori u fshi si datë e zgjedhjeve.[13] Një datë e mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve të ardhshme nuk u caktua. Menjëherë pas kësaj, më 25 maj, Gjykata Kushtetuese e miratoi vendimin përfundimtar në lidhje me nismën e BDI-së, me të cilën shpërndarja e Kuvendit u shpall si jokushtetuese. Në Kuvend u kthye Qeveria në përbërjen si para Marrëveshjes së Përzhinos, me ç'rast kjo nënkuptonte kthim në pozitë fillestare dhe një valë të re të negociatave dhe përplasjeve ndërpartiake.[14]

11 Raporti përfundimtar, Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare të caktuara për 5 Qershor 2016, Zyra për Institucione Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut, 8 korrik 2016, f. 6. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/253996?download=true (vizita e fundit: 10 nëntor 2016).

12 Bruksel: Nuk ka as kushte minimale për zgjedhje më 5 qershor, Dojçe Vele 16 maj të vitit 2016. I aksesshëm në: www.dw.com/mk/брисел-нема-ни-минимум-услови-за-избори-на-5-јуни/a-19260597 (vizita e fundit: 10 nëntor 2016).

13 Të gjithë deputetët e pranishëm e mbështetën këtë vendim me përjashtim të PDSH e cila nuk mori pjesë në aktin e votimit.

14 Kuvendi vendosi – nuk ka zgjedhje më 5 qershor, 24 Vesti, 18 maj 2016. I aksesshëm në: http://24vesti.mk/sobranieto-odluchi-nema-izbori-na-5-juni (vizita e fundit: 10 nëntor 2016).

Pas dy përpjekjeve të pasuksesshme për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016, muajt e ardhshëm kaluan në shenjën e negociatave të mëtutjeshme midis liderëve të katër partive më të mëdha politike në Republikën e Maqedonisë, me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të BE dhe SHBA në Maqedoni, me qëllim të daljes nga kriza politike dhe gjetjes së zgjidhjes për çështjet kontestuese. Në agjendë edhe më tutje ishin çështjet për pastrimin e Listës së Zgjedhësve, Qeverinë kalimtare dhe për reformimin e mediave, si kushte kryesore për zgjedhje të ndershme dhe demokratike. Më datë 20 korrik, këto përpjekje rezultuan me sukses dhe me arritje të Marrëveshjes, të ashtuquajtur Përzhino 2[15] me të cilën, mes tjerash, ranë dakord të zgjidhet çështja me votuesit kontestues të Listës së Zgjedhësve, kthimin e ministrave dhe zëvendësministrave shtesë nga opozita në "Qeverinë kalimtare", formimin e autoritetit ad-hok i cili do të bëjë monitorim mbi mediat dhe raportimin në periudhën parazgjedhore, si dhe për çështjen e kompetencave të ministrit të Punëve të Brendshme. Pas votimit në Kuvend të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve, të cilët rezultuan nga Aneks Marrëveshja e fundit e Përzhinos (Përzhino 2), më 31 gusht u mbajt edhe një takim i liderëve në të cilin u konstatua se është plotësuar ajo për të cilën paraprakisht kanë rënë dakord dhe u caktua data për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor.[16]

Megjithatë, edhe periudha pas caktimit të datës për zgjedhje u përcoll me ngjarje të caktuara. Çështja e numrit joproporcional të votuesve në njësitë zgjedhore dhe iniciativa për rikonfiguracionin e njësive zgjedhore ishte njëra nga çështjet më aktuale. Me fjalë të tjera, tek një pjesë e qytetarëve mbizotëronte qëndrimi se moszgjidhja e kësaj çështjeje mund ta vë në pikëpyetje legjitimitetin dhe ligjshmërinë e zgjedhjeve, dhe së këtejmi mund të shfrytëzohet si alibi nga ndonjëra prej partive e cila do të ishte e pakënaqur me rezultatet e zgjedhjeve

15 Marrëveshje midis katër partive politike nga 20 korriku 2016. E aksesshme në: http://eeas.europa.eu/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/press_corner/all_news/news/2016/2016-07-20_agreement_en.htm (vizita e fundit: 10 nëntor 2016).

16 Më datë 31 gusht u mbajt takimi i liderëve të katër partive më të mëdha politike në të cilin në fokus ishte çështja se a ekzistojnë kushte për mbajtjen e zgjedhjeve në dhjetor. Në këtë takim, liderët ranë dakord për datën e zgjedhjeve të parakohshme – 11 dhjetor, si dhe për masa të tjera plotësuese të cilat rezultojnë nga Marrëveshja e Përzhinos.

që zgjedhjet t'i shpall për jolegjitime.[17] Një debat plotësues nxiti edhe shtyrja e datës së shpërndarjes së Kuvendit, fillimisht e planifikuar për 12 tetor, 60 ditë para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Shkaku i shtyrjes së këtillë ishte mosmiratimi i projekt-buxhetit për vitin 2017. Në ndërkohë, më 12 tetor, LSDM paraqiti kërkesë urgjente për shpërndarjen e Kuvendit e cila u kushtëzua nga VMRO-DPMNE me miratimin e Buxhetit për vitit 2017. Më datë 17 tetor u miratua Buxheti me procedurë të shkurtuar dhe me këtë u hap rruga për miratimin e vendimit për shpërndarjen e Kuvendit, i cili zyrtarisht u miratua më 18 tetor. Megjithatë, edhe pas miratimit të vendimit, situata nuk u qetësua. Partia Uniteti paraqiti një nismë në Gjykatën Kushtetuese me të cilën kontestohet vendimi për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Shkaku i paraqitjes së kësaj nisme ishte mosbalancimi i njësive zgjedhore, përkatësisht numri më i madh i votuesve nga numri i parashikuar në njësinë e gjashtë zgjedhore.[18] Gjykata Kushtetuese akoma nuk është prononcuar për këtë çështje.

## PËRGATITJET PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE

Më datë 18 tetor, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) e miratoi Agjendën për realizimin e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Kuvend.[19] Konform Agjendës, tre ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, përkatësisht më 21 dhjetor, KSHZ paraqiti kërkesë deri te Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratë (MSHIA) për tua dërguar të dhënat e të punësuarve në administratën shtetërore dhe komunale, në administratën e Qytetit të Shkupit dhe në administratën publike, të cilat MSHIA ia dërgoi KSHZ-së më së voni deri më 26 tetor, pesë ditë nga dita e pranimit të kërkesës. Pastaj, në bazë të atyre të dhënave, më së voni deri më

[17] Të gjitha partitë kanë alibi për humbje në zgjedhje, Radio Evropa e Lirë, 18 tetor 2016. I aksessshëm në: http://www.slobodnaevropa.mk/a/28060549.html (vizita e fundit: 10 nëntor 2016).

[18] Uniteti i kontestoi zgjedhjet pra Gjykatës Kushtetuese, Dojçe Vele, 25 tetor 2016. I aksesshëm në: www.dw.com/mk/унитети-ги-оспори-изборите-пред-уставен-суд/a-36148913open_in_new (vizita e fundit: 11 nëntor 2016).

[19] Agjenda për realizimin e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, 18 tetor – 11 dhjetor 2016 – tekst i spastruar. I aksesshëm në:https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zMHFRVlZOQWdHbTg/view (vizita e fundit: 11 nëntor 2016).



31 tetor KSHZ i formoi, përkatësisht i plotësoi komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) me anëtarë të ri në vendet e atyre të cilëve u ka pushuar mandati. Gjithashtu, më së voni deri më 3 nëntor, tre ditë nga formimi i KKZ, KSHZ deri te KKZ i dërgoi të dhënat për të punësuarit në administratën shtetërore dhe komunale, në administratën e Qytetit të Shkupit dhe administratën publike me vendbanim në territorin në juridiksion të KKZ, me qëllim të formimit, përkatësisht plotësimit të këshillave zgjedhorë (KZ) me anëtarë të rinj në vendet e atyre të cilëve iu ka pushuar mandati. Si plotësim të kësaj, deri më 2 nëntor KSHZ dërgoi kërkesë deri te partitë politike në opozitë dhe pozitë, me numër më të madh të votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare, të paraqesin propozime të anëtarëve të KZ dhe zëvendësve të tyre me qëllim të formimit, përkatësisht plotësimit të KZ. Partitë e kishin për detyrë më së voni deri më 7 nëntor, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të të dhënave nga KSHZ t'i paraqesin, përkatësisht dërgojnë propozimet e tyre në KKZ, të cilët pastaj, në bazë të të dhënave të pranuara i formuan KZ-të. Sa i përket zbatimit të votimit jashtë vendit, afati i formimit të KZ ishte 8 nëntori.

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, 10 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve KSHZ e vë në këqyrje publike Listën e Zgjedhësve në faqen e saj të internetit http://izbirackispisok.gov.mk, në njësitë e veta rajonale dhe në zyrat e vendit, si dhe në PDK. Për këto zgjedhje, këqyrja në Listën e Zgjedhësve zgjati nga 28 tetori deri më 11 nëntor. Në afat prej 5 ditësh pas përfundimit të këqyrjes, më së voni deri më 16 nëntor, KSHZ-ja ua dërgon partive politike Listën e Zgjedhësve, të cilat pastaj në afat prej 5 ditësh, deri më datën 21 nëntor, mund të paraqesin kërkesa për regjistrime, plotësime ose shlyerjen e të dhënave. Komisioni për kërkesat vendos në afat prej 3 ditësh, më së voni deri më 24 nëntor. Dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, më 1 dhjetor, KSHZ e nënshkruan Listën përfundimtare të Zgjedhësve.

Sipas afateve të përcaktuara ligjore dhe sipas Agjendës së KSHZ-së për zbatimin e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2016, fushata zgjedhore për këto zgjedhje do të zgjas nga 21 nëntori deri më 9 dhjetor të vitit 2016. Data e 10 dhjetorit është dita e heshtjes zgjedhore.

Sipas Agjendës, raportet financiare të organizatorëve të fushatës zgjedhore paraqiten në KSHZ, Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), në afatet si vijojnë:

- më 1 dhjetor për të ardhurat dhe shpenzimet në 10 ditët e para të fushatës;
- më 10 dhjetor për të ardhurat dhe shpenzimet në gjysmën e dytë të fushatës;
- raportet financiare përfundimtare paraqiten menjëherë, ndërsa më së voni deri në 30 ditë nga mbyllja e llogarive të transaksionit dhe shpallen publikisht në ueb-faqen e KSHZ, ESHT dhe KSHPK;
- radiodifuzerët dhe mediat e shkruara në Republikën e Maqedonisë e kanë për detyrë të paraqesin raport për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar nga secili prej pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore edhe atë jo më vonë se 15 ditë pas ditës së përfundimit të fushatës zgjedhore.

Sa i përket vëzhgimit të zgjedhjeve, sipas Agjendës, paraqitja e kërkesave për vëzhgim në KSHZ fillon më 18 tetor dhe zgjatë deri më 6 dhjetor, përkatësisht më së voni 5 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. Më së voni 2 ditë pas pranimit të kërkesës, KSHZ u lëshon autorizim vëzhguesve.

## NDRYSHIMET E FUNDIT TË LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR

Ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor rezultuan si pjesë e Marrëveshjes së Përzhinos. Në seancën e 75 Kuvendi, me procedurë të shkurtuar, e miratoi pakon e ligjeve përfshirë edhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, [20] të cilat rezultojnë nga Marrëveshja e Përzhinos dhe nga takimi i liderëve, ndërsa kanë për qëllim krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të ndershme dhe legjitime. Këto ndryshime u referohen aspekteve thelbësore të procesit zgjedhor, si vijon:

[20] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 196 nga 10 nëntori 2015. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/63cc34eb402342698f7e82e59629175a.pdf (vizita e fundit: 11 nëntor 2016).

- Modeli zgjedhor me gjashtë njësi zgjedhore në territorin e Republikës së Maqedonisë mbetet i pandryshueshëm. Ndryshim ka në njësitë zgjedhore të diasporës, me ç'rast tri njësitë zgjedhore të deritanishme (NJZ 7, NJZ 8 dhe NJZ 9) u zëvendësuan me një njësi zgjedhore – NJZ 7, e cila i përfshinë të gjithë shtetasit maqedonas të cilët jetojnë në Evropë, Azi, Afrikë, Amerikën Veriore dhe Jugore dhe Australi. Deputetët në NJZ 7 do të zgjidhen sipas modelit proporcional. Kjo nënkupton se numri i nevojshëm i votave që të zgjidhet një deputet në NJZ 7 duhet të korrespondojë me minimumin e votave të cilat i ka fituar deputeti i cili është zgjedhur me numër më të vogël të votave në ndonjërën nga njësitë zgjedhore në zgjedhjet paraprake parlamentare.

- Ndalohet përdorimi i hapësirave të zyrave, pajisjes dhe automjeteve zyrtare të organeve shtetërore për nevojat e fushatës zgjedhore, përveç nëse ndryshe nuk është përcaktuar me ndonjë akt tjetër.

- Si pjesë e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor u parashikua edhe Kodeksi për zgjedhje të ndershme dhe demokratike21, i cili do të nënshkruhet nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje nga dita e shpalljes së zgjedhjeve. Me këtë Kodeks pjesëmarrësit obligohen të mos bëjnë presione mbi të punësuarit në administratën publike shtetërore ose në institucione të tjera të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Veç tjerash, Kodeksi ka për qëllim të garantoj se mbështetja, përkatësisht mosmbështetja të cilësdo qoftë partie ose të kandidatit nga ana e qytetarëve, pjesëmarrësve në procesin zgjedhor nuk do ta shfrytëzojnë si instrument për kërcënim lidhur me vendin e punës ose me sigurinë sociale.

- Përbërja e KSHZ u ndryshua, nga shtatë anëtarët paraprak në nëntë anëtarë. Në këtë përbërje bëjnë pjesë: kryetari, nënkryetari dhe 7 anëtarë. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KSHZ u ndryshua. Me ndryshimet e reja tre anëtarë propozojnë partitë politike në pushtet, me ç'rast partia në pushtet me numër

[21] Kodeksi për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, nëntor 2016. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zTGdoMmZIZjV4UkE/view (vizita e fundit: 21 nëntor 2016).

më të madh të deputetëve në Kuvend propozon dy anëtarë, ndërsa partia e dytë, sipas numrit të deputetëve në pozitë, propozon një anëtar. Partitë e opozitës propozojnë tre anëtarë, me ç'rast partia opozitare me numër më të madh të deputetëve në Kuvend propozon dy anëtarë, ndërsa partia opozitare e dytë për nga madhësia e numrit të deputetëve propozon një anëtar. Tre anëtarë do të zgjidhen përmes konsensusit, të cilët do ta përfaqësojnë publikun ekspert. Me ndryshimet u instalua edhe funksioni Sekretar i Përgjithshëm i KSHZ i cili ka për qëllim përforcimin e pjesës administrative. Sekretari i Përgjithshëm nuk është pjesë e përbërjes së KSHZ dhe nuk ka të drejtë vote.

- Ndryshimet plotësuese të Kodit Zgjedhor përfshijnë dispozita që kanë të bëjnë me Listën e Zgjedhësve. KSHZ u përcaktua si institucioni i vetëm kompetent për udhëheqjen dhe azhurnimin e Listës së Zgjedhësve. KSHZ siguron qasje elektronike deri te Lista e Zgjedhësve në përputhje me aktet normative. KSHZ e publikon Listën e Zgjedhësve në ueb faqen e vet, me ç'rast çdo qytetar ka të drejtë të paraqes kërkesë në KSHZ që adresa e tij të mos shpallet publikisht për shkaqe sigurie. KSHZ e bën azhurnimin e Listës së Zgjedhësve një herë në muaj, ndërsa në çdo 6 muaj shpall thirrje publike deri te qytetarët që të bëjnë këqyrje në të dhënat e tyre. Veç tjerash, me qëllim të përcaktimit të autenticitetit të Listës së Zgjedhësve, çdo anëtar i KSHZ mund të kërkoj të bëhet këqyrje në evidencën e MPB për lëshimin e dokumenteve biometrike, si dhe në bazat e të dhënave dhe në evidencat e qytetarëve të organeve dhe institucioneve tjera shtetërore. KSHZ miraton Rregullore për metodologjinë e udhëheqjes dhe azhurnimit të Listës së Zgjedhësve të bazuar mbi kontrolle dhe analiza statistikore, kontrolle të kryqëzuara të bazave të ndryshme të të dhënave dhe evidencave, kontrolle të pakufizuara në terren dhe metoda të tjera të njohura të kontrolleve, si dhe Rregullore për metodologjinë e qasjes së plotë, kryerjes së ndryshimeve dhe shlyerjes së të dhënave në Listën e Zgjedhësve, si dhe procedurë për zbatimin e kontrolleve në terren, me qëllim të azhurnimit të të njëjtës.

- Ndryshimet e Kodit Zgjedhor parashikojnë edhe rritje të përqindjes së përfaqësimit të gjinisë më pak të përfaqësuar në listat e paraqitura për kandidatë dhe deputetë, nga 33% aktual parashikohet rritje në 40%, përkatësisht në tre vendet e para më së paku një vend i takon gjinisë më pak të përfaqësuar dhe në mënyrë plotësuese edhe më së paku një vend në çdo dhjetë vende.

- Në kategorinë e prezantimit mediatik, me ndryshimet e Kodit Zgjedhor për herë të parë përfshihen edhe mediat elektronike (portalet e internetit), të cilat si edhe radiodifuzerët dhe mediat e shkruara të cilat e mbulojnë procesin zgjedhor e kanë për detyrë të punojnë në përputhje me Kodin Zgjedhor. Gjithashtu, ndalohet financimi dhe donimi i partive politike nga mediat dhe personat të lidhur me ata, si dhe inkorporohet ndalim për transmetimin e reklamave të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor fokusi u vu mbi mundësimin e qasjes së barabartë dhe të balancuar të partive politike në hapësirën reklamuese.

Pas shtyrjes së zgjedhjeve të planifikuara të parakohshme parlamentare të 5 qershorit, ndërkaq si pjesë e raundit të ri të negociatave ndërpartiake, më 20 korrik, katër partitë më të mëdha politike arritën marrëveshje të re, Aneks të Marrëveshjes së Përzhinos (Përzhino 2), me të cilën, mes tjerash, u parashikuan ndryshime edhe në Kodin Zgjedhor. Më 28 korrik u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor22. Ndryshimet e këtij Kodi kryesisht kanë të bëjnë me reformat e mediave:

- Formimi i autoritetit ad-hok në kuadër të Agjencisë për Shërbime Meidatike Audio dhe Audiovizive, përkatësisht formimi i Komisionit të Përkohshëm Pesë-anëtarësh për monitorimin e përfaqësimit mediatik ka për qëllim monitorimin e raportimit mediatik në periudhën parazgjedhore. Mandati i këtij Komisioni do të zgjas deri në përfundimin e procesit zgjedhor.

[22] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142 nga 1 gushti 2016. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 11 nëntor 2016).

- Caktimi i redaktorit të ri të programit informativ të Servisit Publik Radiodifuziv. Redaktori do të zgjidhet me propozim të partisë opozitare me numër më të madh të deputetëve në Kuvend, ndërkaq sipas konsultimit paraprak me dy partitë politike në pushtet me numër më të madh të deputetëve në Kuvend dhe me partinë politike në opozitë e cila është parti e dytë opozitare për nga numri i deputetëve në Kuvend.

# HISTORIKU I ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË MAQEDONI (1990 – 2014)

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 1990[23]

Me instalimin e pluralizmit politik në vitin 1989 u mundësua formimi i partive politike, me ç'rast në vitin 1990 votuesit maqedonas në Republikën e atëhershme Socialiste të Maqedonisë (RSM) për herë të parë patën mundësi të votojnë në zgjedhje shumëpartiake.[24] Njëkohësisht ato ishin zgjedhjet e para të lira shumëpartiake të cilat, gjatë vitit të njëjtë, u zhvilluan në të gjitha gjashtë republikat e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (SFRJ). Zgjedhjet u organizuan në një atmosferë në të cilën tanimë shihej fillimi i shpërbërjes së Federatës dhe së këtejmi procesi i zgjedhjeve, në shumicën e republikave, rezultoi me fitoren e partive të sapoformuara kombëtare mbi partitë të cilat lindën nga degët republikane të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Në Maqedoni zgjedhjet u zhvilluan sipas sistemit zgjedhor mazhoritar, në dy rrethe zgjedhore, në nivel të 120 njësive zgjedhore. Në zgjedhjet e para morën pjesë 18 parti politike dhe 43 kandidatë të pavarur. Në disa nga njësitë zgjedhore partitë morën pjesë në mënyrë të pavarur, por në disa njësi të tjera formuan koalicione parazgjedhore, me ç'rast propozuan kandidatë të përbashkët. Në rrethin e parë, i cili u mbajt më 11 nëntor, dalja e votuesve ishte 84,8 % dhe më së shumti vota fitoi partia e vetme e deriatëhershme në pushtet Lidhja Komuniste e Maqedonisë – Partia për Transformim Demokratik (LKM-PTD). Megjithatë, në rrethin e dytë, më 25 nëntor, më së shumti vota fitoi Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) e themeluar po atë vit. Dalja e votuesve në rrethin e dytë ishte 76,8 %.[25]

23 Informacione të detajuara për zgjedhjet dhe për vlerësimin politik në atë periudhë mund të gjeni në Manualin për zgjedhje parlamentare në Republikën e Maqedonisë të vitit 2014 (botimi i dytë i plotësuar), Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, f. 21-23. I Aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37897-1522-2-30.pdf?140529135320 (vizita e fundit: 26 tetor 2016).

24 Komisioni Republikan (Shtetëror) i Zgjedhjeve. Zgjedhje parlamentare më 11 dhe 25 nëntor të vitit 1990. Buletini nr. 20. Rezultate përfundimtare nga zgjedhjet për deputetë në Kuvendin e RS të Maqedonisë. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/1990_parlamentarni/ konecni_rezultati_1990.pdf (vizita e fundit: 24 mars 2014).

25 Bllagoja Nineski, "Zgjedhjet, mediat dhe partitë në Maqedoni 1990-2000", "Studentski zbor", Shkup, 2001, f. 20.

Në njësitë zgjedhore, në të cilat partitë morën pjesë në mënyrë të pavarur, në rrethin e dytë të zgjedhjeve fituan: VMRO-DPMNE gjithsej 38 mandate, LKM-PTD – 31, Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) – 17, Lidhja e Forcave Reformiste në Maqedoni (LFRM) – 11, Partia Socialiste e Maqedonisë (PSM) – 4, Partia e Jugosllavëve (PJ) 2, VMRO-Partia Demokratike (VMRO-PD) – 1, Partia Demokratike Popullore (PDP) – 1 mandat. Si koalicione fituan: Koalicioni PPD/PDP – 5 mandate, koalicioni LFRM/Partia e Re Progresive Demokratike (PRPD) – 6, koalicioni PSM/LFRM/PRPD – 1, koalicioni Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve (PEPR)/PSM - 1 mandat. Në këto zgjedhje u zgjodhën edhe tre deputetë të pavarur.

Në përbërje të këtillë më datë 20 mars të vitit 1991 Kuvendi e votoi Qeverinë e parë të Republikës së Maqedonisë, e cila ishte Qeveri eksperte në krye me Nikolla Klusevin. Kuvendi e zgjodhi edhe Kiro Gligorovin për President të parë, ndërsa Lubço Georgievskin, liderin e VMRO-DPMNE për nënpresident të shtetit. Qeveria e parë nuk ishte jetëgjatë, Kuvendi më 17 gusht të vitit 1992 i votoi mosbesim. Mandati për formimin e qeverisë së re iu besua liderit të VMRO-DPMNE Lubço Georgievskit, parti e cila kishte numër më të madh të mandateve në Kuvend. Georgievski nuk pati sukses të formoj qeveri, kështu që mandati iu ofrua Petar Goshevit, kryetar i LKM-PTD. Megjithatë, Goshevi e refuzoi mandatin, dhe pas kësaj mandati iu ofrua Branko Cërvenkovskit, po ashtu nga LKM-PTD. Cërvenkovski e pranoi dhe e formoi Qeverinë e parë politike në Maqedoninë e pavarur.




## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 1994

Zgjedhjet e para parlamentare pas pavarësimit të Maqedonisë, u mbajtën në vitin 1994, njëkohësisht me zgjedhjet e para të drejtpërdrejta për President të shtetit. Në zgjedhje kandidatë të tyre propozuan 38 parti politike, ndërkaq u kandiduan 283 kandidatë të pavarur, fitoi koalicioni "Aleanca për Maqedoni", i udhëhequr nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), parti pasardhëse e LKM-PTD. Me fjalë të tjera, në Kongresin partiak në prill të vitit 1991 partia e ndërroi emërtimin, me ç'rast ideologjinë e vet e transformoi nga komuniste në socialdemokrate.

Në zgjedhje,[26] të cilat zhvilloheshin sipas modelit zgjedhor mazhoritar, nga gjithsej 1 360 792 votues të regjistruar në rrethin e parë, i cili u mbajt më 16 tetor, dolën 77,8 %, ndërkaq jehona në rrethin e dytë, i cili u mbajt më 30 tetor ishte 57,5 %. Dalja e zvogëluar në masë të konsiderueshme në rrethin e dytë ka të bëjë me atë që partitë opozitare VMRO-DPMNE dhe Partia Demokratike vendosën ta bojkotojnë votimin.[27] Ata pohonin se në rrethin e parë ka pasur parregullsi serioze të procesit zgjedhor, se ka ndodhur falsifikim zgjedhor dhe lëshime në organizimin e zgjedhjeve, veçanërisht sa u përket listave të zgjedhësve.

Sipas rezultateve të rrethit të parë, Koalicioni "Aleanca për Maqedoninë", në të cilin morën pjesë LSDM dhe PSM, ishte në avantazh të konsiderueshëm para partive kryesore opozitare VMRO-DPMNE dhe Partisë Demokratike (PD). Koalicioni "Aleanca për Maqedoninë" fitoi 32,6 % të votave, VMRO-DPMNE – 14,3 %, ndërsa PD – 11,0 %.

Për shkak të bojkotit të opozitës, partitë e Aleancës për Maqedoninë, në rrethin e dytë arritën të fitojnë një numër shumë më të madh të deputetëve. LSDM fitoi gjithsej 60 mandate të deputetëve, Partia Liberale (PL) – 29, PPD – 11, PSM – 9, Partia për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH) – 4, PDP – 2. Nga 1 mandat deputeti fituan

26 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Zgjedhje Parlamentare 16 dhe 30 tetor 1994. Raport për zgjedhjet e zbatuara për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në vitin 1994. Shkup, 8 nëntor 1994. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/1994_parlamentarni/izvestaj_parlamentarni_1994.pdf (vizita e fundit: 22 mars 2014).

27 Dr. Cane Mojanovski, Kronikë e demokracisë maqedonase, faqe 43. Shkup, viti 2000. I aksesshëm në: http://www.fb.uklo.edu.mk/knigi/Cane%20T.%20Mojanoski%20Letopis%20na%20makedonskata%20demokratija.pdf (vizita e fundit: 24 mars 2014).

partitë: Partia Demokratike e Maqedonisë (PDM), Partia Demokratike e Turqve (PDT), Lidhja Demokratike e Shqiptarëve – Partia Liberale, Partia Socialdemokrate e Maqedonisë (PSDM) dhe PEPR.

Rrethi i dytë i këtyre zgjedhjeve u monitorua nga vëzhguesit e Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI).[28] Vëzhguesit, gjatë monitorimit nuk kanë vërejtur probleme serioze në procesin zgjedhor të cilat do ta vinin në pikëpyetje legjitimitetin e zgjedhjeve. Megjithatë, ata nënvizuan se përkrah konstatimit të përgjithshëm se zgjedhjet janë mirë të organizuara, në shumë vende listat e zgjedhësve nuk kanë qenë të azhurnuara, ndërsa në vendvotime të ndryshme votuesve, nga ana e komisioneve zgjedhore, u janë kërkuar dokumente të ndryshme për identifikimin e tyre, me ç'rast është krijuar konfuzion. Veç tjerash, vëzhguesit kanë vërejtur edhe ankesa nga ana e votuesve se për shkak të mefshtësisë së organeve shtetërore akoma nuk i kanë pranuar dokumentet e nevojshme, me çka u është pamundësuar realizimi i të drejtës së tyre të votës. Pas zgjedhjeve, Qeverinë përsëri e formoi Branko Cërvenkovski në të cilën, përveç ministrave nga radhët e LSDM pozicione fituan edhe partitë PSM, PPD dhe PL. Në periudhën kohore nga viti 1994 deri në vitin 1998 Kuvendi funksionoi pa partitë më të mëdha opozitare të cilat i bojkotuan punimet gjatë gjithë mandati katërvjeçar.




28 Sipas: Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI), Misioni Monitorues i Zgjedhjeve në Maqedoni. Zgjedhje Parlamentare më 18 dhe 30 tetor, 1994. Raport përfundimtar nga monitorimi i rrethit të dytë të zgjedhjeve. I aksesshëm në: http://www.iri.org/sites/default/files/Macedonia's%201994%20Parliamentary%20Elections.pdf (vizita e fundit: 24 mars 2014).

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 1998

Zgjedhjet e ardhshme parlamentare u mbajtën në vitin 1998 sipas modelit zgjedhor të ndryshuar. Zgjedhjet u zhvilluan sipas sistemit të kombinuar zgjedhor,[29] me kombinimin e modelit proporcional dhe mazhoritar me votim në dy rrethe. Me ndryshimet nga 120 mandate, 85 u shpërndanë në njësinë zgjedhore me një mandat, për të cilat u votua më 18 tetor, ndërkaq 35 mandatet e tjera, përmes formulës proporcionale të D'Hont-it, me ç'rast i tërë shteti ishte një njësi zgjedhore, ndërkaq votimi u zhvillua më 1 nëntor. Për listat proporcionale u instalua pragu zgjedhor prej 5 %. Nga gjithsej 1 572 976 votues të regjistruar për këto zgjedhje, për listat mazhoritare në votim dolën 72,9 %. Jehona[30] për listën proporcionale në rrethin e dytë ishte 69,4 %. Për listat mazhoritare me kandidatë të tyre dolën 22 parti politike, 4 koalicione dhe 7 kandidatë të pavarur. Në listat proporcionale garonin 12 parti, 4 koalicione dhe një grup zgjedhësish.

Këto zgjedhje rezultuan me ndërrimin e pushtetit, me ç'rast fitues ishte VMRO-DPMNE,[31] e cila fitoi 49 mandate të deputetëve, ndërsa në vendin e dytë ishte LSDM me 27 mandate. PPD fitoi 14 mandate të deputetëve, Alternativa Demokratike (AD) - 13, Partia Demokratike e Shqiptarëve (PDSH) – 11, Partia Liberal – Demokrate (PLD) – 4, ndërsa PSM dhe Lidhja e Romëve të Maqedonisë (LRM) nga 1 mandat në Parlament. Pas zgjedhjeve, lideri i VMRO-DPMNE, Lubço Georgievski, formoi Qeveri koalicioni me AD dhe PDSH.

Këto ishin zgjedhjet e para në Maqedoni të monitoruara nga Misioni OSBE/ODIHR, përfaqësuesit e të cilëve erdhën me ftesë të Ministrisë së

29 Ligji për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24 nga 28 maj 1998. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/EF6EE403BB7A4C52B969183A4F04CA8A.pdf (vizita e fundit: 22 tetor 2016).

30 Dr. Cane Mojanovski, Kronikë e demokracisë maqedonase, faqe 67. Shkup viti 2000. Të dhëna për daljen e votuesve në të dy rrethet e Zgjedhjeve Parlamentare në vitin 1998. I aksesshëm në: http://www.fb.uklo.edu.mk/knigi/Cane%20T.%20Mojanoski%20Letopis%20na%20 makedonskata%20demokratija.pdf. (vizita e fundit: 26 mars 2014). Në ueb-faqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në arkiv të dhënat nuk janë të aksesshme për daljen e votuesve në vitin 1998.

31 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezultate nga zgjedhja e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 1998. I aksesshëm në: http://www.sobranie.mk/?ItemID=9402373424ED504883EE17FED5E72EB4 (vizita e fundit: 12 tetor 2016).

Punëve të Jashtme të Maqedonisë. Vlerësim i përgjithshëm në raportin[32] e monitorimit është se në këtë proces zgjedhor ka përmirësime të konsiderueshme në krahasim me zgjedhjet e kaluara për shkak të ndryshimeve në legjislacionin zgjedhor, fushatës korrekte parazgjedhore me një numër të vogël të rasteve të izoluara të dhunës. Vërejtjet kryesore konsistojnë me më shumë raste të regjistruara të votimit familjar dhe grupor dhe mefshtësinë e organeve zgjedhore gjatë përpunimit të të dhënave nga votimet.




## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2002

Zgjedhjet parlamentare të 15 shtatorit të vitit 2002 u zhvilluan në një atmosferë të tensionuar post-konfliktuale, pas vitit 2001, në të cilin ndodhi konflikti i armatosur ndërmjet forcave të sigurisë dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), i cili përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.[33] Karakteristikë e këtij cikli është se në skenën politike të bllokut politik shqiptar u paraqit një subjekt i ri partia Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), e formuar nga udhëheqësia e UÇK-së. Në këto zgjedhje u ndryshua modeli zgjedhor. Zgjedhjet u mbajtën sipas modelit zgjedhor proporcional,[34] në gjashtë njësi zgjedhore, ndërsa në listat e kandidatëve kishte përfaqësues nga 33 parti. Nga gjithsej 1 664 296 votues të regjistruar në zgjedhje dolën 73,4 %. Në këto zgjedhje përsëri kishim ndryshim të pushtetit. Shumicën e fitoi Koalicioni "Bashkë për Maqedoninë" i udhëhequr nga LSDM. Koalicioni fitoi 60 mandate, prej të cilëve LSDM fitoi 43, PLD – 12, PDT – 2 dhe nga 1 mandat të deputetit fituan Partia e Bashkuar e Romëve në Maqedoni (PBRM), Liga Demokratike e Boshnjakëve (LDB) dhe Partia Demokratike e Serbëve (PDS).

Koalicioni VMRO-DPMNE – PL fitoi gjithsej 33 mandate. Prej të cilave 27 i fitoi VMRO-DPMNE, 5 i fitoi PL dhe një mandat e fitoi Partia e Lëvizjes së Turqve në Maqedoni (PLTM). Nga partitë politike të shqiptarëve në Maqedoni më së shumit vende në Kuvend fitoi partia e sapoformuar BDI, përkatësisht 16 mandate. PDSH fitoi 7, PPD 2, ndërsa PDP 1 mandat. Partia Socialiste e Maqedonisë (PSM) gjithashtu fitoi një mandat.

Misioni monitorues i OSBE/ODIHR[35] shprehu shqetësime për periudhën kohore të fushatës, i cili u parapriu këtyre zgjedhjeve, për shkak të numrit të madh të rasteve të dhunës, kërcënimeve dhe zbatimit selektiv të procedurave ligjore ndaj kandidatëve të caktuar. Vet procesi zgjedhor u vlerësua se u zhvillua mirë.

Mandatar i Qeverisë së re, pas 4 vitesh pauzë, përsëri ishte lideri i LSDM-së Branko Cërvenkovski, ndërsa në të u përfshinë edhe PLD dhe BDI. Për BDI kjo ishte pjesëmarrja e parë në një Qeveri të Maqedonisë.




32 Sipas: OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje Parlamentare 18 tetor dhe 1 nëntor të vitit 1998, Raport përfundimtar. I aksesshëm në: http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/15887?download=true(vizita e fundit: 12 tetor 2016).

33 Marrëveshja Kornizë e Ohrit, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit. I aksesshëm në: http://siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_mk.pdf (vizita e fundit: 13 tetor 2016).

34 Ligji për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Neni 96, Verifikimi i rezultateve të votimit në njësitë zgjedhore për Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2002. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/2002_parlamentarni/zakonski%20regulativi/zakonski%20regulativi.html (vizita e fundit: 26 mars 2014).

35 Sipas: OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje Parlamentare 15 shtator 2002, Raport përfundimtar. Varshavë, 20 nëntor i vitit 2002. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/15961?download=true (vizita e fundit: 24 mars 2014).

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2006

Në këto zgjedhje, të cilat u mbajtën më 5 korrik të vitit 2006, u shënua jehonë më e ulët[36] Nga gjithsej 1 741 449 votues të regjistruar në zgjedhje dolën vetëm 56 %, ndërsa partitë përsëri i ndërruan rolet. Partia në pushtet LSDM kaloi në opozitë, ndërkaq opozita e deriatëhershme VMRO-DPMNE e fitoi shumicën në Parlament. Këto zgjedhje, sikurse edhe ato paraprake, u zhvilluan sipas modelit zgjedhor proporcional në gjashtë njësi zgjedhore, ndërsa për pjesëmarrje në to u paraqitën 33 lista të kandidatëve, prej të cilave 31 nga partitë politike dhe koalicionet dhe 2 nga grupe zgjedhësish. Koalicioni "Për Maqedoni më të mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 45 mandate të deputetëve. Prej tyre 38 i takuan VMRO-DPMNE. Koalicioni i dytë sipas votave, ishte Koalicioni "Bashkë për Maqedoninë" i udhëhequr nga LSDM me 32 mandate. Prej tyre, LSDM fitoi 23 deputetë, koalicioni i tretë ishte BDI-PPD i cili fitoi 17 mandate të deputetëve. Prej tyre BDI-së i takuan 14 mandate, ndërsa PPD-së – 3. PDSH fitoi 11 mandate, Partia e Re Socialdemokrate (PRSD) – 6, VMRO - Partia Popullore (VMRO-PP) – 6, Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë (RDM) – 1 dhe Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE) – 1 mandat.

Misioni monitorues i OSBE/ODIHR[37] konkludoi se zgjedhjet, në masë të madhe, janë zhvilluar në përputhje me angazhimet për zgjedhje demokratike, megjithatë në ditën e zgjedhjeve është vërejtur një numër i caktuar i parregullsive, ndërsa në gjysmën e parë të fushatës parazgjedhore ka pasur raste të dhunës dhe frikësimeve.

Pas këtyre zgjedhjeve, Nikolla Gruevskit iu besua mandati i parë për formimin e Qeverisë. Në përbërjen e saj u përfshinë përfaqësues të Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, PDSH dhe PRSD. Qeveria e mbështeti RDM dhe PAE, të cilët nuk fituan vende të ministrave. VMRO-PP votoi "Pro" Qeverisë, por nuk hyri në koalicionin qeveritar.

[36] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezultatet zgjedhore të Zgjedhjeve Parlamentare 2006. Rezultate përmbledhëse përfundimtare nga votimi. Raportin e hartoi Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 25 qershor 2006. I aksesshëm në: http://sobranie.mk/WBStorage/Files/Rezultati-2006-5.pdf (vizita e fundit: 25 mars 2014).

[37] Sipas: OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje Parlamentare 5 korrik 2006, Raport përfundimtar. Varshavë, 18 shtator 2006. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/20630?download=true (vizita e fundit: 23 mars 2014).

Karakteristikë e kësaj përbërje të Qeverisë është se ndonëse BDI fitoi më shumë vota dhe deputetë, VMRO-DPMNE për partner të vet e mori PDSH-në e Menduh Thaqit. Kjo rezultoi me krizë politike dhe me bllokada gjysmë orëshe disaditore[38] në një pjesë të rrugëve magjistrale në Maqedoninë Veriperëndimore nga anëtarë dhe simpatizantë të BDI, e cila konsideronte se konform rezultateve zgjedhore është përfaqësuese e vetme legjitime e shumicës së shqiptarëve në Maqedoni dhe për këtë doemos duhej të jetë në Qeveri dhe se çdo gjë që është në kundërshtim me këtë, ka të bëjë me mosrespektimin e vullnetit politik të shqiptarëve. Në muajin mars të vitit 2008 PDSH[39] mori vendim ta braktisë Qeverinë. Arsyetimi i PDSH[40] ishte se e ndërmarrin këtë hap për shkak të heshtjes së Kryeministrit Gruevski lidhur me gjashtë kërkesat të cilat ia paraqitën. Kërkesat kishin të bëjnë me njohjen e Kosovës, me mos-procedimin e "rasteve të Hagës", me ndryshimet e Ligjit për gjuhët sa i përket përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, përdorimit të flamujve dhe statusit të luftëtarëve të UÇK, si dhe rritjen e përfaqësimit të shqiptarëve në administratën publike.



Mandate të fituara në zgjedhjet parlamentare 2006

[38] Protesta të BDI, Dojçe Vele, servisi në gjuhën maqedonase, 7 gusht 2006. I aksesshëm në: http://www.dw.de/%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%81%D1%82%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%B4%D1%83%D0%B8/a-2535607 (vizita e fundit: 17 tetor 2016).

[39] PDSH doli nga Qeveria, Agjencia Informative Maqedonase, 13 mars 2008. I aksesshëm në: http://www.idividi.com.mk/vesti/makedonija/427732/index.htm (vizita e fundit: 17 tetor 2016).

[40] PDSH u prononcua se e braktis Qeverinë, Bi-bi-si servisi në gjuhën maqedonase, 12 mars 2008. I aksesshëm në: http://www.bbc.co.uk/macedonian/news/story/2008/03/080312_vladaostavka.shtml (vizita e fundit: 17 tetor 2016).

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2008

Dy vjet pas ardhjes në pushtet, partia në pushtet VMRO-DPMNE e pranoi iniciativën e BDI në Kuvend për shpërndarjen e Parlamentit dhe për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme.[41] Më 12 prill të vitit 2008 Kuvendi u shpërnda, ndërsa zgjedhjet parlamentare në Maqedoni u mbajtën më 1 qershor. Partia e Ali Ahmetit konsideronte se duhet të mbahen zgjedhje të reja, në mënyrë që të korrigjohet gjendja paraprake në të cilën PDSH, partia me numër më të vogël të mandateve të fituara, i përfaqësonte shqiptarët në Qeveri. Njëkohësisht, në atë periudhë kohore vendi u përball me sfida të reja në integrimet euroatlantike për shkak të mospranimit të ftesës për anëtarësim në Aleancë[42] në Samitin e Bukureshtit, për shkak të kontestit me Greqinë rreth emrit kushtetues të Maqedonisë. Këto janë zgjedhjet e para të parakohshme parlamentare në Maqedoninë, të rëndësishme edhe për atë se zgjedhjet nuk rezultuan me ndërrimin e pushtetit, por VMRO-DPMNE i fuqizoi pozitat e veta. Zgjedhjet u zhvilluan sipas modelit proporcional, ndërsa në votim dolën 57,06% nga gjithsej 1.779.116 qytetarë të regjistruar me të drejtë vote. Në zgjedhjet, të cilat u mbajtën më 1 qershor, me kandidat të tyre në lista morën pjesë 41 parti dhe dy grupe zgjedhësish.

Koalicioni "Për Maqedoni më të mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, nga gjithsej 120 deputetë të mundshëm fitoi 63 mandate[43] e që deri në atë kohë ishte numër rekord. Prej tyre 53 i takuan VMRO-DPMNE. Nga partitë e koalicionit, PSM-ja fitoi 3, ndërsa nga një deputet fituan: Lidhja Demokratike (LD), RDM, Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM), PDS, PBRM, VMRO-Maqedonase dhe Partia për Aksion Demokratik të Maqedonisë (PAD).

41 Sipas: Asociacionit Qytetar "Most", Raport përfundimtar nga monitorimi vendor i Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të 1 qershorit 2008. Shkup, shtator 2008. Konteksti politik, faqe 3. I aksesshëm në: http://www.most.org.mk/images/transparency/Parliamentary%20Elections%202008/parlamentarniIzbori 2008.pdf (vizita e fundit: 26 mars 2014).

42 Dejection in Bucharest: Jilted Macedonia Walks out of NATO Summit, Spiegel. I aksesshëm në: http://www.spiegel.de/international/world/dejection-in-bucharest-jiltedmacedonia-walks-out-of-nato-summit-a-545214.html (vizita e fundit: 17 tetor 2016).

43 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare më 1 qershor 2008. Raport për rezultatet përfundimtare sipas modelit të D'Hontit. I aksesshëm në: http://www.sec.mk/arhiva/2008_predvremeniparlamentarni/index/2008-07-17-10-15-07.htm (vizita e fundit: 20 mars 2014).



Në vend të dytë ishte Koalicioni opozitar "Dielli – Koalicioni për Evropë" i udhëhequr nga LSDM me gjithsej 27 deputetë. Prej tyre 18 mandate u përkisnin LSDM-së, që është numri më i vogël i deputetëve deri më atëherë. Vendet e tjera në Parlament i fituan anëtarët e Koalicionit: PLD – 4, PRSD – 3, ndërsa PL dhe Alternativa e Re (AR) fituan nga një mandat deputeti.

BDI fitoi 18 deputetë dhe pastaj bashkë me Koalicionin fitues formuan Qeverinë. PDSH fitoi 11 deputetë, ndërsa një mandat e fitoi edhe PAE.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve e anuloi votimin në 197 vende zgjedhore dhe organizoi rivotim. Misioni monitorues i OSBE/ODIHR[44] regjistroi se në zgjedhje nuk u realizua progresi i pritur për shkak se autoritetet kompetente nuk arritën t'i parandalojnë incidentet e dhunshme, kryesisht në mjediset me shumicë shqiptare. Mangësitë u shmangën gjatë rivotimit, me prezencë të përforcuar të policisë, me ç'rast qytetarët e realizuan të drejtën e tyre të votës në një atmosferë më të qetë. Qeverinë përsëri e formoi Nikolla Gruevski, ndërsa në të, përveç ministrave të Koalicionit "Për Maqedoni më të mirë" u përfshinë edhe ministra të BDI- së.




44 Sipas: OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 1 qershor 2008, Raport përfundimtar. Varshavë, 20 gusht 2008. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/33153?download=true (vizita e fundit: 23 mars 2014).

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2011[45]

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të datës 5 qershor 2011 ishin zgjedhje të dyta të parakohshme për Kuvendin që nga pavarësimi i Maqedonisë dhe zgjedhje të dyta të këtilla të njëpasnjëshme. Atyre u parapriu një gjendje komplekse politike dhe një nga krizat më serioze politike në vend, që nga pavarësimi i shtetit.[46] Në fillim të vitit 2011 opozita e udhëhequr nga Branko Cërvenkovski, me përjashtim të PLD, e braktisi Parlamentin dhe kërkoi shpallje të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Shkak për këtë ishte pezullimi i llogarive bankare të televizionit më të madh privat “A1” dhe të tri gazetave ditore “Vreme”, “Koha” dhe “Shpic” në pronësi të biznesmenit Velija Ramkovski, arrestimi i tij në dhjetor të vitit 2010, si dhe pohimi se në vend nuk ekziston dialogu politik.[47] Kryeministri Nikolla Gruevski[48] në muajin mars e pranoi kërkesën, ndërsa opozita vendosi disa kushte, në mesin e të cilave zhbllokimin e llogarive të katër mediave, miratimin e Ligjit për shpërndarje të balancuar të parave shtetërore për të gjitha mediat, diskutim për ndryshimet e Kodit Zgjedhor me konsensus dhe formimin e Komisionit të përbashkët parlamentar për kontrollin e Listës së Zgjedhësve, me ç’ras u kërcënuan se nëse nuk përmbushen kërkesat e tyre, do t’i bojkotojnë zgjedhjet. Më 21 mars partia më e madhe opozitare[49] konkludoi se në përgjithësi kushtet që i ka vendosur janë përmbushur dhe vendosi të kthehet në Kuvend.

45 Informacione të detajuara për zgjedhjet dhe për skenën politike në atë periudhë mund të gjeni në Manualin për Zgjedhje parlamentare në Republikën e Maqedonisë viti 2014 (botimi i dytë i plotësuar), Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup, f. 32-34. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37897-1522-2-30.pdf?140529135320 (vizita e fundit: 26 tetor 2016).

46 Sipas: Asociacionit Qytetar “Most”, Raport përfundimtar nga monitorimi vendor i Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 5 qershor 2011. I aksesshëm në: http://www.most.org.mk/images/transparency/elections2011/Final_report_IZBORI_2011_MKD.pdf(vizita e fundit: 17 tetor 2016).

47 Ramkovski u arrestua në dhjetor të vitit 2010, dhe u ndalua në paraburgim me akuzën pastrim parash, organizatë kriminale, abuzim të tatimit dhe keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar. Si i akuzuari i parë në procesin gjyqësor “Pezhishka” në mars të vitit 2012 iu shqiptua dënim me burgim prej 13 vjet. Si pjesë e procesit gjyqësor “Pezhishka” u akuzuan 23 persona, drejtorë dhe themelues të firmave me seli në rr. “Pero Nakov” p.n., në mesin e të cilëve djali i Ramkovskit, Hedi Ramkovski, vajza e tij Emel Ramkovska, vëllai i Ramkovskit, Amdi Ramkovski, si dhe ish drejtorët e televizionit A1 Darko Perushevski dhe Aneta Koçishki.

48 S.S.Z.Partitëbëjnëkonsultimeurgjente,“NovaMakedonija”,22shkurt2011.Iaksesshëmnë:http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=22211818202&id=9&setIzdanie=22213 (vizita e fundit: 26 mars 2014).

49 Cërvenkovski: Pas përmbushjes së 4 kushteve LSDM kthehet në Kuvend. LSDM, Shkup 21 mars 2011. Deklaratë e liderit të LSDM, Branko Cërvenkovski, rreth përfundimit të krizës politike e cila çoi në zgjedhjet e vitit 2011. I aksesshëm në: http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=5008 http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=5008 (vizita e fundit: 26 mars 2014).



Karakteristikë e këtyre zgjedhjeve është edhe ajo që u rrit numri i njësive zgjedhore prej 6 në 9. Me tri njësitë e reja, njëra për Evropë dhe Afrikë, njëra për Amerikën Veriore dhe Jugore dhe njëra për Australinë dhe Azinë, u përfshinë edhe shtetasit jashtë vendit. Me këtë u rrit numri i mandateve të deputetëve në Kuvend nga 120 në 123, përkatësisht nga 1 deputetë nga secila njësi e re zgjedhore. Shtetasit maqedonas të cilët jetojnë jashtë vendit votuan në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK).

Jehona në këto zgjedhje ishte 63,39 % nga gjithsej 1 821 122 votues të regjistruar. Për shkak të mundësimit të votimit jashtë vendit u bë një modifikim i vogël i modelit zgjedhor. Kështu që, në 6 njësitë zgjedhore në territorin e Maqedonisë kandidatët zgjidhen sipas modelit proporcional, ndërsa në tre njësitë e reja zgjedhore jashtë vendit u zbatua modeli mazhoritar. Në listat e zgjedhësve kandidatë të tyre paraqitën 53 parti politike.

Përsëri fitoi Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Koalicioni fitoi 56 mandate prej të cilëve 47 VMRO-DPMNE. Nga partitë e koalicionit, PSM fitoi 3 deputetë, ndërsa LD, RDM, PAD, PDTM, PDS dhe VMRO-Maqedonase nga 1 deputet. Në vend të dytë, sipas numrit të vendeve të fituara, ishte Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, me gjithsej 42 mandate. Prej tyre 29 mandate i takuan LSDM-së, PRSD – 4, PAE - 3, ndërsa nga 1 deputet fituan: PL, Lëvizja për Unitet Nacional të Turqve në Maqedoni (LUNT), PEPR, Partia Përparimtare Serbe në Maqedoni (PPSM) dhe dy deputetë të pavarur. Në vendin e tretë, sipas numrit të mandateve të deputetëve në Kuvend ishte BDI me 14 mandate, vijonin PDSH – 8, RDK – 2 dhe Liga Demokratike e Boshnjakëve (LDB) 1 deputet.

Vlerësimi i përgjithshëm ishte se zgjedhjet zhvillohen në një atmosferë të qetë dhe të ndershme.[50] Pas zgjedhjeve lideri i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski, për herë të tretë e formoi Qeverinë në të cilën si partner koalicioni përsëri u përfshi BDI, si përfaqësuese e shqiptarëve.

50 Sipas: OSBE Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut. Republika e Maqedonisë, zgjedhje të parakohshme parlamentare 5 qershor 2011, Raporti përfundimtar, Varshavë, 6 tetor 2011, gusht 2008. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/ node/84061?download=true (vizita e fundit: 26 mars 2014).




## ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2014

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 ishin zgjedhjet e teta parlamentare me radhë nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë, ndërsa të tretat me radhë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Zgjedhjet u mbajtën bashkë me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, të cilat u shpallën më 6 mars pasi që një ditë më parë, më 5 mars, deputetët unanimisht votuan për shpërndarjen e Kuvendit.[51] Paraprakisht, në dhjetor, lideri i BDI-së Ali Ahmeti, doli me qëndrim se nuk e mbështet presidentin aktual Gjorge Ivanov,[52] meqë në masë të pamjaftueshme i përfaqëson shqiptarët etnikë në Maqedoni. Pastaj, partia doli me qëndrimin se nuk do të propozojë kandidatë të vetin presidencial dhe angazhohej për të ashtuquajturin "President konsensual", përkatësisht President të pranueshëm për të gjitha bashkësitë etnike në Maqedoni. Meqë të dy partnerët e koalicionit VMRO-DPMNE dhe BDI, nuk patën sukses të gjejnë zgjidhje të përbashkët lidhur me propozimin për "President konsensual" dhe meqë u bë e qartë se VMRO-DPMNE do ta propozoj Ivanovin për mandatin e dytë presidencial, grupi parlamentar i BDI-së më 1 mars formalisht paraqiti nismë në Kuvend për shpërndarjen e tij dhe për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.[53]

51 Vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i RM, 6 mars 2014. I aksesshëm në: http://goo.gl/ph6ffF (vizita e fundit: 19 tetor 2016).

52 Ahmeti – Bombardime në koalicion nuk do të ketë, Radio Evropa e Lirë, programi në gjuhën maqedonase, 22 dhjetor 2013. I aksesshëm në: http://www.makdenes.org/content/article/25208426.html (vizita e fundit: 31 mars 2014).

53 Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë viti 2014 (botimi i dytë plotësues), Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, f. 12 – 13. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_37897-1522-2-30.pdf?140529135320 (vizita e fundit: 26 tetor 2016).



Zgjedhjet u mbajtën më 27 prill. Nga gjithsej 1 780 128 votues të regjistruar votuan 62,96 %. Kandidatët për deputetë, si edhe në ciklin paraprak zgjedhor, zgjidheshin në 6 njësi zgjedhore në territorin e Maqedonisë sipas modelit proporcional dhe në tri njësi jashtë vendit, sipas modelit mazhoritar. Deri në afatin e fundit lista të tyre me kandidatë paraqitën gjithsej 14 subjekte politike.

Në këto zgjedhje përsëri fitoi koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE[54] dhe Nikolla Gruevski, kësaj radhe me numër bindës të votave. Ky Koalicion fitoi 61 mandate, prej të cilëve 52 i fitoi VMRO-DPMNE. Nga partnerët e koalicionit, PSM fitoi 3 deputetë, ndërsa LD – 1, RDM -1, PADM (Partia e Aksionit Demokratik të Maqedonisë) – 1, PDTM -1, PDSM (Partia Demokratike e Serbëve të Maqedonisë) - 1, LRM (Lidhja e Romëve të Maqedonisë) 1 deputet. Në vendin e dytë, sipas numrit të vendeve të fituara, ishte Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, me gjithsej 34 mandate. Prej tyre 27 i fitoi LSDM, PRSD – 3, PLD – 3 dhe PLT (Partia e Lëvizjes së Turqve) - 1. Në vend të tretë, sipas numrit të mandateve të deputetëve në Kuvend, ishte BDI me 19 mandate, pasoi PDSH – 7, RDK (Rilindja Demokratike Kombëtare) dhe OPQM (Opsioni Qytetar për Maqedoninë) me nga një deputet.

Pas zgjedhjeve, lideri i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski, për të katërtën herë formoi Qeveri në të cilën përsëri si partner i koalicionit i cili i përfaqëson shqiptarët hyri BDI. Menjëherë, pas mbylljes së vendvotimeve, më 27 prill të vitit 2014, para fillimit të numërimit të votave, lideri i LSDM, Zoran Zaev, publikoi se opozita e bashkuar nuk do t'i njoh rezultatet e zgjedhjeve dhe se kërkojnë të formohet Qeveri teknike, e cila do të organizojë zgjedhje të reja presidenciale dhe parlamentare. Ai e akuzoi VMRO-DPMNE për uzurpimin e së drejtës së votës, për kontroll të plotë sistematik të votuesve në procesin zgjedhor, për abuzim të sistemit shtetëror për qëllime partiake, presione mbi

54 VMRO-DPMNE, Partia Socialiste e Maqedonisë, Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni, Lidhja e Romëve në Maqedoni, Partia e Drejtësisë, Partia e Aksionit Demokratik në Maqedoni, Partia e Vllehëve në Maqedoni, Partia për Integrimin e Romëve, Partia Punëtore – Bujqësore e Republikës së Maqedonisë, Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas, Partia e Re Liberale, Partia e Demokratëve të Bashkuar të Maqedonisë, Organizata Atdhetare Maqedonase për Rilindje Radikale të Vardarit të Egjeut Pirinit, Aleanca Maqedonase, Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni, VMRO-PD (VMRO-Partia Demokratike), Lidhja Demokratike, Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë, Forcat Demokratike të Romëve, Partia Demokratike Boshnjake, Partia e Bashkuar për Barazinë e Romëve, Partia Demokratike e Romëve, Unioni Socialdemokrat, Romët e Bashkuar nga Maqedonia.

administratën publike, me ç'rast deklaroi se partia LSDM ka qenë dëshmitare e blerjes së votave dhe parregullsive të shumta.[55]

Vëzhguesit vlerësuan se zgjedhjet e 27 prillit u zbatuan në mënyrë efikase, duke e përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve, me disa parregullsi të vërejtura teknike gjatë ditës. Në mënyrë pozitive u vlerësua sublimimi i rezultateve në ueb faqen e KSHZ. Megjithatë, vëzhguesit theksuan edhe një sërë dobësish të procesit zgjedhor. Në mesin e të cilave, përdorimi i resurseve publike në fushatën e partisë në pushtet, pabarazia e votës për shkak të shpërndarjes së pabarabartë të votave në njësitë zgjedhore 7, 8 dhe 9 jashtë vendit dhe dallimi midis numrit të votave në njësitë zgjedhore brenda dhe jashtë vendit, presion ndaj votuesve, veçanërisht ndaj të punësuarve në administratën publike dhe mbi rastet sociale, si dhe blerja e votave në mesin e grupeve të rrezikuara ekonomikisht. U manifestua shqetësimi sa i përket saktësisë së Listës së Zgjedhësve, dhe posaçërisht në lidhje me numrin e madh të votuesve të cilët jetojnë në adresë të njëjtë. Dispozitat ligjore, të cilat ju mundësojnë partive politike t'i kontestojnë të dhënat që kanë të bëjnë me votuesit në Listën e Zgjedhësve, janë vlerësuar si të paqarta dhe në mënyrë të paqartë përcaktojnë se cili institucion është përgjegjës për zbatimin e hetimeve.[56,57]




55 Zaev: LSDM nuk i njeh zgjedhjet dhe kërkon zgjedhje të reja me qeveri teknike, Zëri i Amerikës, 27 prill 2014. I aksesshëm në: http://mk.voanews.com/a/macedonia-elections/1902316.html (vizita e fundit: 20 dhjetor 2016?).

56 Raporti final – Monitorimi vendor i zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare 2014, Asociacioni Qytetar MOST. I aksesshëm në: www.most.org.mk/images/MOST/Final Report_ Presidential and Parliamentary Elections 2014_MKD.pdf (vizita e fundit: 18 tetor 2016).

57 Sipas: OSBE Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje presidenciale dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare, 27 prill 2014, Raporti përfundimtar, Varshavë, 15 korrik 2014. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/121926?download=true (vizita e fundit: 8 nëntor 2014.)

## JEHONA E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE (1990 – 2014)

Nga të dhënat e të gjitha zgjedhjeve të organizuara parlamentare deri më tani, duke llogaritur nga viti 1990 dhe deri në zgjedhjet e fundit të vitit 2014, mund të vërehet një rënie e butë e jehonës së votuesve. Në zgjedhjet e para parlamentare të vitit 1990 jehona ishte më e madhe, ndërsa jehonë më e vogël është regjistruar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006. Nga viti 2011 deri në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura në vitin 2014, përqindja e daljes së votuesve është e ngjashme, por megjithatë, shumë më e ulët nga ajo e vitit 1990.



# SISTEMI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR ZGJEDHJE PARLAMENTARE

## SISTEMI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR ZGJEDHJE PARLAMENTARE

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë deputeti zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë për një mandat 4 vjeçar. Në zgjedhjet parlamentare zgjidhen 120 – 123 deputetë, ndërsa sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Kuvendin mund ta përbëjnë nga 120 deri në 140 deputetë. Deputetët zgjidhen sipas modelit zgjedhor proporcional me lista të mbyllura të deputetëve, me ç'rast në secilën nga gjashtë njësitë zgjedhore, sipas të cilave është bërë ndarja e territorit të Maqedonisë, zgjidhen nga 20 deputetë. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor[58] nga muaji nëntor i vitit 2015 votimi jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë organizohet në nivel të një njësie zgjedhore, njësia numër 7 dhe e përfshin Evropën, Amerikën Veriore dhe Jugore, Australinë dhe Azinë, me ç'rast në këtë njësi zgjedhore mund të zgjidhen më së shumti 3 deputetë. Në zgjedhjet paraprake parlamentare, të vitit 2011 dhe 2014, votimi jashtë vendit zhvillohej në nivel të tri njësive zgjedhore, me ç'rast përmes sistemit mazhoritar zgjidhej nga një, përkatësisht gjithsej tre deputetë.

Numri i zgjedhësve në secilën nga 6 njësitë zgjedhore mund të lëvizë më së shumti në kuadër të margjinës -/+5% në raport me numrin mesatar të zgjedhësve në njësitë zgjedhore. Shpërndarja e mandateve bëhet sipas formulës së D'Hondt-it, me ç'rast rezultatet përcaktohen për secilën njësi zgjedhore veç e veç, sipas numrit të votave të përgjithshme që i kanë fituar listat e kandidatëve. Secila nga partitë fiton vende të deputetëve proporcionalisht me numrin e votave që i kanë fituar për listën e tyre të kandidatëve, në krahasim me numrin e votave të listave të tjera të kandidatëve. Nëse gjatë ndarjes së vendit të fundit për deputet paraqiten dy lista me rezultate identike, atëherë vendi u ndahet me short. Gjatë shpërndarjes së vendeve të deputetëve, konsiderohen për të zgjedhur aq kandidatë sa vende ka fituar lista. Së këtejmi, mandate fitojnë kandidatët në bazë të radhitjes sipas së cilës janë përcaktuar në listat e kandidatëve. Numri i deputetëve të zgjedhur jashtë vendit varet nga jehona e votuesve jashtë vendit, dhe në ç'masë numri i votuesve jashtë vendit për listat e kandidatëve do të

[58] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 196 nga data 10 nëntor 2015. I aksesshëm në: (vizita e fundit; 8 prill 2016).

korrespondoj me numrin më të vogël të votuesve në njësitë zgjedhore në territorin e Republikës nga zgjedhjet e fundit parlamentare. Deputeti i parë në njësinë zgjedhore 7 do të zgjidhet nëse lista e kandidatëve për deputet fiton minimum aq vota sa ka fituar edhe deputeti që është zgjedhur me numër më të vogël të votave në ndonjërën nga njësitë zgjedhore në territorin e shtetit në zgjedhjet e fundit parlamentare. Sipas rezultateve nga zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014, ky numër është 6 478 vota. Numri i nevojshëm i votave të domosdoshme që të fitohet vendi i dytë dhe i tretë për deputet jashtë vendit duhet të lëvizë sipas proporcionit të njëjtë, përkatësisht të jetë dyfishë dhe trefishë më i madh nga numri më i vogël i votave të fituara në ndonjërën nga njësitë zgjedhore në territorin e shtetit në zgjedhjet e fundit parlamentare. Nëse asnjëra nga listat e kandidatëve jashtë vendit nuk e fiton numrin e nevojshëm të votave, atëherë nuk do të zgjidhet asnjë deputet nga njësia zgjedhore numër 7.

Zgjedhjet për deputetë mbahen çdo katër vjet në 90 ditët e fundit të mandatit të legjislaturës paraprake të deputetëve ose brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Në zgjedhjet e parakohshme të gjitha afatet e aktiviteteve zgjedhore shkurtohen për 5 ditë, përveç afatit të përcaktuar për zbatimin e fushatës zgjedhore.

Një deputeti mund t'i pushoj mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur, nëse paraqet dorëheqje, nëse është dënuar për vepër penale për të cilën është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej më së paku pesë vitesh, nëse paraqitet rast që nuk është në pajtim me funksionin deputet, në rast të vdekjes dhe nëse me aktvendim të plotfuqishëm i hiqet aftësia e punës. Nëse deputeti paraqet dorëheqje, Kuvendi në seancën e parë të radhës konstaton se deputetit i pushon mandati nga dita e mbajtjes së seancës.

Nëse deputetit të zgjedhur nga lista e kandidatëve i pushon mandati, sipas njërës nga këto baza, atëherë për pjesën tjetër të mandatit, në vend të tij vjen kandidati i radhës nga lista zgjedhore e partisë në të cilën është zgjedhur deputeti. Përjashtim nga ky rregull bëhet nëse mandati i pushon deputetes. Në rast të këtillë, në vendin e saj, do të vijë kandidatja e radhës nga lista.



Përbërja e re e deputetëve në Kuvend konstituohet në seancën e parë e cila mbahet më së voni 20 ditë pas ditës së zgjedhjeve, ndërsa të njëjtën e thërret kryetari në largim. Nëse Kuvendi nuk konstituohet në këto 20 ditë, atëherë deputetët mblidhen vet dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetenjë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve në ora 10, ndërsa seancën duhet ta thërras deputeti i zgjedhur më në moshë sipas viteve. Nëse ai refuzon ta thërras, kjo e drejtë i bartet sipas radhës deputetit të zgjedhur të ardhshëm sipas viteve të tij të moshës, kështu deri te deputeti i zgjedhur i cili do të pajtohet ta thërras seancën e parë në të cilën do të konstituohet Kuvendi.[59]

Në afat prej më së shumti dhjetë ditësh pas konstituimit të përbërjes së re të Kuvendit, Presidenti i Republikës së Maqedonisë e ka për detyrë t'ia besoj mandatin për formimin e qeverisë së re kandidatit (mandatar) nga partia ose partitë të cilat kanë shumicë të deputetëve.[60] Mandatari, në afat prej 20 ditësh nga dita e besimit të mandatit, Kuvendit i paraqet program dhe e propozon përbërjen e Qeverisë. Pastaj deputetët me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm të deputetëve e zgjedhin Qeverinë.

## ORGANE ZGJEDHORE

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) bashkë me komisionet komunale zgjedhore (KKZ), këshillat zgjedhorë (KZ) për votim brenda vendit dhe në PDK të Republikës së Maqedonisë janë organet zgjedhore të ngarkuara për zbatimin e zgjedhjeve parlamentare. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përbëhet nga nëntë anëtarë[61] të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me dy të tretën e shumicë së

59 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i spastruar), "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 54 nga 15 prilli 2013. I aksesshëm në: http://www.sobranie.mk/delovnik-na-sobranieto-na-republika-makedonija-precisten-tekst.nspx (vizita e fundit: 18 tetor 2016).

60 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, 17 nëntor 1991. I aksesshëm në: http://sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx (vizita e fundit: 18 tetor 2016).

61 Sipas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të parashikuara me Marrëveshjen e Përzhinos, KSHZ i ri përbëhet nga nëntë anëtarë, tre anëtarë të propozuar nga partitë në pushtet, tre anëtarë nga partitë opozitare dhe tre anëtarë të pavarur të zgjedhur nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, prej të cilëve kryetari ose nënkryetari zgjidhet nga radhët e pjesëtarëve të bashkësisë më të madhe joshumicë. Paraprakisht, KSHZ përbëhej nga shtatë anëtarë me mandat prej katër vitesh me një mënyrë tjetër të zgjedhjes së anëtarëve. Me fjalë të tjera, partitë opozitare e propozonin kryetarin dhe dy anëtarë të KSHZ, ndërsa partitë në pushtet e propozonin kryetarin dhe tre anëtarë të KSHZ.

votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Funksionin e ushtrojnë në mënyrë profesionale me mandat prej pesë vitesh dhe e kanë të drejtën e rizgjedhjes. Anëtarët e KSHZ zgjidhen në afat prej 30 ditësh para skadimit të afatit të përbërjes ekzistuese. KSHZ ka përbërje partiake-eksperte, me ç'rast gjashtë anëtarë të tij janë përfaqësues të partive politike të përfaqësuara në Kuvend, ndërsa tre anëtarë zgjidhen sipas propozimit të përbashkët të partive në pushtet dhe partive opozitare, përkatësisht nga radhët e kandidatëve të paraqitur. Së këtejmi, partia në pushtet me numër më të madh të deputetëve propozon dy anëtarë, partia e dytë sipas madhësisë në pushtet propozon një anëtar. Partia më e madhe politike në opozitë propozon dy anëtarë, ndërsa partia e dytë për nga madhësia në opozitë propozon një anëtar. Kryetari dhe nënkryetari i KSHZ zgjidhen nga Kuvendi nga radhët e anëtarëve të propozuar sipas propozimit të përbashkët nga partitë në pushtet dhe nga ato opozitare, me ç'rast kryetari ose nënkryetari duhet të jetë nga radhët e pjesëtarëve të bashkësisë më të madhe e cila nuk është në shumicë. KSHZ emëron sekretar të përgjithshëm i cili udhëheq me shërbimin profesional i cili i kryen punët profesionale – administrative dhe punët organizative - teknike.

Komisionet komunale zgjedhore (KKZ), të cilat formohen në nivel të çdo komune, ngarkohen për zbatimin e zgjedhjeve në territorin që është në kompetencë të tyre dhe kryejnë mbikëqyrje mbi punën e këshillave zgjedhorë. Ato përbëhen nga pesë anëtarë, prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa secili nga anëtarët ka zëvendës. Anëtarët dhe zëvendësit e KKZ zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale, me arsim të lartë për mandat prej pesë vitesh. Zgjedhjen e tyre e bën KSHZ sipas zgjedhjes së rastësishme pas pranimit të evidencës me të dhënat për administratën shtetërore dhe komunale, administratën e Qytetit të Shkupit dhe administratës publike.

Këshilli zgjedhor (KZ) është trup i cili formohet për secilin vend zgjedhor, të cilin e përbëjnë pesë anëtarë prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa për secilin prej tyre zgjidhet edhe zëvendës. Kryetari i Këshillit zgjedhor dhe zëvendësi i tij, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale, sipas zgjedhjes së rastësishme për periudhë kohore prej katër vitesh. Nga një anëtar të KZ dhe zëvendësi i tij emërohen me propozim të partive politike në opozitë, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar më së shumti vota, ndërsa një anëtar tjetër me propozim të partive politike në pushtet të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar më së shumti vota. Zgjedhja e rastësishme të anëtareve të këshillave zgjedhorë (nga radhët e administratës) e bëjnë KKZ për zonën për të cilën janë kompetentë, sipas aktit paraprak të KSHZ. Votimi jashtë vendit do të organizohet vetëm në ato PDK në të cilat janë paraqitur më së paku 10 zgjedhës, ndërsa numri i vendeve zgjedhore jashtë vendit do të përcaktohet sipas paraqitjes për votim në këto vende zgjedhore.

## E DREJTA E ZGJEDHJES AKTIVE DHE PASIVE, PROCEDURA E PARAQITJES SË KANDIDATURAVE[62]

Të drejtë vote ka shtetasi i Republikës së Maqedonisë i cili ka mbushur 18 vjet i cili është i aftë për punë. Votimi është i fshehtë dhe askush nuk ka të drejtë ta thërrasë zgjedhësin në përgjegjësi për shkak të votimit, dhe të mos kërkojë nga ai të tregoj për kë ka votuar ose pse nuk ka votuar. KSHZ është përgjegjëse t'i informojë dhe edukojë qytetarët për mënyrën e votimit dhe për realizimin e të drejtës së zgjedhjes, së këtejmi në vendvotimet dhe në paravanët e votimit afishohet udhëzimi për votim në gjuhën maqedonase, shqipe, turke, vllehe, serbe, rome dhe në gjuhën boshnjake. Listat e kandidatëve, gjithashtu, afishohen në hapësirën e votimit.

Të drejtën e kandidimit për deputet e ka secili qytetar i moshës madhore, nëse nuk është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, me dënim me burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj, vuajtja e të cilit akoma nuk ka filluar ose është në vuajtje të dënimit me burgim për vepër të kryer penale. Gjithashtu, nëse ndonjë qytetari me vendim të formës së prerë i është përcaktuar bashkëpunimi me organet e sigurisë

62 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), versioni jozyrtar i hartuar nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/izboren-zakonik/ (vizita e fundit: 19 tetor 2016); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 142 nga data 1 gusht 2016. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 19 tetor 2016).

shtetërore,[63] e drejta e ushtrimit të funksionit publik i kufizohet për një afat prej pesë vitesh nga dita e vendimit përfundimtar.[64]

Propozimi i kandidatëve për zgjedhje të deputetëve bëhet përmes paraqitjes së listës së kandidatëve në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. Së këtejmi, një kandidat mund të propozohet vetëm në një listë, ndërsa një paraqitës liste mund të paraqes vetëm një listë të kandidatëve për deputetë. Në listat e kandidatëve për deputetë, duhet më së paku 40 % të kandidatëve t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar, me ç'rast për çdo tre vende një vend i takon gjinisë më pak të përfaqësuar dhe në mënyrë plotësuese edhe më së paku nga një vend për çdo 10 vende. Ky ndryshim u inkorporua në nëntor të vitit 2015, ndërsa paraprakisht në tre vendet e para të listës më së paku një vend i përkiste gjinisë më pak të përfaqësuar.

Listat paraqiten në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik si gjuhë zyrtare oficiale në Republikën e Maqedonisë, megjithatë paraqitësi i listave në njësitë zgjedhore në të cilat më së paku 20 % e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, këtë mund ta bëjë edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdorin qytetarët në atë njësi të vetëqeverisjes lokale.

Të drejtë që të paraqesin listë të kandidatëve për deputetë kanë partitë e regjistruara politike në mënyrë të pavarur, koalicionet, si dhe grupi i zgjedhësve. Grupi i zgjedhësve në mënyrë që të mund të paraqes listë të kandidatëve nevojitet të grumbullojë më së paku 1.000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës së Zgjedhësve të njësisë zgjedhore. Grumbullimi i nënshkrimeve bëhet para njësive rajonale të KSHZ dhe para personave zyrtarë të PDK, përkatësisht para zyrave konsullore, në formular të përcaktuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Një zgjedhës mund ta jap nënshkrimin e vet për më shumë lista të kandidatëve për deputetë. Në zgjedhje të rregullta grumbullimi i nënshkrimeve fillon ditën e pesëmbëdhjetë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe zgjatë 15 ditë, ndërsa për zgjedhjet e parakohshme fillon ditën e dhjetë nga shpallja e zgjedhjeve dhe zgjatë 10 ditë. Për këto zgjedhje grumbullimi i nënshkrimeve zgjatë nga 28 tetori deri më 6 nëntor. Listat e kandidatëve për deputetë duhet të paraqiten në KSHZ deri më 11 nëntor në mesnatë.

Në rastin kur paraqitës i listës së kandidatëve është parti politike, doemos duhet të paraqes vërtetim për regjistrim nga gjykata kompetente. Kur paraqitësi i listës së kandidatëve është koalicioni, duhet ta paraqes marrëveshjen e koalicionimit ndërmjet partive. Kur paraqitës i listës është grup zgjedhësish, doemos duhet të paraqiten edhe nënshkrimet e mbledhura nga zgjedhësit. Për çdo kandidaturë nevojitet pëlqim me shkrim (deklaratë) e kandidatit që është i parevokueshëm. Listat e kandidatëve paraqiten në komisionin zgjedhor kompetent, më së voni 30 ditë, para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. KSHZ-ja, përkatësisht KKZ-të, pastaj konstatojnë nëse listat janë paraqitur në afatin ligjor dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj. Nëse konstatohen parregullsi, KSHZ-ja, përkatësisht KKZ-ja do ta thërras përfaqësuesin e autorizuar të paraqitësit të listës, përkatësisht personin e parë të nënshkruar në listën e kandidatëve, që t'i shmangin parregullsitë në afat prej 48 orësh nga pranimi i listave. Nëse pastaj, konstatohet se listat janë paraqitur në përputhje me dispozitat ligjore dhe se parregullsitë e konstatuara eventuale janë shmangur brenda afatit të caktuar, atëherë lista e paraqitur verifikohet me aktvendim. Nëse konstatohet se listat nuk janë paraqitur në kohë, përkatësisht parregullsitë ose mangësitë e konstatuara, paraqitësit e listave nuk i kanë shmangur në afat prej 48 orësh, atëherë do të miratohet aktvendim për hedhjen poshtë të listës. Paraqitësi i listës, kundër aktvendimit mund të paraqes padi në Gjykatën Administrative, në afat prej 24 orësh pas pranimit të aktvendimit, ndërkaq Gjykata, në afat prej 24 orësh, pas pranimit të padisë duhet të vendos për të njëjtën. Paraqitja e kundërshtimit dhe padisë për listat në NJZ 7 lejohet vetëm përmes rrugës elektronike, personalisht ose përmes përfaqësuesit të autorizuar.

KSHZ-ja listat, e verifikuara të kandidatëve për deputetë në njësitë zgjedhore, i shpall në shtypin ditor prej të cilëve njëri është në gjuhën e bashkësisë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën

[63] Ky vendim rezulton nga Ligji për përcaktimin e kushtit për kufizimin e ushtrimit të funksionit publik, qasjen në dokumentet dhe publikimin e bashkëpunimit me organet e sigurisë shtetërore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 86 nga data 9 korrik 2012 ose në publik i njohur si Ligji për lustracion.

[64] Ligji për ndërprerjen e vlefshmërisë të Ligjit për përcaktimin e kushtit për kufizimin e ushtrimit të funksionit publik, qasjen në dokumente dhe publikimin e bashkëpunimit me organet e sigurisë shtetërore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 143 nga data 24 gusht 2015. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/aaab4eac48b942f38b927f84b6a49dfa.pdf (vizita e fundit: 28 tetor 2016).

e Maqedonisë, më së voni 23 ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Listat, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, në afat prej 48 orësh,duhet të dërgohen në PDK-të për shkak të publikimit të tyre.

## KUFIZIMI I FUNKSIONARËVE AKTUALË[65]

Funksioni deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ushtrohet në mënyrë profesionale dhe ai nuk është në pajtim me funksionin President i Republikës, Kryetar i Qeverisë së Republikës të Maqedonisë, ministër, gjyqtar, prokuror publik, Avokat i Shtetit, Avokat i Popullit dhe me bartës të tjerë të funksioneve të cilët i zgjedh ose emëron Kuvendi ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Funksioni deputet, gjithashtu nuk është në pajtim edhe me funksionin e kryetarit të komunës apo me anëtarin e Këshillit të Vetëqeverisje Lokale, me kryerjen e punëve profesionale ose administrative në organet e administratës shtetërore, me kryerjen e veprimtarisë ekonomike ose të veprimtarisë tjetër profitabile, me anëtarësimin në këshilla drejtues të ndërmarrjeve publike, institucioneve publike, fondeve, agjencive, enteve dhe në persona të tjerë juridikë, si dhe me zgjedhjen e përfaqësuesit të kapitalit shtetëror dhe shoqëror në shoqëritë tregtare.

Nëse anëtari i Qeverisë dhe zëvendësministri ose ndonjë funksionar tjetër kandidohet për deputet, nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve nuk guxon:

- të ketë në dispozicion mjete buxhetore të Republikës së Maqedonisë, mjete të buxheteve të komunave dhe Qytetit të Shkupit, fondeve publike, ndërmarrjeve publike, institucioneve publike ose të personave juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, përveç nëse kjo ndryshe nuk është zgjidhur me ligj me të cilin rregullohet funksionimi i fushatave zgjedhore të partive politike;

[65] Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), versioni jozyrtar i hartuar nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/izboren-zakonik/ (vizita e fundit: 19 tetor 2016); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 142 nga data 1 gusht 2016. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 19 tetor 2016).



- të filloj ndërtime me mjete buxhetore, me fonde publike, ndërmarrje publike dhe me persona të tjerë juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, objekte të reja infrastrukturore, siç janë rrugë, ujësjellës, linja të tensionit të lartë, kanalizime, fusha sportive dhe objekte të tjera ose objekte për veprimtari shoqërore-shkolla, kopshte dhe objekte të tjera, përveç nëse për këtë dedikim paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, përkatësisht bëhet fjalë për realizimin e programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin rrjedhës;
- të bëjë pagesë të jashtëzakonshme të pagave, pensioneve, asistencës sociale ose pagesa të tjera me mjete buxhetore, me mjete të fondeve publike;
- të tjetërsojë kapital shtetëror;
- të nënshkruaj marrëveshje kolektive, si dhe kufizime të tjera konform Kodit Zgjedhor.

Nëse ndonjë ministër ose zëvendësministër i shkelë këto rregulla atëherë do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 500 deri më 1000 euro në kundërvlerë me denarë, ndërsa vet tentativa dhe veprimi në kundërshtim me këto rregulla ndëshkohet sipas dispozitave të Kodit Penal.

Nëse dikush nga kandidatët për deputet është pjesëtar i forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë, i pjesës së uniformuar të policisë, të personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes ose Agjencisë për Zbulim, nga dita kur do të verifikohet kandidatura e tij, marrëdhënia e punës do t'i pezullohet dhe ai person nuk guxon të marrë pjesë në fushatën zgjedhore me uniformë zyrtare.

Në mënyrë plotësuese, në periudhën kohore prej 20 ditësh, para fillimit të fushatës zgjedhore deri në përfundimin e zgjedhjes së deputetëve dhe zgjedhjes së Qeverisë, nuk mund të paguhen subvencione të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore, të organizohen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objekteve me mjete nga Buxheti ose nga fondet publike, ose me mjete të ndërmarrjeve publike ose të personave të tjerë juridikë që kanë

në dispozicion kapital shtetëror, në pjesën e infrastrukturës siç janë: rrugë, ujësjellës, linja të tensionit të lartë, kanalizime, fusha sporti dhe objekte të tjera ose objekte për veprimtari shoqërore-shkolla, kopshte dhe objekte të tjera. Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, deri në përfundimin e zgjedhjeve dhe zgjedhjes së Qeverisë, Ministria e Financave e ka për detyrë të gjitha pagesat buxhetore, përveç pagave të rregullta, pensioneve dhe shpenzimeve komunale, t'i publikojë në ueb faqen e saj, në një bazë të veçantë për shpenzimet buxhetore gjatë periudhës zgjedhore. Ministria e ka për detyrë, dy javë pas shpalljes së zgjedhjeve, të paraqes raport parazgjedhor financiar, në të cilin do të përfshihet pasqyra e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara nga Buxheti sipas zërave, në periudhën nga fillimi i vitit fiskal deri në ditën e paraqitjes së raportit, i cili publikohet në ueb faqen e saj.

## FUSHATA ZGJEDHORE[66]

Fushata zgjedhore është prezantim publik i kandidatëve nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre në periudhën parazgjedhore për zgjedhje të caktuara. Fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve, përkatësisht më 21 nëntor dhe përfundon më 9 dhjetor në ora 24:00. Dita para mbajtjes së zgjedhjeve, përkatësisht data 10 dhjetor është ditë e heshtjes parazgjedhore kur kandidatët nuk guxojnë të zhvillojnë fushatë zgjedhore, ndërsa mediat publike nuk guxojnë të bëjnë prezantim zgjedhor të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

Organizatorët e fushatës zgjedhore, më së voni 48 orë pas verifikimit të listave të kandidatëve, duhet të hapin llogari të veçantë bankare dhe vetëm përmes saj mund të financohet fushata dhe nuk mund të shfrytëzohet për dedikime të tjera. Së këtejmi, fushata mund të financohet edhe nga pagesa e anëtarësisë së partive politike dhe nga donacionet të cilat nuk mund të jenë më të larta se 3.000 euro për persona fizikë dhe 30.000 euro për persona juridikë. Fushata mund të financohet me para, sende dhe shërbime, vlera e të cilave nuk guxon t'i tejkalojë këto shuma. Nëse lartësia e donacionit është më e madhe nga shuma e lejuar, pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore e ka për detyrë që, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të donacionit, dallimin ndërmjet vlerës së lejuar dhe të donuar ta bartë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë. Pjesëmarrësit e fushatës zgjedhore kanë të drejtë të shpenzojnë më së shumti deri më 110 denarë për një zgjedhës të regjistruar në njësinë zgjedhore për të cilën ka paraqitur listë të kandidatëve, 70 denarë më pak sesa që ishte e lejuar në zgjedhjet e vitit 2014.

Fushatat zgjedhore nuk mund të financohen me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit, nga mjetet e kompensimeve të shpenzimeve për zgjedhje të cilat i posedojnë organizatorët e fushatës zgjedhore. Nuk mund të financohet as nga mjetet e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, nga mjetet e shoqatave të qytetarëve, komuniteteve fetare, grupeve religjioze dhe fondacioneve, nga mjetet e qeverive të huaja dhe institucioneve ndërkombëtare, si dhe nga mjetet e ndërmarrjeve me kapital të përbashkët ku kapitali i huaj është dominant, por edhe nga burime të paidentifikuara. Me ndryshimet e reja ligjore radiodifuzerët, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit), si dhe personat e tyre të ndërlidhur nuk guxojnë të financojnë ose t'u dhurojnë partive politike, përfshirë edhe fushata. Së këtejmi, si persona të ndërlidhur konsiderohen anëtarët e familjes, të familjes së bashkëshortit - bashkëshortes ose shokut jashtë martesor, personat të cilët kanë hise në pronësi, personat të cilët marrin pjesë në menaxhim, personat të cilët një periudhë të gjatë kohore me marketing ose me kontratë tjetër realizojnë më shumë se 30 % nga të ardhurat e reklamimit, teleshopingut dhe sponsorimit.[67]

66 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), versioni jozyrtar i hartuar nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/izboren-zakonik/ (vizita e fundit: 19 tetor 2016); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 142 nga data 1 gusht 2016. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 19 tetor 2016).

67 Nocioni "persona të ndërlidhur në mënyrë të saktë është përkufizuar në Ligjin për shërbime meidatike audio dhe audiovizive, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184 nga data 26 dhjetor 2013. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/b063254742a44129b8dfe1221762ddb4.pdf (vizita e fundit: 19 tetor 2016)

Në rast se kandidatura nuk realizohet, organizatorët e fushatës zgjedhore e kanë për detyrë donacionet e pashpenzuara në afat prej 60 ditësh tua kthejnë donatorëve. Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore e ka për detyrë menjëherë dhe më së voni në afat prej 30 ditësh, nga dita e përfundimit të fushatës zgjedhore, të paraqes raport financiar për mjetet e grumbulluara dhe të shpenzuara gjatë fushatës. Kandidatët e zgjedhur për deputetë ose të gjithë ata të cilët kanë fituar më së paku 1,5 % të votave nga qytetarët që kanë dalë të votojnë në njësinë zgjedhore kanë të drejtë kompensimi nga buxhet shtetëror në lartësi prej 15 denarë për një votë të fituar. Këto mjete paguhen më së voni deri në tre muaj pas paraqitjes së raportit financiar për fushatën.

Si pjesë të ndryshimeve ligjore të inkorporuara me Marrëveshjen e Përzhinos, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe deri në përfundimin e tyre, radiodifuzerët, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit) nuk guxojnë të publikojnë reklama të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe të gjithë personat e tjerë të cilëve me ligj u është besuar ushtrimi i autorizimeve publike.

Nëse gjatë prezantimeve publike ose raportimeve publike cenohet të drejtat e disa kandidatëve, të njëjtit kanë të drejtë menjëherë të ngrenë procedurë gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Për padi të këtillë gjykata kompetente themelore vendos në afate urgjente, ndërsa vendimi publikohet në mediat publike.

## ROLI I MEDIAVE PUBLIKE[68]

Gjatë fushatës mediat private, duke i përfshirë edhe mediat elektronike (portalet e internetit) dhe servisin radiodifuziv publik e kanë për detyrë të mundësojnë qasje të barabartë për prezantimin e programeve zgjedhore dhe të kandidatëve në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe

68 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), versioni jozyrtar i hartuar nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/izboren-zakonik/ (vizita e fundit: 19 tetor 2016); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 142 nga data 1 gusht 2016. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 19 tetor 2016).



të balancuar. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (ASHMAA)[69] e ka për detyrë ta monitoroj prezantimin zgjedhor të partive dhe kandidatëve në mediat radiodifuzive dhe elektronike (portalet e internetit)[70] nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e votimit në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve. Në rast të cenimit të parimit të qasjes së barabartë, Agjencia e ka për detyrë të ngre procedurë për kundërvajtje kundër medias përgjegjëse.

Redaktorë, gazetarë, udhëheqës të programeve dhe prezantues, të angazhuar në përgatitjen e programeve të radiodifuzerëve nuk guxojnë të marrin pjesë në aktivitete parazgjedhore të partive politike, koalicioneve, grupeve të zgjedhësve dhe përfaqësuesve të tyre, përkatësisht të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore. Nëse vendosin të marrin pjesë në aktivitete të kësaj natyre, angazhimi i tyre në programet e radiodifuzerëve iu pezullohet nga dita e shpalljes deri në përfundimin e zgjedhjeve.

Difuzeri publik, Radiotelevizioni Maqedonas (RTVM), e ka për detyrë pa kompensim t’i njoftojë qytetarët për mënyrën dhe teknikën e votimit, si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. RTVM duhet të sigurojë qasje të balancuar në programin informativ. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor sipas Marrëveshjes nga Përzhino, kjo nënkupton se 30 % e programit duhet t’i referohet ngjarjeve nga vendi dhe bota, 30 % aktiviteteve të partive të përfaqësuara në pushtet, 30 % të kohës për aktivitetet e partive në opozitë dhe 10 % të kohës për aktivitetet e partive politike jashtëparlamentare.

Gjatë kohës së fushatës zgjedhore RTVM e ka për detyrë të transmetojë prezantim politik falas pjesëmarrësve në procesin zgjedhor në përputhje

69 Ish Këshilli i Radiodifuzionit, Ligji për shërbime mediatike audio dhe audio vizive, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 184 nga 26 dhjetor 2013. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_audio_i_audiovizuelni_mediumski_uslugi_mkd_1.pdf (vizita e fundit: 27 mars 2014).

70 Edhe pse Kodi Zgjedhor e parashikon këtë detyrim të Agjencisë, në janar të vitit 2016 Agjencia doli me qëndrim se për shkak të mosekzistimit të parakushteve nuk do ta monitoroj prezantimin zgjedhor mediatik në portalet e internetit. Më shumë informacione për këtë në: ASHMAA, 2016, Qëndrimi i ASHMAA për monitorimin e raportimeve në portalet e internetit. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Stav_na_Agencijata.pdf (vizita e fundit: 4 nëntor 2016). ASHMAA, 2016, Metodologjia e monitorimit të prezantimit zgjedhor mediatik përmes serviseve programore radio dhe televizive gjatë kohës së proceseve zgjedhore. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/metodologija_za_monitoring_05.01.2016.pdf (vizita e fundit: 4 nëntor 2016).

me parimin e balancit, përkatësisht proporcionalitetit sipas numrit të listave të verifikuara të kandidatëve për deputetë, ndërsa Kanali i Kuvendit duhet të sigurojë prezantim politik falas në kohëzgjatje prej tre orësh edhe për opozitën edhe për partitë në pushtet, në përputhje me rezultatet nga zgjedhjet e fundit parlamentare, dhe një orë për paraqitësit e listave të cilët nuk janë të përfaqësuar në Kuvend. Së këtejmi, prezantimi politik falas duhet të shënohet në mënyrë përkatëse dhe të dukshme si "prezantim politik falas" gjatë gjithë kohëzgjatjes së transmetimit. Për dallim nga RTVM, radiodifuzerët nuk guxojnë të transmetojnë prezantime politike falas nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre.

Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës zgjedhore ndalohet reklamimi politik falas. Nga dita e njëjtë ndalohet edhe publikimi i reklamave të financuara nga buxheti shtetëror dhe komunal. Në periudhën e njëjtë, radiodifuzerët e kanë për detyrë ta incizojnë programin e tyre, ndërsa incizimet t'i ruajnë më së paku 30 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve, me qëllim që t'ia dërgojnë ASHMAA nëse ajo i kërkon.

Mediat duhet të përcaktojnë listë të çmimeve[71] për rekalimim politik në afat prej pesë ditësh nga shpallja e zgjedhjeve dhe t'i shpallin publikisht, ndërkaq të njëjtat nuk guxon të ndryshohen gjatë fushatës. Radiodifuzerët të cilët i mbulojnë zgjedhjet mund të transmetojnë më së shumti 18 minuta kohë shtesë për reklamim për orë reale program të transmetuar të dedikuar kryesisht për reklamime politike falas, me ç'rast veçanërisht për partitë politike në pushtet dhe për partitë opozitare parlamentare mund të ndajnë më së shumti nga tetë minuta, ndërsa për partitë parlamentare politike, të cilat nuk kanë grup deputetësh dhe për partitë politike jashtëparlamentare, mund të ndajnë nga një minutë. Kur ekziston interesim për bashkimin e blloqeve për kohën shtesë për reklamim të një partie politike në dy orë reale të njëpasnjëshme, media duhet të siguroj përfaqësim të alternuar të partive politike nga pushteti dhe opozita, në dy orë. Radiodifuzerët dhe mediat e shkruara e kanë për detyrë të paraqesin raport për hapësirën

[71] Lista e çmimeve të mediave për reklamim të paguar politik të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor për zgjedhjet parlamentare më 11 dhjetor 2016 është e aksesshme në ueb faqen e KSHZ në këtë link: goo.gl/TbAlf3.



e reklamimit të shfrytëzuar nga secili prej pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore dhe për mjetet e paguara ose të cilat duhet të arkëtohen mbi këtë bazë.

Rezultatet e sondazhit të opinionit publik në lidhje me kandidatët nuk guxon të publikohet përmes mediave publike gjatë 5 ditëve të fundit para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Gjatë publikimit të rezultateve nga sondazhi i opinionit publik, lidhur me pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, mediat e kanë për detyrë t'i theksojnë të dhënat për emrin e porositësit i cili e ka kërkuar dhe paguar sondazhin, emërtimin e institucionit që e ka realizuar sondazhin, metodologjinë e aplikuar, madhësinë dhe strukturën e modelit të sondazhit dhe periudhën brenda së cilës është zbatuar sondazhi. Rezultatet e sondazhit të opinionit publik, të zbatuar në ditën e zgjedhjeve nuk guxon të publikohen para orës 19:00, përkatësisht para mbylljes së vendeve të votimit.

## VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Të drejtë vëzhgimi të zgjedhjeve kanë organizatat e akredituara vendore, të huaja dhe ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, me ç'rast autorizimin për vëzhgim e lëshon KSHZ. Akreditim për vëzhgues mund të marrin edhe organizata qytetare vendore të regjistruara së paku një vit para mbajtjes së zgjedhjeve, të cilat në statusin e tyre e kanë inkorporuar parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Paraqitësit e listave, gjithashtu, kanë të drejtë që përfaqësues të autorizuar prej tyre ta monitorojnë punën e organeve zgjedhore.

# NJËSITË ZGJEDHORE

## NJËSITË ZGJEDHORE[72]




Njësitë zgjedhore[73]

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat do të mbahen më datë 11 dhjetor të vitit 2016 do të organizohen në nivel të 7 njësive zgjedhore (NJZ). Territori i Republikës së Maqedonisë është ndarë në 6 NJZ, ndërsa njësia e 7 zgjedhore i përfshin vendvotimet jashtë territorit të shtetit dhe i përfshin të gjithë shtetasit maqedonas me të drejtë vote të cilët jetojnë jashtë vendit.

Fill para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në vitin 2002 u miratua Ligji për njësitë zgjedhore[74] me të cilin u përcaktuan 6 NJZ në Maqedoni, me të cilat territori i shtetit ndahet në rajone zgjedhore me numër përafërsisht të njëjtë të votuesve të regjistruar. Në përputhje me Kodin

72 Për numrin e mandateve të fituara dhe votuesve të regjistruar në NJZ nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 27 prillit 2014 janë shfrytëzuar rezultatet zyrtare përfundimtare të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë. I aksesshëm në: rezultati.sec.mk/Parliamentary/Results (vizita e fundit: 15 tetor 2016).

73 Pasqyra grafike e njësive zgjedhore në Maqedoni është marrë nga faqja e internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë (KSHZ). I aksesshëm në: http://217.16.84.11/Default.aspx и на goo.gl/6Cb9e5 (vizita e fundit: 2 nëntor 2016).

74 Ligji për njësitë zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Republikën e Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43 nga data 26 qershor 2002. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/D8BCA0533D35554CA3F003112BB47F1B.pdf (vizita e fundit: 5 tetor 2016).

Zgjedhor nga viti 2016[75], numri i votuesve në një NJZ mund të lëvizë nga minus 5 deri në plus 5 për qind në raport me numrin mesatar të zgjedhësve, i cili është përafërsisht rreth 292 mijë për njësi zgjedhore. Në secilën prej këtyre 6 NJZ zgjidhen nga 20 deputetë në Kuvend sipas modelit proporcional, përkatësisht 120 nga gjithsej 123 deputetë.

Para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2011 u bënë ndryshime në Kodin Zgjedhor[76] me të cilat për herë të parë u mundësua të votojnë edhe shtetasit maqedonas të cilët gjenden jashtë shtetit. Votimi jashtë vendit u zhvillua në tri njësi zgjedhore me modelin mazhoritar të votimit. Sipas kësaj, njësia zgjedhore 7 e përfshinte Evropën dhe Afrikën, njësia zgjedhore 8 e përfshinte Amerikën Veriore dhe Jugore dhe njësia zgjedhore 9 e përfshinte Azinë dhe Australinë. Me ndryshimet ligjore të arritura me Marrëveshjen e Përzhinos u inkorporua vetëm një njësi zgjedhore për votim jashtë vendit, përkatësisht njësia zgjedhore 7 për Evropën, Afrikën, Amerikën Veriore, Amerikën Jugore, Australinë dhe Azinë, ku sipas modelit proporcional zgjidhen tre deputetë.[77] Shtetasit maqedonas jashtë vendit votojnë në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK) dhe në zyrat e konsullatave të Republikës së Maqedonisë.

Numri i vendeve zgjedhore në vend për këto zgjedhje të parakohshme parlamentare është 3 524. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014 numri i vendeve zgjedhore ishte 3 480, përkatësisht 504 vende zgjedhore më shumë në krahasim me zgjedhjet paraprake të

75 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), version jozyrtar i hartuar nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/izboren-zakonik/ (vizita e fundit: 7 tetor 2016); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142 nga 1 gushti 2016. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 7 tetor 2016).

76 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), "Gazeta Zyrtare e RM, nr. 54 nga data 14 prill 2011. I aksesshëm në: http://old.sec.mk/star/Predvremeni2011/IZBOREN_ZAKONIK_(Precisten_tekst).pdf (vizita e funtit: 3 nëntor 2016).

77 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), version jozyrtar i hartuar nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/izboren-zakonik/ (vizita e fundit: 7 tetor 2016); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142 nga 1 gushti 2016. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 7 tetor 2016).



vitit 2011. Në një vend zgjedhor nuk mund të votojnë më shumë se 1 000 votues.

Përveç ndryshimeve të dakorduara me Marrëveshjen e Përzhinos lidhur me Kodin Zgjedhor dhe shfuqizimin e tre NJZ jashtë vendit dhe bashkimin e tyre në një njësi zgjedhore - NJZ 7, në periudhën e kaluar u zhvillua debat për rikonfigurimin e kufijve të njësive zgjedhore. Kështu që, pas paraqitjes së listës së fundit të zgjedhësve nga ana e KSHZ u konstatua se në njësinë e gjashtë zgjedhore (rajoni i Tetovës-Gostivarit) pragu i votuesve është mbi limitin e lejuar prej 5 për qind (janë shënuar 5,28 %) të përcaktuar me Kodin Zgjedhor, me ç'rast rrezikohet barazia e votës. Si rezultat të situatës së krijuar, BDI e inicioni debatin për ndryshimin e kufijve të njësive zgjedhore që rezultoi me formimin e Grupit të Punës për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor në pjesën e ndryshimit të kufijve të njësive zgjedhore. Së këtejmi, BDI ofroi dy propozime për evitimin e pabarazisë ekzistuese në njësitë zgjedhore. Propozimi i parë parashikonte të riformatohet vetëm njësia e 6 zgjedhore dhe bartje të disa mijë votuesve në njësinë e pestë, përkatësisht e gjithë Dibra të bartet në NJZ 5. Sa i përket propozimit të dytë, si zgjidhje e mundshme ishte propozuar riformatimi i të gjitha njësive zgjedhore. Megjithatë, Grupi i Punës edhe përkrah këtyre propozimeve nuk pati sukses të arrijë një zgjidhje për këtë problem para shpërndarjes së Kuvendit, e që njëherësh nënkupton mbajtje të zgjedhjeve parlamentare pa njësi zgjedhore të balancuara.[78]

NJZ 1 përfshin një pjesë të Qytetit të Shkupit dhe një pjesë të Maqedonisë Qendrore, përkatësisht komunat e Shkupit: Aerodrom, Karposh, Kisella Vodë, Qendër, një pjesë të komunës Çair, Sarajin, Sopishtin, Makedonski Brodin dhe Studeniçanin. Sipas përkatësisë etnike të popullatës, shumica e votuesve janë maqedonas etnikë. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014 në këtë NJZ u regjistruan 297 686 votues të cilët votuan në 522 vende zgjedhore. Jehona në këtë njësi zgjedhore ishte 65,22 %, ndërsa më së shumti mandate fitoi koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE – 8, koalicioni i LSDM – 7, BDI – 3, PDSH – 1 dhe OPQM – 1.

78 "Gjashta – asi nga mënga për kontestimin e zgjedhjeve", Dojçe Vele 19 tetor 2016. I aksesshëm në: www.dw.com/mk/шестката-кец-од-ракав-за-оспорување-на-изборите/a-36085391 (vizita e fundit: 3 nëntor 2016).

NJZ 2 gjithashtu përfshin një pjesë të Qytetit të Shkupit dhe një pjesë të Maqedonisë Veriore me përbërje të ekuilibruar të popullsisë, maqedonas etnikë, shqiptarë, ndërsa janë të pranishëm edhe serbet dhe romët. Kjo NJZ i përfshin komunat e Shkupit: Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, një pjesë të komunës Çair, Shuto Orizarën, Haraçinën, një pjesë të Kumanovës, Likovën, një pjesë të Nagoriçanit të Vjetër dhe Çuçer Sandevën. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014 në NJZ 2 u regjistruan 306 067 votues të cilët votuan në 504 vende zgjedhore. Jehona e votuesve ishte 60,18 %, ndërsa më së shumti mandate fitoi koalicioni i VMRO-DPMNE – 10, i dyti ishte koalicioni i LSDM me 5 mandate, pastaj BDI me 4 dhe PDSH me 1 mandat.

NJZ 3 përfshin pjesë të Maqedonisë Qendrore, Lindore dhe Veriore, kjo NJZ i përfshin komunat: Berovë, Veles, Vinicë, Gradsko, Dellçevë, Zelenikovë, Zërnovcë Ilinden, Karbincë, Koçani, Kratovë, Kriva Pallankë, një pjesë të Kumanovës, Llozovën, Makedonska Kamenicën, Petrovecin, Pehçevën, Probishtipin, Rankovcin, Shën Nikollën, një pjesë të Nagoriçanit të Vjetër, Çashkën, Çeshinovën- Obleshevën dhe Shtipin. Dominon popullsia me përkatësi etnike maqedonase. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014 në NJZ 3 u regjistruan 280 890 votues të cilët votuan në 682 vende zgjedhore. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 jehona e votuesve ishte 70,80 %, me ç'rast më së shumti mandate fitoi koalicioni i VMRO-DPMNE – 13, ndërsa i dyti ishte koalicioni i LSDM me 7 mandate.

NJZ 4 e përfshin territorin e Maqedonisë Juglindore. Në këtë NJZ përfshihet një pjesë e qytetit të Manastirit, Bogdanci, Bosileva, Vallandova, Vasileva, Gjevgjelia, Demir Kapia, Dojrani, Kavadarci, Konçe, një pjesë e Krivogashtanit, Mogilla, Negotina, Novaci, Novo Sella, Prilepi, Radovishi, Rosomani dhe Strumica. Në këtë NJZ dominon popullsia me përkatësi etnike maqedonase. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014 në NJZ 4 u regjistruan 280 810 votues të cilët votuan në 599 vende zgjedhore. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, jehona e votuesve ishte 73,14 %, ndërsa më së shumti mandate fitoi koalicioni i VMRO-DPMNE – 12, ndërsa LSDM – 8 mandate.

NJZ 5 e përfshin territorin e Maqedonisë Jugperëndimore. Kjo njësi e përfshin një pjesë të qytetit të Manastirit, Vevçanin, një pjesë të Dibrës, Debërcën, Demir Hisarin, Dollnenin, një pjesë të Kërçovës, një pjesë të Krivogashtanit, Krushevën, Ohrin, Pllasnicën, Resnjën, Strugën dhe Qendrën Zhupa. Shumica e popullsisë është e përkatësisë etnike maqedonase, por një pjesë e konsiderueshme e votuesve janë të përkatësisë etnike shqiptare. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014 në NJZ 5 u regjistruan 286 435 votues të cilët votuan në 655 vende zgjedhore. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, jehona ishte 61,24 %, ndërsa më së shumti mandate fitoi koalicioni i VMRO-DPMNE – 11, LSDM – 6 dhe BDI- 3 mandate.

NJZ 6 e përfshin territorin e Maqedonisë Veriperëndimore. Kjo NJZ e përfshin: Bogovinën, Bërvenicën, Vrapçishtin, Gostivarin, një pjesë të Dibrës, Zhelinën, Jegunocin, një pjesë të Kërçovës, Mavrovën dhe Rostushën, Tearcën dhe Tetovën. Në këtë njësi zgjedhore dominon popullsia me përkatësi etnike shqiptare. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014 në NJZ 6 u regjistruan 304 458 votues të cilët votuan në 516 vende zgjedhore, ndërsa jehona ishte 49,69 %. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 në këtë NJZ më së shumti mandate fitoi BDI- 9, në vend të dytë ishte PDSH me 5, pastaj koalicioni i VMRO-DPMNE me 4, ndërsa RDK dhe koalicioni i LSDM fituan nga 1 mandat.

NJZ 7 i përfshin të gjithë shtetasit maqedonas të cilët jetojnë ose janë me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, përkatësisht në shtetet e Evropës, Afrikës, Amerikës Veriore, Amerikës Jugore, Australisë dhe Azisë. NJZ 7 tani i përfshin të gjithë shtetasit maqedonas jashtë vendit të cilët sipas modelit proporcional mund të zgjedhin 3 deputetë. Mandatet e deputetëve shpërndahen sipas formulës së D'Hont-it. Në mënyrë që mund të votojnë jashtë vendit, shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët janë me punë ose qëndrim të përkohshëm jashtë vendit me vendbanim të paraqitur të fundit në Republikën e Maqedonisë para zgjedhjeve duhet të paraqiten në PDK/zyrën konsullore respektive që të votojnë. Së këtejmi, ata regjistrohen në një ekstrakt të veçantë të Listës së Zgjedhësve. Paraqitja mund të bëhet përmes dorëzimit të deklarimit, i cili duhet të nënshkruhet dora vet, ose të dërgohet me postë elektronike. Numri i vendeve zgjedhore jashtë vendit është

variabil, ndërkaq nuk do të caktohet vend zgjedhor në PDK/ zyrën konsullore nëse për votim paraqiten më pak se 10 votues.

Për zgjedhjet parlamentare të vitit 2011 dhe 2014 votimi jashtë vendit zhvillohej në tre njësi zgjedhore. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014 në NJZ 7 (Evropa dhe Afrika) u regjistruan 18 911 votues të cilët patën mundësi të votojnë në 27 vende zgjedhore në PDK ose në zyrat konsullore të Republikës së Maqedonisë, ndërsa jehona ishte 45,55 %. Mandatin në NJZ 7 - Evropa dhe Afrika e fitoi koalicioni i VMRO-DPMNE. Në NJZ 8 (Amerika Veriore dhe Jugore) në vitin 2014 u regjistruan 3 337 votues, votimi u zhvillua në 6 vende zgjedhore, ndërsa jehona ishte 55,29 %. Mandatin e fitoi koalicioni i VMRO-DPMNE. NJZ 9 në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 përfshiu 3 vende zgjedhore në Australi dhe në shtetet e Azisë. Atje për votim u paraqitën 1 534 votues, jehona ishte 64,02 %, ndërsa mandatin e fitoi koalicioni i VMRO-DPMNE.

# PASQYRA E PJESËMARRËSVE NË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE 2016

## PASQYRA E PJESËMARRËSVE NË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE 2016

Në përputhje me Agjendën për realizimin e veprimeve zgjedhore lidhur me zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të miratuar nga KSHZ, deri në afatin e fundit 11 dhjetor 2016, gjithsej 13 parti politike dhe koalicione paraqitën lista të kandidatëve për zgjedhjen e deputetëve. Pas shqyrtimit të kandidaturave, KSHZ miratoi aktvendim për pranimin e 11 kandidaturave[79]. Dy kandidatura u hodhën poshtë, përkatësisht kandidatura e Partisë Socialdemokrate të Maqedonisë dhe Lëvizjes Popullore për Maqedoni.[80] Kjo nënkupton se në këto zgjedhje 1 784 524 qytetarë me të drejtë vote do të kenë mundësi të votojnë për 11 subjekte politike, përkatësisht për gjashtë parti politike dhe pesë koalicione me 58 lista të kandidatëve. Në NJZ 7 për diasporën, gjithsej 20 573 qytetarë do ta realizojnë të drejtën e tyre të votës.

Në këtë Manual do të prezantohen të gjitha partitë politike, koalicionet, si dhe bartësit e listave të kandidatëve të cilët do të marrin pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Katër partitë më të mëdha parlamentare VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH, do të prezantohen më detajisht. Radhitja e partive dhe koalicioneve korrespondon me radhitjen që do ta kenë në fletëvotime[81].

79 Konkluzion për verifikimin e listave të kandidatëve të cilët do të marrin pjesë në zgjedhjet e parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë – 11 dhjetor të vitit 2016. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 17 nëntor 2016. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zcVZ4Z1NEb2Y2bFU/view (vizita e fundit: 20 nëntor 2016).

80 Kandidaturat u hodhën poshtë meqë përmbanin parregullsi të caktuara. Pasi që KSHZ e publikoi aktvendimin për hedhjen poshtë të kandidaturave, të dy partitë ngritën padi përmes KSHZ deri te Gjykata Administrative e RM. Gjykata i refuzoi paditë dhe i konfirmoi vendimet për hedhjen poshtë të listave të kandidatëve të miratuara nga KSHZ.

81 Filloi fushata për zgjedhjet e parakohshme të 11 dhjetorit, Telma, 21 nëntor 2016. I aksesshëm në: http://telma.com.mk/vesti/pochna-kampanjata-za-predvremnite-izbori-na-11-dekemvri (vizita e fundit: 22 nëntor 2016).

## PARTITË POLITIKE, KOALICIONET DHE BARTËSIT E LISTAVE TË KANDIDATËVE[82]

### VMRO-DPMNE

VMRO-DPMNE është parti e cila deklarohet si parti popullore e qendrës së djathtë, me proveniencë ideologjike demokristiane. Nga pavarësimi e deri më sot, VMRO-DPMNE është njëra nga dy partitë më të mëdha në Maqedoni. Ka marrë pjesë thuaja se në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale, me përjashtim të zgjedhjeve parlamentare në vitin 1994, kur e bojkotuan rrethin e dytë. Në zgjedhjet e treta parlamentare të mbajtura në vitin 1998, me 49 mandate të fituara në koalicion me Alternativën Demokratike e cila fitoi 13 deputetë dhe PPDSH – PPD (më vonë PDSH) me 11, si dhe disa parti të vogla, VMRO-DPMNE për here të parë e formoi Qeverinë. VMRO-DPMNE mbeti në pushtet deri në vitin 2002, por gjatë kohës së konfliktit nga muaji maj deri në muajin nëntor të vitit 2001 u formua Qeveri e koalicionit të gjerë, e cila përfshiu edhe ministra nga LSDM dhe PLD. Në vitin 2002, VMRO-DPMNE bashkë me partnerët e koalicionit fitoi 33 mandate të deputetëve, i humbi zgjedhjet dhe funksionoi si opozitë deri në vitin 2006. Në vitin 2006 bashkë me Koalicionin "Për një Maqedoni më të mirë" përsëri fitoi në zgjedhjet parlamentare duke fituar gjithsej 45 vende të deputetëve dhe e formoi Qeverinë. Në këto zgjedhje partia, për herë të parë, u paraqit me program konkret dhe afate konkrete, e që ishte risi në garat zgjedhore. Prej atëherë e deri më sot VMRO-DPMNE fitoi edhe në tre cikle zgjedhore në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2008, 2011 dhe 2014. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008 bashkë me Koalicionin "Për një Maqedoni më të mirë" fitoi 63 vende rekord të deputetëve. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011 bashkë me koalicionin kjo parti fitoi 56 vende të deputetëve. VMRO-DPMNE në legjislaturën e fundit të Kuvendit kishte 52 deputetë, ndërsa bashkë me partnerët e koalicionit kishin 61 deputetë nga gjithsej 123 deputetë në Kuvend.

[82] Logot e partive dhe fotografitë e bartësve të listave të kandidatëve janë shkarkuar nga faqja e Internetit të partive respektive, nga institucione të caktuara publike dhe nga Fejsbuk profilet zyrtare të kandidatëve. Për të gjitha logot dhe fotografitë si burim e kemi përdorur Internetin.



Kryetar i VMRO-DPMNE nga themelimi deri në vitin 2003 ishte Lubço Georgievski. Në Kongresin e partisë në maj të vitit 2003 Georgievski dha dorëheqje, ndërsa në vend të tij u zgjodh Nikolla Gruevski i cili është në krye të partisë deri në ditët e sotme. Gruevski nga viti 2006 deri në janar të vitit 2016 ishte Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE e posedon pushtetin edhe në nivel lokal. Pas zgjedhjeve të fundit lokale në vitin 201383 kandidatët e saj janë në krye të 57 komunave nga gjithsej 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit.




Koalicioni "Për një Maqedoni më të mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përbëhet nga 24 parti: Partia Socialiste e Maqedonisë (PSM), Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni (PDSM), Lidhja e Romëve të Maqedonisë (LRM), Partia e Drejtësisë (PD), Opsioni Qytetar për Maqedoninë – OPQM, Partia e Aksionit Demokratit në Maqedoni (PADM), Partia e Vllehëve të Maqedonisë (PVM), Partia për Integrimin e Romëve (PIR), Partia Punëtore Bujqësore e Republikës së Maqedonisë, Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas, Aksioni Maqedonas (MAAK), Partia e Re Liberale, Partia e Demokratëve të Bashkuar të Maqedonisë, Aleanca Maqedonase, Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni, VMRO – PD (VMRO-Partia Demokratike), Partia Demokratike Boshnjake, Partia Demokratike e Romëve, Unioni Socialdemokrat, Romët e Bashkuar nga Maqedonia, Lidhja e Forcave të Majta të Titos, Partia e Bashkuar për Barazinë e Romëve, Lëvizja për Unitetin Nacional të Turqve, Forcat Demokratike të Romëve.

Për këto zgjedhje, Koalicioni "Për një Maqedoni më të mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE paraqiti lista të kandidatëve në të gjitha shtatë njësitë zgjedhore.

[83] Rezultatet përfundimtare nga zgjedhjet lokale 2013, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 1 majj 2013. I aksesshëm në: http://217.16.84.17/Results.aspx?RaceID=1&UnitID=1&IsPS=0&Turnout=0&LangID=1 (vizita e fundit: 3 prill 2014).

**VMRO-DPMNE**
Rr. "Maqedonia" 17a
1000 Shkup
contact@vmro-dpmne.org.mk
www.vmro-dpmne.org.mk

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË VMRO-DPMNE DHE KOALICIONIT "PËR NJË MAQEDONI MË TË MIRË"



**NJZ 1 – Nikolla Poposki** është zëvendës aktual i Kryetarit të Qeverisë dhe Ministër i Punëve të Jashtme. Në të kaluarën ka ushtruar një sërë funksionesh në institucionet evropiane, ndërsa nga viti 2010 deri në vitin 2011 u nominua për ambasador, Shef i Misionit të RM-së pranë Bashkimit Evropian. Nga viti 2004 është magjistër i gjuhëve të huaja dhe tregtisë ndërkombëtare pranë Universitetit në Rem, Francë dhe Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup, ndërsa nga viti 2005 edhe magjistër i studimeve Ekonomike Evropiane pranë Kolegjit të Evropës në Brizh – Belgjikë. Ka lindur në vitin 1977 në Shkup. Poposki në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014 ishte bartës i listës së kandidatëve në NJZ 6.



**NJZ 2 – Nikolla Todorov** është Zëvendës i Kryetarit të Qeverisë dhe Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e RM-së dhe anëtar i KE të VMRO-DPMNE. Nga viti 2006 ushtron një sërë funksionesh në ndërmarrjet publike, ndërsa nga viti 2009 deri në vitin 2011 ishte Ministër i Arsimit dhe Shkencës në Qeverinë e RM-së. Nga viti 2011 është zgjedhur për Ministër të Shëndetësisë. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Ka lindur në vitin 1979 në Shkup. Todorovi në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014 ishte bartës i listës së kandidatëve në NJZ 3.



**NJZ 3 – Ilija Dimovski** është koordinator i grupit të deputetëve të VMRO-DPMNE në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Mandatin e parë në Kuvend e fitoi në vitin 2006. Ky është mandate i tij i katërt. Ka lindur në vitin 1980 në Veles. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik "Justiniani I" pranë Universitetit "Shën Cirli e Metodi" në Shkup.



**NJZ 4 – Nikolla Gruevski** ishte Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (RM) deri në janar të vitit 2016, kur në përputhje me Marrëveshjen e Përzhinos dha dorëheqje. Është kryetar i VMRO-DPMNE. Në funksionin e Kryetarit të Qeverisë erdhi pas fitores në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006. Gruevski në jetën politike është i pranishëm nga viti 1998 deri në vitin 1999, me ç'rast i ka ushtruar funksionet ministër pa resor dhe Ministër i Tregtisë. Në periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2002 e ushtron funksionin e Guvernatorit të RM-së në Bankën Botërore dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ndërsa pastaj edhe Ministër i Financave. U zgjodh për deputet në Kuvend në legjislaturën nga viti 2002 deri në vitin 2006, ndërsa nga viti 2003 është lider i VMRO-DPMNE. Ka lindur në vitin 1970 në Shkup. Nga viti 2006 Gruevski është magjistër i shkencave ekonomike pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Shën Cirili e Metodi" Shkup, ndërsa ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik – Prilep pranë Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit" - Manastir.



**NJZ 5 – Antonio Milloshoski** është deputet dhe Nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Në periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2000 është shef i Kabinetit të Nënkryetares së Qeverisë së RM-së, Dosta Dimoska, ndërsa nga viti 2000 deri në vitin 2001 është zëdhënës i Qeverisë. Në zgjedhjet e vitit 2006 u zgjodh për deputet në Kuvendin e RM-së. Menjëherë, pastaj është zgjedhur për Ministër i Punëve të Jashtme, funksion të cilin e ushtroi deri në vitin 2011, kur pas

zgjedhjeve parlamentare dha dorëheqje nga funksioni i ministrit dhe u kthye në Parlament. Milloshoski nga viti 2002 është magjistër i euro-integrimeve pranë Universitetit Fridrih Vilhelm në Bon – Gjermani. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – Shkup. Ka lindur në vitin 1976 në Tetovë. Ishte bartës i listës zgjedhore në NJZ 5 në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, 2008, 2011 dhe 2014.



**NJZ 6 – Vlladimir Gjorçev** është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga viti 2006, ndërsa ky është mandati i tij i katërt. Ka lindur në vitin 1978 në Shkup. Ka diplomuar në studimet politike në Fakultetin Juridik "Justiniani I" pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, 2008 dhe 2011 ishte bartës i listës në NJZ 3.



**NJZ 7 – Ramazan Miftaroski**[84] me origjinë është nga Mogorçja e Dibrës. Jeton në Venecia të Italisë.

84 Për këtë kandidat për deputet në Kuvend nga NJZ 7 nuk mund të gjenden më shumë informacione biografike nga këto që i kemi dhënë.

## PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE

Partia Demokratike Shqiptare u themelua në qershor të vitit 1997 me bashkimin e Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH) dhe Partisë Demokratike Popullore (PDP). PPDSH u themelua në vitin 1994 pasi që krahu radikal i Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD), Arbër Xhaferi dhe Menduh Thaçi, e braktisën partinë e tyre amë. PDSH u deklarua si parti e qendrës së djathtë dhe angazhohet për të drejta më të mëdha të shqiptarëve në Maqedoni dhe për ripërkufizimin e kornizës kushtetuese të vendosur me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Kryetar i PDSH është Menduh Thaçi, i cili në këtë funksion është zgjedhur më datë 30 qershor të vitit 2007. Thaçi e merr këtë funksion pas dorëheqjes së ish-kryetarit Arbër Xhaferi.

Në zgjedhjet e vitit 1998 PDSH fitoi 11 vende të deputetëve dhe u bë pjesë e Qeverisë së RM e udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Gjatë kohës së konfliktit në vitin 2001, PDSH ishte pjesë e Qeverisë së Koalicionit të gjerë e cila më vonë e nënshkroi Marrëveshjen Kornizë. Nënshkrues i Marrëveshje Kornizë nga PDSH ishte kryetari i atëhershëm Arbër Xhaferi. Pas shpërbërjes së Qeverisë, PDSH mbeti në Koalicionin qeveritar. Në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2002 PDSH fitoi 5,2% të votave, përkatësisht 7 mandate dhe u bë opozitë në Kuvend. PDSH përsëri kthehet në pushtet kur pas zgjedhjeve të vitit 2006 me sukses i përfundoi negociatat me VMRO-DPMNE, e cila e fitoi mandatin për formimin e Qeverisë. Në këto zgjedhje PDSH fitoi 7,5% të votave, përkatësisht 11 mandate të deputetëve, numër ky i cili ishte më i ulët nga mandatet e partisë rivale BDI. Në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2008, PDSH përsëri fitoi 11 mandate. Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008 partia më e madhe parlamentare VMRO-DPMNE e ndërpreu partneritetin tradicional me PDSH dhe formoi koalicion me partinë më të madhe shqiptare në Parlament, BDI. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011 PDSH fitoi 8 mandate. Në legjislaturën e fundit të Parlamentit PDSH kishte 7 deputetë.

Në nivel lokal pas zgjedhjeve të fundit lokale të vitit 2013 kjo parti fitoi një kryetar komune nga gjithsej 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit.

Për këto zgjedhje, partia paraqiti lista të kandidatëve në pesë njësi zgjedhore, përkatësisht në NJZ 1, NJZ 2, NJZ 3, NJZ 5 dhe NJZ 6.

**Partia Demokratike Shqiptare**
Sheshi "Iliria" Tetovë 15/1
1200 Tetovë
info@gurra-pdsh.org
www.pdsh.info

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË PDSH



**NJZ 1 – Idriz Orana**[85] me profesion është mjek. Njëkohësisht e ushtron edhe funksionin anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit.



**NJZ 2 – Orhan Ibraimi** është deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit, dhe njëkohësisht zëvendës koordinator i grupit të deputetëve të PDSH. Ka lindur në vitin 1964 në fshatin Opajë, Likovë. Ka diplomuar në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit" në Manastir.

85 Për këtë kandidat për deputet në Kuvend nga NJZ 1 nuk mund të gjenden më shumë informacione biografike nga këto që i kemi dhënë.



**NJZ 3 – Sami Rushidi**[86].



**NJZ 5 – Adrian Useini**[87] me profesion është avokat. Ka lindur në fshatin Dollogozhdë, Strugë.



**NJZ 6 – Menduh Thaçi** është deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM-së dhe është kryetar i PDSH. Thaçi është deputet në Kuvend nga viti 2002. Nga viti 1997 deri në vitin 2006 e ushtron funksionin e nënkryetarit të partisë, ndërsa pas tërheqjes së liderit Arbër Xhaferi, bëhet kryetar i PDSH. Ka diplomuar për stomatologji në Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit të Prishtinës - Kosovë. Thaçi në më shumë cikle zgjedhore për deputetë në Kuvend është bartës i listës së kandidatëve në NJZ 6.

86 Për këtë kandidat për deputet në Kuvend nga NJZ 3 nuk mund të gjenden të dhëna themelore biografike.

87 Për këtë kandidat për deputet në Kuvend nga NJZ 5 nuk mund të gjenden më shumë informacione biografike nga këto që i kemi dhënë.

## BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Bashkimi Demokratik për Integrim lindi nga pjesëtarët e ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e cila e filloi konfliktin e armatosur në vitin 2001. Nga pikëpamja ideologjike, BDI deklarohet si parti e qendrës së majtë e cila angazhohet për të drejtat e shqiptarëve dhe për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Partia u formua në vitin 2002 dhe për herë të parë mori pjesë në zgjedhjet parlamentare në vitin e njëjtë, me ç'rast e fitoi numrin më të madh të votave nga elektorati etnik shqiptar, kështu që siguroi gjithsej 16 vende të deputetëve dhe u bë pjesë e Qeverisë të udhëhequr nga LSDM. Që nga themelimi e deri më sot, kryetar i kësaj partie është Ali Ahmeti. BDI ishte pjesë e Qeverisë nga viti 2002 deri në vitin 2006, me ç'rast ishte e përfaqësuar me numër më të madh të ministrave të cilët një parti shqiptare i ka pasur në qeveritë e RM-së. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 BDI përsëri e fitoi numrin më të madh të votave nga elektorati shqiptar (12,2%) përkatësisht 17 vende të deputetëve, megjithatë pas negociatave të pasuksesshme me VMRO-DPMNE nuk u përfshi në koalicionin e atëhershëm qeveritar. Si rezultat i kësaj BDI e bojkotoi punën e Kuvendit në një periudhë kohore nga viti 2006 deri në vitin 2008, kur edhe u shpallën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2008 BDI fitoi 12,8% të votave, përkatësisht 18 vende të deputetëve, dhe si parti më e madhe politike me të cilën përfaqësohen shqiptarët etnikë u bë pjesë e Qeverisë në krye me Nikolla Gruevskin. Në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2011, BDI përsëri është partia e tretë për nga madhësia në Maqedoni duke fituar 14 vende të deputetëve. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 BDI fitoi 19 vende të deputetëve dhe e formoi Qeverinë bashkë me VMRO-DPMNE.

Në nivel lokal pas zgjedhjeve të fundit lokale të vitit 2013, BDI fitoi 14 kryetarë të komunave nga gjithsej 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit.

Për këto zgjedhje, partia paraqiti lista të kandidatëve në të gjitha shtatë njësitë zgjedhore.

**Bashkimi Demokrati për Integrim**
Rr. "Reçica e Vogël"
1200 Tetovë
tel: 044 334 398
press@bdi.mk
www.bdi.mk

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË BDI



**NJZ 1 – Artan Grupi** është deputet në legjislaturën e fundit të Kuvendit të RM. Ka lindur në vitin 1997 në Shkup. Është magjistër i mediave dhe komunikimit dhe doktorant i shkencave politike.



**NJZ 2 – Ejup Alimi** është sekretar shtetëror në Sekretariatin për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Nga viti 2005 deri në vitin 2009 e ushtroi funksionin e këshilltarit në Këshillin Komunal të Çairit. E ka ushtruar funksionin e koordinatorit të grupit të këshilltarëve të BDI-së dhe kryetarit të Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Ka lindur në vitin 1980 në fshatin Tanushë, Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës.



**NJZ 3 – Nafi Durmishi**[88] është student i Fakultetit të Mjekësisë në Tetovë. Me origjinë është nga rajoni i Velesit.

88 Për kandidatët për deputet në Kuvend nga NJZ3, NJZ4, NJZ5 dhe NJZ7 nuk mund të gjenden më shumë të dhëna biografike nga të dhënat e prezantuara.



**NJZ 4 – Artin Spahiu** është drejtor i Pallatit të Kulturës në Dibër. Ka lindur në Dibër. Ka studiuar në Universitetin Shtetëror të Tetovës.



**NJZ 5 – Agim Shaqiri** origjinën e ka nga fsh. Labënisht - Strugë.



**NJZ 6 – Ali Ahmeti** është deputet i legjislaturës së fundit të Kuvendit të RM-së dhe lider i BDI. Ai është lider i BDI që nga themelimi i saj në vitin 2002. Në konfliktin e vitit 2001 ishte komandanti suprem dhe lider politik i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Në vitin 1983 ka diplomuar për filozofi në Universitetin e Prishtinës, Kosovë. Ka lindur në vitin 1959 në fshatin Zajas – Kërçovë. Ahmeti për herë të gjashtë është bartës i listës së kandidatëve në NJZ 6.



**NJZ 7 – Xhevdet Spahiu** është biznesmen i cili punon dhe jeton në Cyrih, Zvicër.

## LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë deklarohet si parti e qendrës së majtë, me proveniencë ideologjike socialdemokrate. Ajo, aktualisht, për nga madhësia është partia e dytë në Maqedoni. U themelua në Kongresin e mbajtur më 21 prill të vitit 1991 si pasardhëse juridike e Lidhjes së Komunistëve të Maqedonisë – Partia për Transformim Demokratik (LKM-PTD). Po atë vit, partia e ndryshoi emrin në LSDM, ndërsa ideologjinë nga komuniste në socialdemokrate. Ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale nga pavarësimi e deri më sot. Në vitin 1992 pas shpërndarjes së Qeverisë së parë eksperte, LSDM edhe pse nuk e kishte shumicën në Kuvend, e mori mandatin dhe e formoi Qeverinë e parë politike të Republikës së Maqedonisë. Në periudhën kohore nga viti 1994 deri në vitin 1998 partia e fitoi shumicën në Kuvend dhe bashkë me partnerët e koalicionit në zgjedhjet e vitit 1994 fitoi 85 vende të deputetëve, por pastaj në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998 e humbi pushtetin dhe fitoi 27 vende të deputetëve. LSDM është partia më e madhe opozitare deri në vitin 2002, kur përsëri i fitoi zgjedhjet me 60 vende të deputetëve bashkë me partnerët e koalicionit dhe ishte në pushtet deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2006. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 koalicioni i LSDM fitoi 32 vende të deputetëve. Prej atëherë e deri më sot LSDM është në opozitë, pasi që humbi edhe në tre cikle të tjera zgjedhore, në vitin 2008, 2011 dhe 2014. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008 bashkë me koalicionin fitoi 27 vende të deputetëve, ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011 LSDM me koalicionin fitoi 42 vende të deputetëve. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2014 LSDM fitoi 27 vende të deputetëve, ndërsa koalicioni gjithsej fitoi 34 vende të deputetëve.

Kryetar i partisë nga pavarësimi i shtetit dhe transformimit nga LKM-PTD në LSDM nga viti 1991 deri në vitin 2004 ishte Branko Cërvenkovsi. Nga kjo pozitë u tërhoq për shkak të fitores në zgjedhjet e jashtëzakonshme presidenciale në vitin 2004, me ç'rast u bë President i RM. Në Kongresin e jashtëzakonshëm të LSDM në nëntor të vitit 2004 për kryetar u zgjodh

Vllado Buçkovski, i cili do të jetë në krye të partisë deri në humbjen e zgjedhjeve në vitin 2006. Pas zgjedhjeve Buçkovskit iu votua mosbesim dhe në Kongresin e jashtë radhës, në nëntor të vitit 2006, për kryetare u zgjodh Radmilla Sheqerinska. Në pozitën e kryetares së LSDM, Radmilla Sheqerinska qëndroi deri në muajin qershor 2006 kur paraqiti dorëheqje të parevokueshme për shkak të humbjes në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në shtator të vitit 2008 në Kongresin e 8 të kësaj partie për kryetar u.d. u zgjodh Zoran Zaev. Në vitin 2009 pas skadimit të mandatit të Presidentit, në Kongresin partiak përsëri në krye të LSDM kthehet Branko Cërvenkovski. Ai do të jetë lider i partisë deri në vitin 2013, kur edhe tërhiqet nga pozita, ndërsa në vendin e tij përsëri zgjidhet kryetari aktual i partisë, Zoran Zaev.

Partia është në opozitë edhe në nivelin lokal. Pas zgjedhjeve të fundit lokale të vitit 2013, LSDM e ka pushtetin në katër nga gjithsej 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit.

Koalicioni i Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) i udhëhequr nga LSDM përbëhet nga 13 parti: Partia e Re Socialdemokrate (PRSD), Partia Liberal Demokrate (PLD), Partia për Lëvizjen e Turqve në Maqedoni (PLT), Alternativa e Re (AR), Lidhja Demokratike e Vllehëve të Maqedonisë (LDVM), Partia Serbe në Maqedoni (PSM), Partia për Ndryshime Ekonomike ("PNE 21"), Partia e Pensionistëve dhe Qytetarëve të Bashkuar të Maqedonisë (PPQBM), Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE), Aleanca për Maqedoni Pozitive (AMP), Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë (RDM), Partia Përparimtare Serbe në Maqedoni (PPSM) dhe Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve (PEPR).

Për këto zgjedhje partia paraqiti lista të deputetëve në të gjitha shtatë njësitë zgjedhore.

**Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë**
Rr. "Bihaçka" nr. 8 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
web@sdsm.org.mk
www.sdsm.org.mk

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË KOALICIONIT LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË



**NJZ 1 – Stevo Pendarovski** është profesor inordiner në Fakultetin e Shkencave Politike pranë Universitetit "Amerikan Kolegj", Shkup. Në vitin 1990 e ka ushtruar funksionin e ndihmës-ministrit të Punëve të Brendshme dhe Kryeshef i Drejtorisë për Analitikë dhe Hetim në MPB. Në periudhën kohore 2004/2005 është kryetar i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa në periudhën 2001-2004 dhe 2005-2009 është këshilltar për Siguri Nacionale dhe për Politikë të Jashtme të dy presidentëve. Në vitin 2014 ishte kandidat i propozuar nga LSDM për president të RM-së. Ka lindur në vitin 1963 në Shkup, ka diplomuar në Fakultetin Juridik "Justiniani I" pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi". Në universitetin e njëjtë i kryen edhe studimet pasuniversitare dhe të doktoratës.



**NJZ 2 – Oliver Spasovski** është Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë. Konform Marrëveshjes së Përzhinos, Spasovski u zgjodh për Ministër të Punëve të Brendshme në Qeverinë e cila është angazhuar për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016. Spasovski u zgjodh për deputet në Kuvend në dy mandate (2006-2008 dhe 2011-2014). Ka lindur në Kumanovë në vitin 1976. Ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin Juridik "Justiniani I" pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup.



**NJZ 3 – Lupço Nikollovski** është shef i kabinetit të kryetarit të LSDM dhe anëtar i Këshillit Ekzekutiv të LSDM. Konform Marrëveshjes së Përzhinos, Nikollovski u zgjodh për Zëvendësministër shtesë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave në Qeverinë e angazhuar për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016. Ka lindur në Kriva Pallankë në vitin 1983, ndërsa ka

diplomuar në Fakultetin Juridik "Justiniani I" pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Për momentin është magjistrant në fakultetin e njëjtë në drejtimin e drejta administrative dhe administrata publike.



**NJZ 4 – Zoran Zaev** është kryetar i Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë dhe kryetar i Komunës së Strumicës. Me fitoren në zgjedhjet lokale të vitit 2013 e filloi mandatin e tij të tretë si kryetar komune. Në periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2005 ishte deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Ai është kryetar i LSDM nga viti 2013. Ka lindur në Strumicë në vitin 1974. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup, ndërsa në fakultetin e njëjtë aktualisht është regjistruar në studime pasuniversitare në drejtimin ekonomi monetare dhe financa.



**NJZ 5 – Radmilla Sheqerinska** është zëvendëskryetare e Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë. Në karrierën e saj politike, Sheqerinska u zgjodh në katër mandate për deputete (1998-2002, 2006-2008, 2008-2011 dhe 2011-2014). Nga viti 2002 deri në 2006 ishte Zëvendëskryetare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë e ngarkuar për eutointegrimet dhe koordinatore për asistencën nga jashtë. Nga viti 2006 deri në vitin 2008 ishte kryetare e LSDM. Ka lindur në Shkup në vitin 1972. Ka diplomuar në Fakultetin Elektroteknik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Është magjistre për marrëdhënie ndërkombëtare në Shkollën Juridike dhe të Diplomacisë "Fleçer" pranë Universitetit "Tafts", SHBA.



**NJZ 6 – Petre Shilegov** është deputet dhe zëdhënës i Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 ishte bartës i NJZ 2 dhe u zgjodh deputet në Kuvend. Ka lindur në vitin 1969 në Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik "Justiniani I" pranë Universitetit "Shën Ciliri e Metodi" në Shkup. Para ushtrimit të funksionit deputet, Shilegov ka punuar si avokat.





**NJZ 7 – Bllazho Stojanov**[89] është kryetar i organizatës partiake në Lokarno, Zvicër.

89 Për këtë kandidat për deputet në Kuvend nga NJZ 7 nuk mund të gjenden më shumë të dhëna biografike nga këto që i kemi dhënë.

## KOALICIONI PËR NDRYSHIME DHE DREJTËSI – BLLOKU I TRETË (LIDHJA DEMOKRATIKE, FRODEM, DEMOS DHE MORO-PP)

Koalicioni për NDRYSHIME dhe DREJTËSI – BLLOKU I TRETË përbëhet nga katër subjekte politike: Lidhja Demokratike (LD), Fronti për Maqedoni Demokratike (FRODEM), DEMOS dhe MORO – Partia Punëtore, ndërsa udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Pavle Trajanov-it. Është formuar në vitin 2016 pak para mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare 2016. Ky Koalicion angazhohet për luftë kundër krimit, stabilizimin e ekonomisë, reduktimin e varfërisë, parandalimin e shpërnguljes së të rinjve.

Për këto zgjedhje, Koalicioni për NDRYSHIME dhe DREJTËSI paraqiti lista të kandidatëve për deputetë në gjashtë njësi zgjedhore.

**Lidhja Demokrate**
Rr. "Stale Popov" 9 lok. 4
1000 Shkup
demokratskisojuz@ymail.com
www.demokratskisojuz.org.mk

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË KOALICIONIT NDRYSHIME DHE DREJTËSI

NJZ 1 – Pavle Trajanov
NJZ 2 – Jove Kekenovski
NJZ 3 – Vesna Stoimenovska
NJZ 4 – Sllobodan Bogoevski
NJZ 5 – Aleksandar Dellov
NJZ 6 – Branko Majstorovski

## PARTIA PËR PROSPERITET DEMOKRATIK

Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) është partia më e vjetër e shqiptarëve në Maqedoni, është themeluar në vitin 1990 dhe funksiononte deri në zgjedhjet parlamentare 2011 kur iu bashkëngjit PDSH. Partia është riaktivizuar në muajin janar 2014, ndërsa në krye të saj është Abdyladi Vejseli, deputet në tri legjislatura të mëparshme të Kuvendit. Në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, PPD ishte partia më e madhe parlamentare e cila i përfaqësonte shqiptarët e Maqedonisë dhe disa herë ishte partnere e koalicionit në qeverinë e LSDM. Pas shkëputjes së të ashtuquajturit krah radikal nga partia në vitin 1994 nga i cili u formua PDSH, PPD konsiderohet si parti politike e matur. PPD angazhohet për barazi të plotë të shqiptarëve në planin politik, ekonomik, social dhe kulturor, për gjuhën e tyre kombëtare, marrëdhënie harmonike ndëretnike të themeluara mbi parime demokratike të barazisë dhe drejtësisë së mirëfilltë. Slogani i PPD për këto zgjedhje është "Krenari dhe Dinjitet".

Për këto zgjedhje, partia paraqiti listë vetëm në një njësi zgjedhore, NJZ 6.

**Partia për Prosperitet Demokratik**
Rr. "Karaorman" nr. 62
1200 Tetovë
https://www.facebook.com/PPDzyrtare/?ref=br_rs

## BARTËS I LISTËS SË KANDIDATËVE TË PPD

NJZ 6 – Abdyladi Vejseli

## KOALICIONI "ALEANCA PËR SHQIPTARËT" (LR-PDSH, UNITETI, RDK)

Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" përbëhet nga partitë politike: Lëvizja për Reforma e PDSH, Uniteti dhe RDK. Konventa për promovimin e Koalicionit u mbajt në Gostivar. Në krye të Koalicionit është lideri i Lëvizjes për Reforma – PDSH, Zijadin Sela, kryetari i Rilindjes Demokratike Kombëtare, Vesel Memedi dhe kryetari i Unitetit, Gëzim Ostreni. Angazhimet kryesore të Koalicionit janë barazia e plotë e shqiptarëve në Maqedoni, gjuha shqipe të bëhet gjuhë zyrtare në Maqedoni, shpërndarja e drejtë e Buxhetit dhe rregullimi me Kushtetutë i funksionimit të PSP.

Koalicioni paraqiti lista të kandidatëve në katër NJZ.

**Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" (LR-PDSH, Uniteti, RDK)**
www.uniteti.org
www.rdk.org.mk
https://www.facebook.com/aleancaper?fref=ts

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPTARËT"

NJZ 1 – Zylfi Adili
NJZ 2 – Nexhmedin Sadiku
NJZ 5 – Syrija Rashidi
NJZ 6 – Zijadin Sela

## PARTIA LIBERALE

Partia Liberale është themeluar në vitin 1990 dhe është njëra nga partitë politike më të vjetra në Maqedoni. Ka karakter qendror me orientim liberal. Në vitet e para, pas pavarësimit të Maqedonisë, PL koalicioni me LSDM, PSM dhe PPD. Në vitin 1997 PL u bashkua me Partinë Demokratike (DP) duke e formuar Partinë Liberale Demokratike, me të cilën qëndroi deri në vitin 1999. Nga viti 1999 deri në vitin 2008, PL bëri koalicion me VMRO-DPMNE. Kryetar i partisë është Ivon Veliçkovski i cili u zgjodh në kuadër të Kongresit të Dhjetë të Partisë në vitin 2011. PL si parti angazhohet për liberalizëm reformist sipas platformës social-liberale. Në fokus janë demokracia dhe pluralizmi, ekonomia e tregut dhe sundimi i së drejtës të cilat e garantojnë realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive të qytetarëve.

Në këto zgjedhje PL paraqiti lista të kandidatëve në pesë njësi zgjedhore në Maqedoni, përkatësisht në: NJZ 1, NJZ 2, NJZ 3, NJZ 4 dhe në NJZ 5.

**Partia Liberale**
Rr. "Jurij Gagarin" 67B
1000 Shkup
info@lp.org.m
www.lp.org.mk

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË PARTISË LIBERALE

NJZ 1 – Ivon Veliçkovski
NJZ 2 – Kire Buzliev
NJZ 3 – Danço Markovski
NJZ 4 – Danica Jovanova
NJZ 5 – Kice Mickovski

## KOALICIONI VMRO PËR MAQEDONINË

VMRO për Maqedoninë është koalicion i partive politike VMRO Partia Popullore, Të Bashkuar për Maqedoninë dhe Dinjiteti. Koalicioni udhëhiqet nga liderët e të tri partive politike, përkatësisht Lubço Georgievski si lider i VMRO Partia Popullore, Lube Boshkovski si lider i Të Bashkuar për Maqedoninë dhe Stojançe Angellov si lider i Dinjitetit. Struktura ideologjike është qendër e djathtë. Synime kryesore të koalicionit janë demokratizimi i Maqedonisë, sundimi i së drejtës me prokurorë dhe gjyqtarë të pavarur, progresi ekonomik, anëtarësimi në BE dhe në NATO.

Për këto zgjedhje, Koalicioni paraqiti lista të kandidatëve në shtatë njësi zgjedhore.

**Koalicioni VMRO për Maqedoninë**
www.facebook.com/vmrozamakedonija2016/
www.vmro-np.org.mk
www.facebook.com/obedinetiza.makedonija/
www.facebook.com/dostoinstvo1/

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË KOALICIONIT VMRO PËR MAQEDONI

NJZ 1 – Danail Donçev
NJZ 2 – Lupço Ballkovski
NJZ 3 – Stojançe Angellov
NJZ 4 – Lubço Georgievski
NJZ 5 – Lube Boshkosvki
NJZ 6 – Zoran Vellkovski
NJZ 7 – Stojadin Naumovski

## LËVIZJA BESA

Partia politike "Lëvizja BESA" u themelua më 23 mars 2015. Lëvizja BESA ka për qëllim t'i promovojë interesat e të gjithë qytetarëve, dhe veçanërisht të shqiptarëve. Përcaktimet themelore bazohen në barazi, drejtësi, liri dhe mirëqenie. Pikënisja e lëvizjes është nga struktura asimetrike e shtetit në drejtim të njerëzve në të. Në vend të asimetrisë shteti duhet të bazohet mbi: parimet e lirisë, barazisë, drejtësisë, mirëqenies, luftës kundër korrupsionit. Për arritjen e këtyre qëllimeve Besa angazhohet për ndryshimin e funksionimit të sistemit në shtet, zhvillimit të vlerave universale të humanizmit, përmirësimit të demokracisë në vend, eliminimit të çdo lloji të diskriminimit, ndërtimit të shteti juridik dhe ngjashëm. Kjo parti për herë të parë do të merr pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016.

Për këto zgjedhje, Besa paraqiti lista të kandidatëve në njësitë zgjedhore, si vijojnë: NJZ 1, NJZ 2, NJ 5 dhe NJZ 6.

**Lëvizja Besa**
Bul. "Kërste Misirkov" nr. 7 lokali 68 A
1000 Shkup
kontakt@levizjabesa.mk
www.levizjabesa.mk

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË LËVIZJES BESA

NJZ 1 – Zeqirija Ibrahimi
NJZ 2 – Afrim Gashi
NJZ 5 – Arben Labenishti
NJZ 6 – Bilal Kasami

## LEVICA

Levica është parti e re politike e themeluar në fund të vitit 2015. Partia ka shprehur ideologji majtiste dhe angazhohet për vlerat e majta mes të cilave: antikapitalizmin, antimilitarizmin dhe antiklerikalizmin dhe antikonservatizmin. Në fokusin e partisë janë të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat themelore të njeriut, ndërsa si parti, para së gjithash, angazhohet për të varfrit, të paprivilegjuarit, të margjinalizuarit dhe atyre që nuk kanë të drejta. Kjo parti, për herë të parë, do të merr pjesë në zgjedhjet e ardhshme në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Levica paraqiti lista të kandidatëve në pesë njësi zgjedhore, përkatësisht në: NJZ 1, NJZ 2, NJZ 3, NJZ 4 dhe NJZ 5.

**Levica**
Rr. "Gjuro Gjakoviq" nr. 20, hyrja 1, kati 3, lokali nr. 12
1000 Shkup
contact@levica.mk
www.levica.mk

## BARTËS TË LISTAVE TË KANDIDATËVE TË LEVICA

NJZ 1 – Dimitar Apasiev
NJZ 2 – Trajçe Stojanov
NJZ 3 – Marija Xhons
NJZ 4 – Mitko Nikollov
NJZ 5 – Zdravko Saveski

# ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2016 – REZULTATE, FUSHATA, VLERËSIME

## HYRJE

Më datë 11 dhjetor 2016 u mbajtën zgjedhjet e teta parlamentare të radhës nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë, të cilat njëkohësisht ishin zgjedhjet e katërta të radhës të parakohshme parlamentare. Në këto zgjedhje të drejtë vote patën gjithsej 1.784.416 votues prej të cilëve 20.573 votues nga diaspora. Personat e sëmurë, të pamundur, personat në arrest shtëpiak dhe të burgosurit në institucionet ndëshkuese-korrektuese votuan një ditë më herët, përkatësisht më datë 10 dhjetor. Votimi në përfaqësitë diplomatike-konsullore u mbajt më datë 7 dhjetor. Dalja në zgjedhje ishte 66,79% ose 1,191,852 votues në krahasim me 63% dalje në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. Në diasporë dalja ishte 40% ose 8,232 votues.

Në këto zgjedhje morën pjesë 11 subjekte politike, përkatësisht pesë koalicione dhe gjashtë parti politike me 58 lista të kandidatëve, edhe atë: Koalicioni "Për një Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, "Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë", Koalicioni "VMRO për Maqedoninë", Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët", Partia Demokratike e Shqiptarëve, Bashkimi Demokratik për Integrim, Partia për Prosperitet Demokratik, Partia Liberale, Lëvizja BESA dhe Levica.

Sipas KSHZ, zgjedhjet parlamentare u monitoruan nga gjithsej 7,605 vëzhgues të akredituar vendor dhe të huaj dhe 642 vëzhgues të huaj, 354 përkthyes dhe 98 gazetarë të huaj. Vlerësimi i përgjithshëm i vëzhguesve ishte se zgjedhjet ishin të qeta, megjithatë, gjatë procesit zgjedhor u regjistruan disa parregullsi të caktuara. Vërejtjet kryesore të vëzhguesve kishin të bëjnë ushtrimin e presionit mbi votuesit, mosrespektimin e fshehtësisë së votimit, votimit grupor etj.[90]

Zgjedhjet rezultuan me ndryshime drastike sa i përket shpërndarjes së mandateve midis pjesëmarrësve. Koalicioni "Për një Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE në përbërjen e ardhshme të

---

90 Misioni Vëzhgues Ndërkombëtar për Zgjedhje i OSBE/ODIHR, Republika e Maqedonisë, Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, 11 dhjetor 2016, Deklaratë për të dhënat preliminare dhe konkluzionet. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/288296?download=true (vizita e fundit: 30 dhjetor 2016).

Kuvendit do të ketë 51 deputetë për dallim nga 61 deputetët e deritanishëm, ndërsa BDI do të ketë 10 deputetë për dallim të 19 deputetëve në përbërjen e fundit. Në llogari të dobësimit të partive në pushtet, partitë/koalicionet opozitare, pas këtyre zgjedhjeve, do të jenë më shumë të përfaqësuara në Kuvend sesa në përbërjen e fundit. Koalicioni i LSDM fitoi 49 vende të deputetëve, përkatësisht 15 vende më shumë se në legjislaturën e fundit parlamentare kur kishte 34 deputetë. PDSH tani ka 2 deputetë, përkatësisht 5 më pak sesa në përbërjen e fundit kur kishte 7 vende të deputetëve. Risi në këto zgjedhje ishin partitë dhe koalicionet e formuara të reja shqiptare - Lëvizja BESA dhe Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët", të cilat për herë të parë do të hynë në Kuvend. Lëvizja BESA fitoi 5 mandate, ndërsa Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" 3 mandate. Partitë dhe koalicionet e tjera pjesëmarrëse në këto zgjedhje, përkatësisht Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë, Partia për Prosperitet Demokratik, Partia Liberale, Koalicioni "VMRO për Maqedoninë" dhe Levica nuk fituan vota të mjaftueshme për të siguruar përfaqësues të vet në Kuvend. Në këto zgjedhje, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të votave, asnjë kandidat për deputetë nga diaspora nuk siguroi mandat në Kuvend. Në diasporë numër më të madh të votave fitoi Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE - 5,044.

Në vazhdim të këtij Manuali vijon vështrimi i detajuar i fushatës zgjedhore, i të ardhurave dhe shpenzimeve të partive dhe koalicioneve gjatë kohës së fushatës zgjedhore, raportimit të mediave, rezultateve të zgjedhjeve, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të zgjedhësve, vlerësimit të zgjedhjeve nga vëzhguesit dhe partitë politike, si dhe konkluzionet e përmbledhura për ciklin e përgjithshëm zgjedhor.

## FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare zyrtarisht filloi më datë 21 nëntor dhe zgjati deri më 9 dhjetor. Për shkak të heshtjes zgjedhore, partitë duhej t'i ndërpresin fushatat më 10 dhjetor. Në masë të madhe, partitë i shfrytëzonin metodat e zakonshme për promovim, siç janë mitingjet, takimet me qytetarë, fushata nga dera në derë, reklamat televizive, ndërsa u vërejt edhe një prezencë më e madhe në mediat sociale. Përkrah asaj që një pjesë e madhe e kandidatëve kishin fushatë pozitive, megjithatë, retorika negative dhe e ashpër nuk mungoi edhe këtë radhe. Në fokus të fushatës ishte çështja e krizës politike në Maqedoni, federalizimi i Maqedonisë dhe dygjuhësia, shpërngulja e të rinjve, hapja e vendeve të reja të punës, ekonomia.

Sipas Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR[91], gjatë fushatës zgjedhore partitë kishin mundësi lirshëm t'i zhvillojnë fushatat e tyre, me ç'rast u respektua liria e shoqërimit, tubimit dhe e shprehjes. Megjithatë edhe krahas kësaj konkluzionet janë se gjatë kohës së fushatës u regjistrua një numër i caktuar i incidenteve si pretendime për frikësimin e votuesve, presion mbi nëpunësit shtetërorë, mbi individë dhe familjet e tyre, keqpërdorim të resurseve administrative, blerja e votave në bashkësinë rome. Në bllokun shqiptar fushata zhvillohej në mënyrë akoma më intensive me një retorikë të ashpër. Vëzhguesit e OSBE, mes tjerash, vërejtën edhe raste të sjelljes së dhunshme, siç është vandalizmi i shtabeve partiake, shkatërrimi i bilbordeve, dëmtimi i automjeteve të anëtarëve të partive politike.

Është interesante se në këtë fushatë dy partitë më të mëdha të bllokut maqedonas i ndryshuan ngjyrat e tyre emblematike partiake. Partia në pushtet VMRO-DPMNE në këto zgjedhje u përcaktua për ngjyrën blu bojë qielli në kombinim me motive të bardha dhe të kuqe portokalli. Ndërsa LSDM u paraqit me ngjyrë të kuqe në kombinim me motive të bardha. Me këtë ribrendim, partitë iu kthyen ngjyrave të cilat tradicionalisht korrespondojnë me përcaktimin e tyre ideologjik të cilat dominojnë edhe në partitë e tyre evropiane simotra. Në Evropë ngjyra blu tradicionalisht konsiderohet si ngjyrë e partive konservative të qendrës së djathtë, ndërsa ngjyra e kuqe tradicionalisht është ngjyrë e socialdemokratëve.[92]

Si pjesë e fushatës, përveç paraqitjeve të rregullta mediatike dhe debateve, u organizuan edhe disa emisione debative midis bartësve të listave. Të

---

91 Misioni Vëzhgues Ndërkombëtar i Zgjedhjeve OSBE/ODHR. Republika e Maqedonisë, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare, 11 dhjetor 2016, Deklaratë për të dhënat dhe konkluzionet fillestare. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/288296?download=true (vizita e fundit: 19 dhjetor 2016).

92 VMRO-DPMNE u ribrendua në ngjyrë blu-bardhë, ja përse?, Zurnal, 23 nëntor 2015. I aksesshëm në: http://zurnal.net/?p=11650 (vizita e fundit: 22 dhjetor 2016).

këtilla ishin debatet midis një pjese të bartësve të listave në NJZ 1 në TV21 dhe në televizionin Alsat M, midis bartësve të listave të NJZ 2 dhe të NJZ 3 në RV21, si dhe midis bartësve të listave të partive shqiptare.

Koalicioni "Për një Maqedoni më të Mirë", i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, në këto zgjedhje e zhvilloi fushatën me sloganin: "E Din Çka Është më Mirë!", "Për Ty!" "Për Maqedoninë!". Në kuadër të fushatës zgjedhore, partia e promovoi Programin e vet zgjedhor për periudhën kohore 2017-2020 me titull "Realisht! Punë, Siguri! Progres!".[93] Në Programin e prezantuar në përafërsisht 500 faqe, në 17 kapituj u përfshinë projekte dhe masa të fushave të ndryshme me të cilat, mes tjerash, parashikohet hapja e 70 000 vendeve të reja të punës në katër vitet e ardhshëm, vazhdimi i subvencioneve të banimit, rritja e pagave, pensioneve dhe asistencës sociale, 600 milionë euro subvencione të reja për bujqit, etj. Në fokus të fushatës zgjedhore, gjithashtu ishin edhe investimet në arsim, infrastrukturë, sport, integrimin e Maqedonisë në BE dhe në NATO, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmirësimi i kushteve për zhvillimin e bizneseve, mbrojtja e mjedisit jetësor, mbështetja e turizmit. Disa muaj para zgjedhjeve VMRO-DPMNE e prezantoi llogaridhënien[94] për të realizuarat e partisë dhe koalicionit "Për një Maqedoni më të Mirë" në 10 vitet e fundit, me fokus mbi periudhën kohore 2014 - 2016, e cila përmbante mbi 3 500 projekte, masa dhe reforma të realizuara.

Fushata onlajn e VMRO-DPMNE zhvillohej përmes faqes së internetit të partisë www.vmro-dpmne.org.mk, profileve zyrtare të partisë në rrjetet sociale Fejsbuk dhe Tuiter, si dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve për deputetë të listave zgjedhore. Video regjistrimet nga mitingjet dhe takimet me qytetarë, si dhe nga video-spotet zgjedhorë muzikor, përveç në rrjete sociale publikoheshin edhe në kanalin Jutub[95] të partisë.

93 Realisht! Programi i VMRO-DPMNE 2017-2020, Punë! Siguri! Progres!, VMRO-DPMNE. I aksesshëm në: http://vmro-dpmne.org.mk/files/vmro_programa_2017-2020_web.pdf (vizita e fundit: 15 dhjetor2016).

94 Llogaridhënia për realizimin e Programit të VMRO-DPMNE dhe koalicionit "Për një Maqedoni më të Mirë" 2016r, VMRO-DPMNE. I aksesshëm në: http://vmro-dpmne.org.mk/files/vmro-dpmne_otcet_2016.pdf(vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).

95 Kanali Jutub i VMRO-DPMNE. I aksesshëm në: https://www.youtube.com/user/vmrodpmnemacedonia (vizita e fundit: 15 dhjetor 2016).



Koalicioni i udhëhequr nga partia më e madhe opozitare LSDM fushatën zgjedhore e udhëhoqi me sloganin "Për Jetë në Maqedoni". Fushata zgjedhore me titullin "Plani për Jetë në Maqedoni!"[96] në 262 faqe i prezantoi qëllimet kryesore të koalicionit, si dhe Prioritetet Urgjente të Reformave të qeverisë së re në 6 muajt e parë, përkatësisht 24 muaj. Gjithashtu, në kuadër të fushatës zgjedhore u prezantuan edhe pesë shtyllat, qëllimi i të cilave është reduktimi i pabarazisë në Maqedoni. Shtylla e parë, e përfshin pushtetin e përgjegjshëm dhe kontrollin mbi pushtetin përmes sigurimit të transparencës gjatë shpenzimit të parave nga buxheti shtetëror. Shtylla e dytë, ka të bëjë me ekzistimin e sistemit të drejtë tatimor dhe social, ndërsa synon reduktimin e pabarazisë gjatë shpërndarjes së të ardhurave në dispozicion në Maqedoni. Shtylla e tretë, zhvillimi i kapaciteteve vendore dhe puna modeste ka të bëjë me sigurimin e mbështetjes së ndërmarrjeve vendore dhe me këtë krijimin e vendeve të reja të punës. Në fokusin e shtyllës së katërt, ardhmëria evropiane dhe jeta cilësore, qëndron riafirmimi i agjendës euroatlantike të Maqedonisë dhe ndërtimi i fushave kyç të shoqërisë, siç është arsimi, shëndetësia, mjedisi jetësor, kultura. Shtylla e pestë e përfshin ndërtimin e një shoqërie të bashkuar përmes tejkalimit të tensioneve ndëretnike dhe tensioneve të tjera me fokus mbi dallimet sociale.

Fushata Onlajn e LSDM u zhvillua përmes internet faqes së partisë, www.sdsm.org.mk dhe të koalicionit www.zazivot.mk, përmes profilit zyrtar të partisë në rrjetet sociale Fejsbuk dhe Tuiter, si dhe përmes profileve personale të bartësve të kandidatëve të listave zgjedhore të Koalicionit. Video-regjistrimet nga mitingjet dhe takimet me qytetarë, përveç në rrjetet sociale publikoheshin edhe në kanalin Jutub[97] të partisë.

Fushatën zgjedhore BDI e zhvilloi me sloganin "Bashkë Vendosim". Programi zgjedhor[98] i përpiluar nga mbi 100 intelektualë me një format prej mbi 200 faqe, me titull identik si edhe slogani i partisë. Në të njëjtin u prezantuan masat për periudhën e ardhshme kohore

96 Plani për jetë në Maqedoni, LSD dhe koalicioni, Zgjedhje Parlamentare 2015. I aksesshëm në: http://zazivot.mk/wp-content/uploads/2016/11/Plan_za_zivot_vo_Makedonija.pdf (vizita e fundit: 15 dhjetor 2016).

97 Kanali Jutub i LSDM. I aksesshëm në: https://www.youtube.com/user/SDSMtube (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).

98 Bashkë Vendosim, BDI. I aksesshëm në: http://bashkevendosim.com.mk/BDI_Programa_WEB.pdf (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).

katërvjeçare 2016-2020. Si prioritet për katër vitet e ardhshëm u përcaktua dygjuhësia në Maqedoni, përkatësisht instalimi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në gjithë territorin e Maqedonisë. Për këtë qëllim, partia premtoi formimin e institucionit i cili do të shërbejë si mekanizëm për mbrojtjen e gjuhës shqipe. Në pjesën ekonomike partia ka parashikuar masa për reduktimin e papunësisë përmes hapjes së vendeve të reja të punës, me qëllim që asnjë familje shqiptare të mos mbetet pa një person të punësuar. Gjithashtu, një pjesë e masave u fokusua mbi arritjen e barazisë së plotë dhe mirëqenies së shqiptarëve në të gjitha fushat shoqërore, pastaj rritja e cilësisë së arsimit, zhvillimi rajonal, buxheti transparent, njëkohësisht theksi ishte vënë edhe mbi integrimet euroatlantike të vendit. Në këtë fushatë zgjedhore risi ishte ajo që partia u mundësoi qytetare në ueb faqen e partisë të propozojnë sugjerime në lidhje me atë që ata konsiderojnë se partia nuk ka arritur ta realizojë deri më tani.

Fushatën zgjedhore përmes internetit BDI në pjesën më të madhe e zhvilloi përmes faqes partiake, www.bdi.mk, përmes profileve zyrtare partiake në rrjetin social Fejsbuk dhe përmes profileve të bartësve të listave zgjedhore dhe kandidatëve për deputet. BDI në këto zgjedhje nuk pati profil në rrjetin social Tuiter.

Në këto zgjedhje, partia PDSH u prezantua me sloganin "Shkojmë Drejt". Si edhe në zgjedhjet e kaluara parlamentare, ashtu edhe në këto zgjedhje, PDSH nuk u ofroi votuesve program zgjedhor, por platformë për mandatin e radhës të qeverisë me titull: "Platforma e PDSH për periudhën 2016-2020"[99] e përshkruar në 68 faqe. Në kuadër të kësaj Platforme, partia veçanërisht u fokusua mbi dy fusha, mbi ekonominë dhe politikën. Në pjesën e ekonomisë, partia angazhohet për shpërndarje të drejtë dhe proporcionale të buxhetit, ndërmarrjen e masave kundër buxhetit diskriminues, më shumë investime në të gjitha rajonet njësoj dhe lirimin e shqiptarëve nga pagesa e borxheve të dënimeve nga shteti. Në pjesën politike fokusi kryesor i programit ishte dygjuhësia, përkatësisht përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në gjithë territorin e Maqedonisë, si dhe lirimi i të gjithë shqiptarëve të dënuar nga proceset e montuara gjyqësore.

99 Platforma e PDSH për periudhën kohore 2016-2020, PDSH. I aksesshëm në: http://www.pdsh.info/platforma-finale.pdf (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).



Përveç kësaj, partia fushatën e zhvilloi edhe në internet, si dhe në rrjetet sociale. Në rastin e parë fushata u zhvillua kryesisht përmes faqes zyrtare www.pdsh.info, në rrjetin social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore. Video-regjistrimet nga ngjarjet publikoheshin përmes rrjeteve sociale dhe kanalit Jutub[100] të partisë.

Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë i Lidhjes Demokratike, FRODEM, MORO dhe DEMOS fushatën zgjedhore e zhvilloi me sloganin: "Mos u Frikësoni, Regjimi do të Rrëzohet". Programi zgjedhor i koalicionit me titullin: "Ndryshime, Drejtësi, Progres"[101] përfshin fusha të ndryshme nga jeta shoqërore. Si prioritete janë përcaktuar vendosja e sistemit të qeverisjes së përgjegjshme dhe krijimi i shtetit të drejtë "i udhëhequr" nga sundimi i së drejtës. Gjithashtu, si synime të rëndësishme theksohet edhe zbatimi i reformave në sistemin gjyqësor, zhvillimi ekonomik, reforma në arsim, projekte dhe krijimi i mundësive për të rinjtë, inkuadrimi në BE dhe në NATO, pagë minimale më të lartë. Ky koalicion fushatën onlajn e zhvilloi përmes rrjetit social Fejbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore. Prezantimet zgjedhore të koalicionit ishin të aksesshme edhe në kanalin Jutub[102] të partisë Lidhja Demokratike.

Partia për Prosperitet Demokratik në këto zgjedhje u prezantua vetëm në një njësi zgjedhore, NJZ 6. Fushata zgjedhore u kufizua në takime dhe tubime më të vogla me qytetarë. Partia, gjithashtu, zhvilloi fushatë modeste zgjedhore kryesiht në rrjetin social Fejsbuk.

Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" për herë të parë u paraqit në zgjedhjet parlamentare. Angazhimet kryesore të Platformës së koalicionit kanë të bëjnë me barazinë e plotë të shqiptarëve në Maqedoni, gjuha shqipe të bëhet gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë, shpërndarja

100 Kanali Jutub i PDSH. I aksesshëm në:https://www.youtube.com/user/PDSHoficiale (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).

101 Ndryshime, drejtësi, progres - Programi zgjedhor 2016-2020, Koalicioni për ndryshime dhe drejtësi. I aksesshëm në: http://www.demokratskisojuz.org.mk/content/KPP%20-%20IP%202016-2020%20A5__NOVO%20(2).pdf (vizita e fundit: 20 dhjetor 2016).

102 Kanali Jutub i LD. I aksesshëm në: https://www.youtube.com/user/demokratskisojuz100 (vizita e fundit: 20 dhjetor 2016).

e drejtë e buxhetit dhe sanksionimi në Kushtetutë të PSP. Fushatën onlajn koalicioni e zhvilloi përmes ueb faqeve të partive të koalicionit, përmes rrjetit social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare të partive, si dhe përmes profileve të bartësve të kandidatëve të listave zgjedhore, si dhe përmes kanalit Jutub[103] të koalicionit.

Partia Liberale fushatën e zhvilloi me sloganin: "Për një Shtet të Konsoliduar". Në këto zgjedhje, partia e prezantoi programin zgjedhor "Doktrina Liberale për një Maqedoni të Konsoliduar"[104]. Në kuadër të programit u identifikuan tri tema kryesore: ekonomia, shteti i organizuar, arsimi dhe rinia. Disa nga qëllimet e partisë kanë të bëjnë me krijimin e shtresës dominante të mesme, me shtetin e konsoliduar, institucione funksionale me media të lira, buxhetim të drejtë dhe me udhëheqje të përgjegjshme. Fushatën zgjedhore partia e zhvilloi në formë të takimeve më të vogla me qytetarë, tribunave dhe përmes mitingjeve të vegjël. Fushata onlajn u zhvillua përmes ueb faqes www.lp.org.mk, përmes rrjetit social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore, si dhe përmes kanalit Jutub[105] të partisë.

Koalicioni "VMRO për Maqedoninë" u prezantua me sloganin: "Bashkë për një Maqedoni të Fuqishme!". Koalicioni nuk prezantoi program të shkruar klasik, por vetëm materiale zgjedhore. Përmes paraqitjeve të tyre publike mund të vërehej se si koalicion angazhohen për liri, demokraci, prosperitet ekonomik, të drejtat e njeriut. Fushatën onlajn koalicioni kryesisht e zhvilloi përmes rrjetit social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore, si dhe përmes kanalit Jutub[106] të koalicionit.

103 Kanali Jutub i Koalicionit Aleanca për Shqiptarët. I aksesshëm në: https://www.youtube.com/channel/UC4Eb-YmODPqvlGLFszaUZDg (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).
104 Doktrina liberale për një Maqedoni të konsoliduar, PL. I aksesshëm në: https://www.dropbox.com/s/amsqxdrix7k1462/Doktrina.pdf?dl=0 (vizita e fundit në: 16 dhjetor 2016).
105 Kanali Jutub i PL.: https://www.youtube.com/channel/UCr7ZB0uk0bzZbVxoooypiUg (vizita e fundit: 19 dhjetor 2016).
106 Kanali Jutub i koalicionit VMRO për Maqedoninë. I aksesshëm në: https://www.youtube.com/channel/UC5DX2__0qvTbYkVJPoaNnlw (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).



Fushatën zgjedhore, Lëvizja BESA e zhvilloi me sloganin: "Rilindje me BESË! O sot, o kurrë". Programi zgjedhor[107] u fokusua mbi më shumë aspekte në mesin e të cilave integrimet euroatlantike të Maqedonisë, ekonomia, depolitizimi i sistemit të jurisprudencës, përmirësimi i shëndetësisë, arsimit, infrastrukturës. Njëri nga angazhimet kryesore të partisë, gjithashtu, ka të bëjë me barazinë e plotë të shqiptarëve në Maqedoni, barazinë e gjuhës dhe me ridefinimin e shtetit. Fushata onlajn u zhvillua përmes ueb faqes www.levizjabesa.mk, rrjeteve sociale Fejsbuk dhe Tuiter, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore, si dhe përmes kanalit Jutub[108] të BESA.

Partia Levica, e cila për herë të parë mori pjesë në zgjedhje parlamentare, u prezantua me sloganin "Shkëndija në Errësirë". Përmes fushatës zgjedhore[109] partia u angazhua për të drejta më të mëdha punëtore dhe drejtësi sociale, rishpërndarje të pasurisë në dobi të të varfërve, demokratizim në të gjitha fushat e jetës shoqërore, qasje më të lehtë deri te drejtësia, avancimi i arsimit, sigurimi i mbrojtjes shëndetësore për të gjithë, modernizimi dhe organizimi i bujqësisë, fokus mbi ekologjinë, marrëdhënie të mira ndër-fqinjësore. Fushatën zgjedhore partia kryesisht e zhvilloi përmes takimeve të vogla me qytetarë, përmes fushatave, si dhe përmes ueb faqes së internetit të Levica www.levica.mk, përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore dhe përmes kanalit Jutub[110] të partisë.

## FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE[111]

Në përputhje me Agjendën për realizimin e veprimeve zgjedhore, në këto zgjedhje parlamentare pjesëmarrësit e kishin për detyrë të

107 Programi Zgjedhor per Zgjedhjet parlamentare 2016 – Rilindje me BESË, BESA. I aksesshëm në: http://www.levizjabesa.mk/wp-content/uploads/2016/11/Programi%20Zgjedhor%20per%20Zgjedhjet%20parlamentare%202016%20-%20Rilindje%20me%20BES%C3%8B.pdf (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).
108 Kanali Jutub i Lëvizjes BESA. I aksesshëm në: https://www.youtube.com/channel/UCFg0vjAkXJ59CMK9C4c5v-A (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).
109 Programi zgjedhor i Levica, Levica. I aksesshëm në: https://levica.mk/wp-content/uploads/2016/11/Programa-FINAL-23.XI_.2016.pdf (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).
110 Kanali Jutub i Levica. I aksesshëm në: https://www.youtube.com/channel/UC4IvFV-Invs76o0WZQdMBAzA (vizita e fundit: 16 dhjetor 2016).
111 Të gjitha të dhënat janë shkarkuar nga ueb faqja zyrtare e KSHZ.

paraqesin tre raporte financiare për shpenzimet e fushatës zgjedhore. Raporti i parë financiar i përfshin 10 ditët e para të fushatës zgjedhore, ndërsa partitë dhe koalicionet e kishin për detyrë ta paraqesin në ditën e 11 nga dita e fushatës zgjedhore, përkatësisht më 1 dhjetor. Raporti i dytë e përfshin gjysmën e dytë të fushatës zgjedhore, ndërsa partitë dhe koalicionet e kishin për detyrë ta paraqesin një ditë pas përfundimit të fushatës zgjedhore, përkatësisht më datë 10 dhjetor. Raporti i tretë financiar, që ka të bëjë me të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme gjatë gjithë fushatës, partitë dhe koalicionet duhet ta paraqesin në afat prej 30 ditësh nga dita e mbylljes së llogarisë së transaksionit, e që mund të jetë katër muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve. Raportet financiare paraqiten në KSHZ, Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), ndërsa raporti i tretë financiar i paraqitet edhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu, ESHR e ka për detyrë në afat prej 60 ditëve nga paraqitja e raportit të përgjithshëm financiar të zbatoj revizion.

Të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhjet parlamentare i paraqitën të dy raportet periodike financiare. Sipas raporteve të paraqitura financiare, më së shumti mjete në fushatën zgjedhore ka shpenzuar koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, përkatësisht 117,212,742 denarë (1,905,898 euro[112]). Në pjesën e parë të fushatës koalicioni ka shpenzuar 43,961,384 denarë (714,819 euro), ndërsa në pjesën e dytë 73,251,358 denarë (1,191,079 euro). Deri më datë 10 dhjetor koalicioni gjithsej ka grumbulluar 18,131,715 denarë (294,825 euro), me ç'rast dallimi midis të ardhurave dhe shpenzimeve është 99,081,027 denarë (1,611,074 euro), përkatësisht shpenzimet janë pothuajse gjashtë herë e gjysmë më të larta nga të ardhurat.

Partia, përkatësisht koalicioni i dytë, sipas shumës së mjeteve të shpenzuara, është koalicioni i udhëhequr nga LSDM. Koalicioni gjatë fushatës zgjedhore ka shpenzuar gjithsej 33,923,911 denarë (551,608 euro), përkatësisht 19,683,894 denarë (320,063 euro) në pjesën e parë dhe 14,240,017 denarë (231,545 euro) në pjesën e dytë të fushatës. Koalicioni i udhëhequr nga LSDM është njëri nga pesë pjesëmarrësit të cilët për fushatën e këtyre zgjedhjeve ka grumbulluar më shumë mjete sesa që ka shpenzuar, përkatësisht ka grumbulluar 50,736,772 denarë

112 Kalkulimet në euro janë bërë sipas kursit të mesëm prej 61,5 denarë për 1 euro.

(824,988 euro). Sipas Kodit Zgjedhor, tepricën e mjeteve koalicioni duhet ta dhurojë për qëllime bamirësie.

Partia e tretë sipas të ardhurave dhe shpenzimeve në këtë fushatë është BDI. Partia, në të dyja pjesët e fushatës ka grumbulluar gjithsej 12,686,050 denarë (206,277 euro), përkatësisht 7,880,750 denarë (128,142 euro) në pjesën e parë dhe 4,805,300 denarë (78,135 euro) në pjesën e dytë. Deri në 10 dhjetor partia gjithsej ka shpenzuar 22,684,550 denarë (368,854 euro), e që është për 9,998,500 denarë (162,577 euro) më shumë sesa që ka grumbulluar.

Koalicioni "VMRO për Maqedoninë" në këto zgjedhje ka shpenzuar gjithsej 8,364,675 denarë (136,011 euro), përkatësisht 2,848,970 denarë (46,325 euro) në pjesën e parë dhe 5,515,705 denarë (89,686 euro) në pjesën e dytë të fushatës. Koalicioni është njëri nga pjesëmarrësit e zgjedhjeve të cilët kanë grumbulluar më shumë mjete sesa që kanë shpenzuar, përkatësisht ka grumbulluar 10,150,504 denarë (165,049 euro). Sipas Kodit Zgjedhor, tepricën e mjeteve koalicioni duhet ta dhurojë për qëllime bamirësie.

Gjatë fushatës zgjedhore, Lëvizja BESA ka shpenzuar gjithsej 8,725,348 denarë (141,876 euro), përkatësisht 4,725,217 denarë (76,833 euro) në pjesën e parë dhe 4,000,131 denarë (65,043 euro) në pjesën e dytë të fushatës. Deri në paraqitjen e raportit të dytë financiar, partia ka grumbulluar gjithsej 6,079,750 denarë (98,858 euro) ose 2,645,598 denarë (43,018 euro) më pak sesa që ka shpenzuar.

Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi – Blloku i Tretë, në fushatë ka shpenzuar gjithsej 2,469,485 denarë (40,154 euro), përkatësisht 1,559,635 denarë (25,360 euro) në pjesën e parë dhe 909,850 denarë (14,794 euro) në pjesën e dytë. Deri më datë 10 dhjetor, koalicioni ka grumbulluar gjithsej 1,837,871 denarë (29,884 euro) ose 631,614 denarë (10,270 euro) më pak sesa që ka shpenzuar.

Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" në këto zgjedhje ka grumbulluar gjithsej 1,326,145 denarë (21,563 euro). Deri në paraqitjen e raportit të dytë financiar, koalicioni ka shpenzuar gjithsej 1,052,030 denarë (17,106 euro), përkatësisht 893,519 denarë (14,529 euro) në pjesën

e parë dhe 158,511 denarë (2,577 euro) në pjesën e dytë. Koalicioni është njëri nga disa partitë i cili dallimin midis të ardhurave dhe shpenzimeve e ka në pozitiv. Sipas Kodit Zgjedhor, tepricën e mjeteve koalicioni duhet ta dhurojë për qëllime bamirësie.

Në këto zgjedhje PDSH pati të ardhura dhe shpenzime më të ulëta. Në pjesën e parë të fushatës partia ka shpenzuar 433,840 denarë (7,054 euro), ndërsa në pjesën e dytë 1,610,370 denarë (26,185 euro) ose gjithsej 2,044,210 denarë (33,239 euro). Deri më datë 10 dhjetor partia ka grumbulluar gjithsej 935,001 denarë (15,203 euro) ose 1,109,209 denarë (18,036 euro) më pak sesa që ka shpenzuar.

Partitë më të vogla, PL, Levica dhe PPD në këto zgjedhje kishin të ardhura dhe shpenzime më të vogla në krahasim me partitë e tjera. Të tria partitë bashkërisht kanë shpenzuar gjithsej 863,787 denarë (14,045 euro), ndërsa kanë grumbulluar gjithsej 605,300 denarë (9,842 euro).

Nëse i sublimojmë rezultatet, mund të vërehet se në nëntë raporte ka tejkalim të shpenzimeve në krahasim me të ardhurat. Që të kompensohen dallimet e këtilla, partitë mund të grumbullojnë donacione më së voni deri në paraqitjen e raportit financiar final. Gjithashtu, njëra nga vërejtjet e "Transparencë Maqedoni" ka të bëjë me atë se në raportet pjesa më e madhe e partive nuk i kanë prezantuar shpenzimet për transport dhe shërbime transporti, për shërbime komunale dhe ngrohje, për shërbime komunikimi, si dhe për marrjen me qira të hapësirave dhe pajisjes.[113]

| | | Raporti i parë financiar | Raporti i dytë financiar | GJITHSEJ |
|---|---|---|---|---|
| VMRO-DPMNE | Të ardhura | 7,431,579 | 10,700,136 | 18,131,715 |
| | Shpenzime | 43,961,384 | 73,251,358 | 117,212,742 |
| PDSH | Të ardhura | 602,001 | 333,000 | 935,001 |
| | Shpenzime | 433,840 | 1,610,370 | 2,044,210 |
| BDI | Të ardhura | 7,880,750 | 4,805,300 | 12,686,050 |
| | Shpenzime | 5,336,095 | 17,348,455 | 22,684,550 |
| LSDM | Të ardhura | 32,922,717 | 17,814,055 | 50,736,772 |
| | Shpenzime | 19,683,894 | 14,240,017 | 33,923,911 |
| KND | Të ardhura | 1,448,300 | 389,571 | 1,837,871 |
| | Shpenzime | 1,559,635 | 909,850 | 2,469,485 |
| PPD | Të ardhura | 0 | 0 | 0 |
| | Shpenzime | 262,761 | 0 | 262,761 |
| Aleanca për Shqiptarët | Të ardhura | 1,145,745 | 180,400 | 1,326,145 |
| | Shpenzime | 893,519 | 158,511 | 1,052,030 |
| PL | Të ardhura | 436,000 | 46,000 | 482,000 |
| | Shpenzime | 477,811 | 645 | 478,456 |
| VMRO për Maqedoninë | Të ardhura | 4,633,502 | 5,517,002 | 10,150,504 |
| | Shpenzime | 2,848,970 | 5,515,705 | 8,364,675 |
| BESA | Të ardhura | 4,153,750 | 1,926,000 | 6,079,750 |
| | Shpenzime | 4,725,217 | 4,000,131 | 8,725,348 |
| Levica | Të ardhura | 104,800 | 18,500 | 123,300 |
| | Shpenzime | 81,354 | 41,216 | 122,570 |

## MEDIAT

Misioni vëzhgues i zgjedhjeve pranë OSBE/ODIHR[114] e realizoi monitorimin për periudhën kohore nga data 7 nëntor deri më 10 dhjetor dhe i përfshiu programet e transmetuara në terminet e pikut të shikueshmërisë së kanaleve të Servisit Publik RTM 1 dhe RTM 2, të televizioneve private Sitel, Kanal 5, Alfa, Telma dhe Alsat-M, programet kryesore informative të 24 Vesti, si dhe gazetat ditore Dnevnik, Koha, Lajm, Slloboden Peçat dhe Vest. Misioni, në raportin e tij për monitorimin e mediave gjatë kohës së fushatës së zgjedhjeve parlamentare, vuri në dukje ekzistimin e ndarjes politike dhe etnike të mediave në Maqedoni. Mes tjerash, u vërejt edhe ndikim i fuqishëm i radiodifuzerëve privatë proqeveritarë mbi tregun e reklamave, presion politik mbi mediat, si dhe raste të provokimeve dhe sulmeve verbale ndaj gazetarëve.

113 Monitorimi i shpenzimeve nga buxhetet e partive politike në procesin parazgjedhor dhe zgjedhor, "Transparencë Maqedoni", 5 dhjetor 2016. I aksesshëm në http://www.transparency.mk/images/stories/press/2016/prezentacija_izborni_troshoci_21.11-30.12.2016.pdf (vizita e fundit: 21 dhjetor 2016).

114 Misioni Vëzhgues Ndërkombëtar i Zgjedhjeve pranë OSBE/ODIHR, Republika e Maqedonisë, Zgjedhje të Parakohshme Parlamentare 11 dhjetor 2016, Deklaratë për të dhënat preliminare dhe konkluzionet. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/288296?download=true (vizita e fundit: 7 janar 2017).

Raporti i OSBE në përgjithësi vuri në dukje se të dy kanalet publike televizive kryesisht i kanë respektuar aktet normative për raportim të balancuar midis pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore kurse kandidatët kryesisht i kanë prezantuar në mënyrë pozitive dhe jokritike. Sa u përket radiodifuzerëve privatë, monitorimi i OSBE/ODIHR vuri në dukje se ekziston dallim midis mënyrës së raportimit. Së këtejmi, mediat private Sitel, Kanal 5 dhe Alfa kanë raportuar në mënyrë të disbalancuar dhe të njëanshme në dobi të VMRO-DPMNE në pushtet. Megjithatë, nga ana tjetër, mediat e njëjta i kanë përkushtuar më pak kohë mbulimit të aktiviteteve të LSDM, i cili kryesisht ka qenë me tone negative, ndërsa një tendencë e këtillë më së shumti është vërejtur tek Sitel. Mediat e tjera private, siç është Telma, Alsat-M dhe 24 Vesti në emisionet informative patën sukses të sigurojnë mbulim të shumëllojshëm dhe shpeshherë kritikë ndaj pjesëmarrësve kryesorë në procesin elektoral. Gazetat e monitoruara ditore kryesisht kanë raportuar në mënyrë të shumëllojshme, megjithatë, në masë të caktuar kanë qenë të njëanshme ndaj disa partive.

Kodi Zgjedhor e rregullon mbulimin mediatik të zgjedhjeve.[115] Në përputhje me Kodin Zgjedhor mediat e kanë për detyrë të sigurojnë raportim të balancuar, proporcional dhe të paanshëm dhe ta mbulojnë fushatën zgjedhore. Në periudhën parazgjedhore Komisioni i Përkohshëm për Monitorimin e Prezantimit Mediatik u ngarkua me monitorimin e raportimit mediatik. Ky organ ad hok, u themelua në kuadër të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-Vizive, ndërkaq si pjesë e Marrëveshjes së Përzhinos (Përzhino 2) midis katër partive më të mëdha politike në Maqedoni. Mandati i Komisionit të Përkohshëm zgjati deri në përfundimin e procesit zgjedhor. Objekt i monitorimit ishte zbatimi i dispozitave të neneve 75, 75-a, 75-b, 75-v, 75-g, 75-d, 75-gj, 76, 76-a, 76-b, 76-v 76-g dhe 77 nga Kodi Zgjedhor të cilat, mes tjerash, kanë të bëjnë me mënyrën e raportimit të mediave gjatë periudhës parazgjedhore, me sigurimin e kushteve të barabarta të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për qasje në të gjitha format e prezantimit elektoral mediatik, si dhe me respektimin e parimit të proporcionalitetit sipas numrit të listave të verifikuara të kandidatëve për deputetë.

115 Për më shumë informacione shih: Roli i mediave publike f. 51 të Manualit.



## Monitorimi mbi servisin publik RTM

Në këto zgjedhje, monitorimi mbi raportimin mediatik elektoral të Servisit Radiodifuziv Publik RTM u realizua në dy periudha kohore, nga 21 deri më 30 nëntor dhe nga 1 deri në 9 dhjetor të vitit 2016, ndërkaq përfshiu minutazh të caktuar dhe kontribute gazetareske nga edicionet e TV ditarëve dhe nga emisionet informative. Në të dyja periudhat kohore subjekt i monitorimit ishte Servisi i Parë Programor RTM 1, Servisi i Dytë Programor RTM 2, Radioja Maqedonase - Servisi i Parë Programor RM 1, dhe Radio Maqedonase - Servisi i Tretë Programor - Programi në Gjuhën Shqipe RM 3.

Në periudhën kohore nga 21 deri më 30 nëntor të vitit 2016 sipas Raportit për monitorimin e realizuar[116] mbi Servsin e Parë Programor RTM 1, redaksia informative i ka respektuar parimet programore të përcaktuara në "Rregullat e mbulimit mediatik të proceseve zgjedhore - për prezantim të balancuar politik". Në përputhje me këto parime, koha informative duhet të shpërndahet në këtë mënyrë: 30 % për partitë në pushtet, 30 % për partitë në opozitë, 10 % për ato parti të cilat nuk kanë përfaqësues të tyre në Kuvend, si dhe 30 % për ngjarjet ditore nga vendi dhe bota. Gjithashtu, sa u përket zgjedhjeve parlamentare, shpërndarja e kohës informative për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit sipas numrit të listave të verifikuara me kandidatë për deputetë. Sipas Raportit, kjo shpërndarje është respektuar dhe është arritur balancim informativ.

Raporti për monitorimin e realizuar[117] mbi Servisin e Dytë Programor RTM 2 vë në dukje një disbalancim të caktuar sa i përket shpërndarjes së kohës konform Kodit Zgjedhor. Së këtejmi, në pozicionin "ngjarje ditore nga vendi dhe bota" është vërejtur një rritje e caktuar në llogari të kohës së dedikuar për aktivitetet e partive në pushtet dhe në opozitë. Gjithashtu, nuk është respektuar edhe parimi i proporcionalitetit sipas numrit të listave të verifikuara me kandidatë për deputetë. Me fjalë të

116 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – RTM 1, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/MRT_1_06.12.2016.pdf (vizita e fundit: 7 janar 2017).

117 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – RTM 2, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/MRT_2_06.12.2016.pdf (vizita e fundit: 7 janar 2017).

tjera, 30 % e kohës së parashikuar për aktivitetet e partive në pushtet, përkatësisht për Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe për BDI, të cilat në këto zgjedhje patën nga shtatë lista të deputetëve, nuk është shpërndarë në mënyrë të barabartë, por 1 orë më shumë është ndarë në dobi të BDI. Mosrespektime të ngjashme ka edhe sa i përket shpërndarjes së kohës (30 %) të parashikuar për aktivitetet e partive nga opozita, me ç'rast PDSH-së e cila ka pesë lista të verifikuara me kandidatë, i është ndarë shumë më shumë kohë në krahasim me Koalicionin e udhëhequr nga LSDM me shtatë lista të kandidatëve dhe "Koalicionin për Ndryshime dhe Drejtësi" (KND) me gjashtë lista të verifikuara me kandidatë për deputetë. Një tendencë e këtillë vërehet edhe tek 10 % të hapësirës së përgjithshme informative - ditore të dedikuar për partitë politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvend, me ç'rast për Koalicionin "VMRO për Maqedoninë" nuk ka fare informacione.

Të dhënat nga Raporti për monitorimin e realizuar[118] mbi Radion Maqedonase - Servisi i Parë Programor RM 1 vë në dukje se edhe në këtë rast në pozicionin "ngjarje ditore nga vendi dhe bota" është shpenzuar shumë më shumë kohë nga ajo që është parashikuar, përkatësisht madje 39 %. Përveç kësaj, shpërndarja e kohës për aktivitetet e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor nuk është proporcionale me numrin e listave të verifikuara me kandidatë. 30 % e kohës së dedikuar për aktivitetet e partive në pushtet është shpërndarë në favor të Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE me 1 orë dallim në disfavor të BDI. Sa i përket opozitës, më së shumti kohë i është ndarë Koalicionit të udhëhequr nga LSDM (1 orë, 35 minuta e 52 sekonda), pastaj PDSH-së (27 minuta e 6 sekonda) dhe KND-së (13 minuta e 29 sekonda).

Sipas Raportit për monitorimin e realizuar[119] mbi Radion Maqedonase - Servisi i Tretë Programor - Programi në Gjuhën Shqipe RM 3, koha e përgjithshme për aktivitetet e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor nuk është shpërndarë në mënyrë proporcionale me numrin e listave të verifikuara me kandidatë. Tek partitë në pushtet ka dallim në mbulimin sipas minutazhit. BDI-së, nga koha e parashikuar i është përkushtuar 1 orë 5 minuta e 8 sekonda në krahasim me Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE të cilit i janë përkushtuar vetëm 25 minuta e 17 sekonda. Koha e parashikuar për mbulimin e aktiviteteve të opozitës, gjithashtu nuk është shpërndarë në mënyrë adekuate, me ç'rast PDSH-së i janë përkushtuar 43 minuta kundrejt Koalicionit të udhëhequr nga LSDM të cilit i janë përkushtuar 32 minuta e 33 sekonda dhe "Koalicionit për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë" (KND) të cilit i janë përkushtuar 4 minuta e 20 sekonda.

Tabela 1: Përfaqësimi i subjekteve në zhanret informative (21 – 30 nëntor 2016)
Burimi: ASHMAAV

| | **RTM1** | | **RTM2 në gjuhën shqipe** | | **Radio maqedonase 1** | | **RM në gjuhën shqipe** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitetet e fushatave të partive politike në pushtet** | | | | | | | | |
| | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja |
| **VMRO-DPMNE etj.** | 01:16:25 | 51,05 % | 01:03:51 | 33,73 % | 01:46:08 | 69,98 % | 00:25:17 | 27,96 % |
| **BDI** | 01:13:16 | 48,95 % | 02:05:28 | 66,27 % | 00:45:32 | 30,02 % | 01:05:08 | 72,04 % |
| **Gjithsej** | 02:29:41 | 100 % | 03:09:19 | 100 % | 02:31:40 | 100 % | 01:30:25 | 100 % |
| **Aktivitetet e fushatave të partive politike në opozitë** | | | | | | | | |
| **LSDM etj.** | 01:02:18 | 41,05 % | 00:57:11 | 31,19 % | 01:35:52 | 70,26 % | 00:32:33 | 40,70 % |
| **PDSH** | 00:40:43 | 26,83 % | 01:48:33 | 59,21 % | 00:27:06 | 19,86 % | 00:43:05 | 53,88 % |
| **Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi** | 00:48:46 | 32,13 % | 00:17:35 | 9,59 % | 00:13:29 | 9,88 % | 00:04:20 | 5,42 % |
| **Gjithsej** | 02:31:47 | 100 % | 03:03:19 | 100 % | 02:16:27 | 100 % | 01:19:58 | 100 % |
| **Aktivitetet e fushatave të partive politike të cilat nuk janë në Kuvend** | | | | | | | | |
| **Partia Liberale** | 00:09:24 | 18,07 % | 00:02:20 | 3,31 % | 00:08:51 | 20,73 % | 00:02:57 | 8,72 % |
| **Levica** | 00:12:16 | 23,58 % | 00:02:27 | 3,47 % | 00:09:04 | 21,24 % | 00:00:34 | 1,68 % |
| **PPD** | 00:01:59 | 3,81 % | 00:17:22 | 24,62 % | 00:00:41 | 1,60 % | 00:03:48 | 11,24 % |

118 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – RM 1, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/MRA_prv_programs-ki_06.12.2016.pdf (vizita e fundit 7 janar 2017).

119 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – RMSH 1, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Makedonsko_ra-dio-tret_programski.pdf (vizita e fundit: 7 janar 2017).

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **BESA** | 00:06:48 | 13,07 % | 00:24:34 | 34,82 % | 00:02:43 | 6,36 % | 00:10:50 | 32,04 % |
| **Aleanca për Shqiptarët** | 00:07:54 | 15,19 % | 00:23:50 | 33,78 % | 00:03:08 | 7,34 % | 00:10:16 | 30,36 % |
| **VMRO për Maqedoninë** | 00:13:40 | 26,27 % | / | / | 00:18:14 | 42,72 % | 00:05:24 | 15,97 % |
| **Gjithsej** | 00:52:01 | 100 % | 01:10:33 | 100 % | 00:42:41 | 100 % | 00:33:49 | 100 % |

Në periudhën kohore nga 1 deri më 9 dhjetor të vitit 2016 u realizua edhe një monitorim mbi Serviset Programore të Radiotelevizionit Maqedonas. Ashtu si edhe në periudhën e parë, Servisi i Parë Programor RTM 1 siguroi shpërndarje të balancuar të kohës për fushatat dhe aktivitetet e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Në ato 30 % të dedikuara për aktivitetet e partive në pushtet në Raportin për monitorimin e realizuar[120] është vënë në dukje thuaja se shpërndarje e barabartë e kohës midis dy partive në pushtet - Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe BDI, përkatësisht 1 orë 8 minuta e 28 sekonda për Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe 1 orë 5 minuta e 31 sekonda për BDI. Tendencë të ngjashme ka edhe në mbulimin e aktiviteteve të partive në opozitë dhe të atyre të cilat nuk janë në Kuvend, me ç'rast është respektuar parimi i proporcionalitetit në përputhje me listat e kandidatëve.

Raporti për monitorimin e realizuar[121] mbi Servisin e Dytë Programor RTM 2, vë në dukje një disbalanc të caktuar sa i përket shpërndarjes së kohës sipas parimit të proporcionalitetit konform Kodit Zgjedhor. Partive në pushtet, RTM 2 u ka përkushtuar 1 orë 56 minuta dhe 15 sekonda për BDI dhe 59 minuta për Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Proporcion i njëjtë vërehet edhe gjatë mbulimit të aktiviteteve të partive/koalicioneve në opozitë, me ç'rast PDSH-së i është përkushtuar 1 orë 45 minuta e 13 sekonda, ndërsa Koalicionit të udhëhequr nga LSDM i janë përkushtuar 47 minuta e 30 sekonda,

[120] Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – RTM 1, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/MRT_1_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 7 janar 2017).

[121] Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – RTM 2, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/MRT_2_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 7 janar 2017).

ndërkaq Koalicionit për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë (KND) 22 minuta e 8 sekonda. Sa i përket kohës së përkushtuar partive të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvend, Koalicionit "Aleanca për Shqiptarët" i janë përkushtuar 21 minuta e 3 sekonda, Lëvizjes BESA - 30 minuta e 8 sekonda, ndërkaq shumë më pak kohë i është përkushtuar Partisë Liberale (1 minutë e 58 sekonda), Koalicionit "VMRO për Maqedoninë" (2 minuta e 11 sekonda) dhe PPD-së (9 minuta e 41 sekonda) të cilat kanë më shumë lista të kandidatëve. Koha më e madhe që u është përkushtuar partive të bllokut shqiptar, në këtë Raport sqarohet në bazë të rregullit për shpërndarje inverse të minutazhit për fushata zgjedhore nga "Rregullat e mbulimit mediatik të proceseve zgjedhore - për prezantim të balancuar politik", kapitulli

"Mbulimi i zgjedhjeve në lajme", ku është përcaktuar se duke i pasur parasysh specifikat e Servisit të Dytë Televiziv të RTM të dedikuar për mbulimin e nevojave informative të qytetarëve të bashkësive etnike joshumicë në Maqedoni, shpërndarja e kohës në lajme, midis pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, do të jetë në dobi të subjekteve politike nga bashkësitë jo-shumicë.

Sipas Raportit për monitorimin e realizuar[122] mbi Radion Maqedonase -Servisi i Parë Programor RM 1, gjatë periudhës kohore të monitorimit shumë më shumë kohë i është përkushtuar "ngjarjeve ditore nga vendi dhe bota", përkatësisht madje 39 %. Sa i përket minutazhit për aktivitetet e fushatave të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, Programi i Parë i Radios Maqedonase ka vendosur të zbatoj shpërndarje të balancuar midis dy grupacioneve komparative elektorale: nga njëra anë koalicionet e udhëhequra nga VMRO-DPMNE dhe LSDM të cilave u është përkushtuar 1 orë e 30 minuta; ndërsa nga ana tjetër BDI-së si pjesë e partive në pushtet i janë përkushtuar 36 minuta, kurse si pjesë të opozitës PDSH-së i janë përkushtuar 26 minuta dhe "Koalicionit për Ndryshime dhe Drejtësi" 19 minuta. Hapësira informative-ditore e dedikuar për partitë politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvend, sipas Raportit, nuk është respektuar plotësisht.

[122] Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – RM 1, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/MRA_1_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 7 janar 2017).

Të dhënat e Raportit për monitorimin e realizuar[123] mbi Radion Maqedonase - Servisi i Tretë Programor Programi në Gjuhën Shqipe RM 3 vë në dukje se RM3 kryesisht e ka respektuar shpërndarjen në përqindje të kohës midis aktiviteteve të partive në pushtet, të atyre në opozitë dhe të atyre të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvend. Nga ana tjetër, Raporti vuri në dukje se Servisi i Tretë Programor kryesisht është udhëhequr sipas rregullit për shpërndarje inverse të minutazhit për fushatat zgjedhore në përputhje me "Rregullat e mbulimit mediatik të procesit zgjedhor - për prezantim të balancuar politik", kapitulli "Mbulimi i zgjedhjeve në lajme". Sipas kësaj, partive të bllokut shqiptar në pushtet edhe në opozitë në masë të konsiderueshme u është përkushtuar më shumë kohë.

Tabela 2: Përfaqësimi i subjekteve në zhanret informative (1 – 9 dhjetor 2016)
Burimi: ASHMAAV

| | **RTM1** | | **RTM2 në gjuhën shqipe** | | **Radio maqedonase 1** | | **RM në gjuhën shqipe** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitetet e fushatave të partive politike në pushtet** | | | | | | | | |
| | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja |
| **VMRO-DPMNE etj.** | 01:08:28 | 51,10 % | 00:59:26 | 33,83 % | 01:30:54 | 71,51 % | 00:28:30 | 35,46 % |
| **BDI** | 01:05:31 | 48,90 % | 01:56:15 | 66,17 % | 00:36:13 | 28,49 % | 00:51:53 | 64,54 % |
| **Gjithsej** | 02:13:59 | 100 % | 02:55:41 | 100 % | 02:07:07 | 100 % | 01:20:23 | 100 % |
| **Aktivitetet e fushatave të partive politike në opozitë** | | | | | | | | |
| **LSDM etj.** | 00:52:52 | 39,97 % | 00:47:30 | 27,17 % | 01:30:34 | 66,43 % | 00:29:10 | 37,36 % |
| **PDSH** | 00:37:07 | 28,07 % | 01:45:13 | 60,18 % | 00:26:01 | 19,08 % | 00:43:18 | 55,47 % |
| **Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi** | 00:42:16 | 31,96 % | 00:22:08 | 12,66 % | 00:19:45 | 14,49 % | 00:05:36 | 7,17 % |
| **Gjithsej** | 02:12:15 | 100 % | 02:54:51 | 100 % | 02:16:20 | 100 % | 01:18:04 | 100 % |
| **Aktivitetet e fushatave të partive politike të cilat nuk janë në Kuvend** | | | | | | | | |
| **Partia Liberale** | 00:07:26 | 15,68 % | 00:01:58 | 2,93 % | 00:05:51 | 14,92 % | 00:00:56 | 3,06 % |
| **Levica** | 00:08:41 | 18,31 % | / | / | 00:03:37 | 9,23 % | 00:01:06 | 3,60 % |
| **PPD** | 00:02:52 | 6,05 % | 00:09:41 | 14,45 % | 00:01:07 | 2,85 % | 00:04:03 | 13,27 % |
| **BESA** | 00:09:03 | 19,09 % | 00:30:08 | 44,96 % | 00:03:54 | 9,95 % | 00:10:08 | 33,21 % |
| **Aleanca për Shqiptarët** | 00:07:39 | 16,13 % | 00:23:03 | 34,39 % | 00:03:03 | 7,78 % | 00:10:22 | 33,97 % |
| **VMRO për Maqedoninë** | 00:11:44 | 24,75 % | 00:02:11 | 3,26 % | 00:21:40 | 55,27 % | 00:03:56 | 12,89 % |
| **Gjithsej** | 00:47:25 | 100 % | 01:07:01 | 100 % | 00:39:12 | 100 % | 00:30:31 | 100 % |

[123] Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – RMSH, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/MRA_3_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 7 janar 2017).

## Monitorimi mbi mediat komerciale

Raportet e monitorimit të realizuar mbi mediat komerciale në periudhën kohore nga 21 nëntori deri më 9 dhjetor të vitit 2016 e përfshijnë raportimin mediatik në terminet e pikut të shikueshmërisë së emisioneve informative ditore gjatë fushatës zgjedhore. Raportet, të cilat veç e veç e analizojnë pjesën e parë (I) dhe pjesën e dytë (II) të fushatës zgjedhore, përkatësisht nga 21 deri më 30 nëntor dhe nga 1 deri më 9 dhjetor, vënë në dukje dallime midis mediave sa i përket raportimit mediatik elektoral.

Tabela 3: Përfaqësimi i subjekteve në zhanret informative (21 nëntor – 9 dhjetor 2016)
Burimi: ASHMAAV

| | **24 Vesti** | | **Alsat - M** | | **Alfa** | | **Kanal 5** | | **Sitel** | | **Telma** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **I** | **II** | **I** | **II** | **I** | **II** | **I** | **II** | **I** | **II** | **I** | **II** |
| **VMRO-DPMNE etj.** | 00:35:34 | 00:29:33 | 00:12:16 | 00:07:41 | 02:09:01 | 01:46:21 | 03:07:26 | 02:45:51 | 03:28:09 | 03:11:03 | 00:36:53 | 00:15:25 |
| **LSDM etj.** | 00:25:53 | 00:23:50 | 00:13:21 | 00:08:15 | 01:44:48 | 01:20:55 | 01:58:14 | 02:21:10 | 01:47:25 | 00:57:17 | 00:24:41 | 00:22:26 |
| **BDI** | 00:15:35 | 00:09:59 | 00:15:24 | 00:09:06 | 00:06:44 | 00:01:12 | 00:15:07 | 00:10:40 | 00:16:45 | 00:03:58 | 00:11:24 | 00:07:17 |
| **PDSH** | 00:04:01 | 00:04:39 | 00:15:15 | 00:09:16 | 00:03:22 | 00:00:17 | 00:12:58 | 00:01:53 | 00:01:58 | 00:05:08 | 00:10:09 | 00:08:52 |
| **VMRO për Maqedoninë** | 00:11:24 | 00:14:28 | 00:01:15 | / | 00:02:26 | / | / | 00:04:01 | / | / | 00:12:17 | 00:13:57 |
| **Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi** | 00:17:54 | 00:13:49 | 00:01:25 | / | 00:02:00 | 00:00:17 | / | 00:01:26 | / | / | 00:19:10 | 00:11:46 |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Partia Liberale** | / | 00:00:53 | / | / | 00:00:34 | / | 00:01:21 | / | 00:04:46 | 00:01:55 | 00:03:04 | 00:03:02 |
| **Levica** | / | 00:10:24 | / | / | 00:04:12 | 00:06:36 | / | 00:01:31 | 00:06:35 | 00:00:48 | 00:09:05 | 00:05:30 |
| **PPD** | / | / | / | / | / | / | 00:01:01 | / | / | / | 00:00:54 | / |
| **BESA** | 00:01:02 | 00:01:23 | 00:08:50 | 00:06:44 | 00:00:34 | / | / | / | / | / | 00:02:55 | 00:06:53 |
| **Aleanca për Shqiptarët** | 00:03:59 | 00:01:49 | 00:06:50 | 00:06:00 | 00:00:21 | 00:00:17 | / | / | / | / | 00:05:45 | 00:03:13 |

Në kuadër të edicioneve të analizuara të emisioneve informative ditore në pjesën e parë[124] të fushatës zgjedhore, Televizioni 24 Vesti[125] 1 orë 57 minuta dhe 40 sekonda ua ka përkushtuar pjesëmarrësve dhe kandidatëve në fushatën zgjedhore. Së këtejmi, koha e përkushtuar për raportimin e katër subjekteve politike me nga shtatë lista të kandidatëve është shpërndarë në atë mënyrë që Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE i është përkushtuar më shumë kohë (35 minuta e 34 sekonda), pastaj pason Koalicioni i udhëhequr nga LSDM (25 minuta e 53 sekonda), BDI (15 minuta e 35 sekonda) dhe Koalicionit "VMRO për Maqedoninë" (11 minuta e 24 sekonda). Nga ana tjetër, KND, i cili ka gjashtë lista të kandidatëve i janë përkushtuar 17 minuta e 54 sekonda, PDSH-së e cila ka pesë lista të kandidatëve i janë përkushtuar 4 minuta e 1 sekondë. Pjesëmarrësve në fushatë me katër lista të kandidatëve u janë përkushtuar: Koalicionit "Aleanca për Shqiptarët" - 3 minuta e 59 sekonda, Lëvizjes BESA - 1 minutë e 2 sekonda. Për PL, PPD dhe Levica nuk ka kontribute. Gjatë pjesës së dytë[126] të fushatës nga katër subjektet me nga shtatë lista të kandidatëve më së shumti kohë për raportim i është përkushtuar Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE (29 minuta e 33 sekonda), pason Koalicioni i udhëhequr nga LSDM (23 minuta e 50 sekonda), Koalicioni "VMRO për Maqedoninë" (14 minuta e 28 sekonda) dhe BDI (9 minuta e 59 sekonda), për KND janë raportuar 13 minuta e 49 sekonda. Partive me nga pesë lista të kandidatëve Televizioni 24 Vesti ua ka shpërndarë kohën në këtë mënyrë: Levica (10 minuta e 24 sekonda), PDSH 4 minuta e 39 sekonda) dhe PL (53 sekonda). Pjesëmarrësve në fushatë me nga katër lista të deputetëve u është shpërndarë koha në këtë mënyrë: Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" - 1 minutë e 49 sekonda dhe Lëvizja BESA 1 minutë e 23 sekonda.

Alsat-M në pjesën e parë[127] të fushatës zgjedhore minutazh të ngjashme u ka përkushtuar dy partive më të mëdha të bllokut maqedonas - Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE (12 minuta e 16 sekonda) dhe Koalicionit të udhëhequr nga LSDM (13 minuta e 21 sekonda), si dhe dy partive nga blloku shqiptar të përfaqësuara në Kuvend - BDI (15 minuta e 24 sekonda) dhe PDSH (15 minuta e 15 sekonda). Lëvizjes BESA i janë përkushtuar 8 minuta e 50 sekonda kundrejt 6 minuta e 50 sekonda për Koalicionin "Aleanca për Shqiptarët". KND dhe Koalicionit "VMRO për Maqedoninë" u është përkushtuar vetëm 1 minutë e 25 sekonda, përkatësisht 1 minutë e 15 sekonda. Për PL, Levica dhe PPD nuk ka kontribute. Pjesa e dytë[128] e fushatës zgjedhore shënon një shpërndarje të ngjashme të kohës për raportim, BDI-së dhe PDSH-së përsëri u është përkushtuar më shumë kohë, 9 minuta e 6 sekonda, përkatësisht 9 minuta e 16 sekonda, kundrejt kohës së përkushtuar Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe Koalicionit të udhëhequr nga LSDM, 7 minuta e 41 sekonda, përkatësisht 8 minuta e 15 sekonda. Lëvizjes BESA dhe Koalicionit "Aleanca për Shqiptarët" u është përkushtuar kohë e ngjashme, rreth 6 minuta. Për PL, Levica PPD, KND dhe Koalicionin "VMRO për Maqedoninë" nuk ka kontribute.

Në pjesën e parë[129] të fushatës zgjedhore kontributet e analizuara vënë në dukje se Televizioni Alfa për aktivitetet e pjesëmarrësve në fushatë ka raportuar 4 orë 14 minuta e 36 sekonda. Nga katër subjektet me nga shtatë lista të kandidatëve Televizioni Alfa më shumë kohë i ka përkushtuar Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE (2 orë 9 minuta e 1 sekondë), pastaj Koalicionit të udhëhequr nga LSDM (1 orë

---

124 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – 24 Vesti, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/24_Vesti_06.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

125 Shpërndarja e kohës informative për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit sipas numrit të listave të verifikuara me kandidatë për deputetë.

126 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – 24 Vesti, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/24_Vesti_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

127 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – Alsat-M, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Alsat_06.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

128 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – Alsat-M, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Alsat-M_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

129 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – Alfa, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Alfa_06.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

44 minuta 48 sekonda), BDI (6 minuta 44 sekonda) dhe Koalicionit "VMRO për Maqedoninë" (2 minuta e 26 sekonda). KND me gjashtë lista të kandidatëve i janë përkushtuar 2 minuta. Nga partitë me nga 5 lista të kandidatëve gjatë raportimit Levica-s i janë përkushtuar (4 minuta e 12 sekonda), PDSH (3 minuta e 22 sekonda) dhe PL (34 sekonda). Lëvizjes BESA dhe Koalicionit "Aleanca për Shqiptarët" të cilat kanë nga katër lista të kandidatëve u janë përkushtuar 34 sekonda, përkatësisht 21 sekonda). Për PPD nuk ka informacione. Në pjesën e dytë[130] të fushatës Televizioni Alfa u ka përkushtuar 3 orë 15 minuta e 55 sekonda aktiviteteve të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore dhe përsëri minutazh më të gjatë i ka përkushtuar Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE (1 orë 46 minuta e 21 sekonda), pasta Koalicionit të udhëhequr nga LSDM (1 orë 20 minuta e 55 sekonda), Levica 6 minuta e 36 sekonda), BDI (1 minutë e 12 sekonda) dhe PDSH, KND dhe Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" 17 sekonda. Për katër pjesëmarrës në fushatën zgjedhore nuk ka kontribute edhe atë për Koalicionin "VMRO për Maqedoninë", PL, PPD dhe Lëvizjen BESA.

Nga ana tjetër TV Kanal 5, minutazh dominant i ka përkushtuar mbulimit të fushatës së VMRO-DPMNE dhe Koalicionit në të dyja periudhat e monitorimit. Në kuadër të kontributeve të analizuara në pjesën e parë[131] të fushatës zgjedhore, nga gjithsej 5 orë 36 minuta e 7 sekonda të përkushtuara aktiviteteve të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, 3 orë 7 minuta e 26 sekonda i janë përkushtuar Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE kundrejt 1 orë 58 minuta e 14 sekonda të përkushtuara Koalicionit të udhëhequr nga LSDM. Partive tjera u është përkushtuar minutazh shumë më i vogël, ndërsa për aktivitetet e KND, Levica, Koalicionit "VMRO për Maqedoninë", Lëvizjes BESA dhe Koalicionit "Aleanca për Shqiptarët" nuk ka kontribute. Tendencat janë të ngjashme edhe në pjesën e dytë[132] të fushatës zgjedhore, me ç'rast aktiviteteve të pjesëmarrësve në fushatë u janë përkushtuar 5 orë 26

130 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – Alfa, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Alfa_TV_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

131 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – TV Kanal 5, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/TV_KAnal_5_06.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

132 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – TV Kanal 5, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Kanal_5_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

minuta e 32 sekonda. Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE i janë përkushtuar 2 orë 45 minuta e 51 sekonda, Koalicionit të udhëhequr nga LSDM - 2 orë 21 minuta e 10 sekonda, BDI - 10 minuta e 40 sekonda, Koalicionit "VMRO për Maqedoninë" 4 minuta e 1 sekondë, ndërsa për Levica, PDSH dhe KND më pak se 2 minuta. Nuk ka të dhëna për PL, PPD, Lëvizjen BESA dhe Koalicionin "Aleanca për Shqiptarët".

Raporti për raportimin mediatik elektoral të TV SItel në të dyja periudhat[133] e monitorimit vë në dukje disbalancë të konsiderueshme gjatë shpërndarjes së kohës konform parimit të proporcionalitetit. Kështu që, Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE i është përkushtuar bindshëm më shumë kohë, përkatësisht 3 orë 28 minuta e 9 sekonda, në pjesën e parë dhe 3 orë 11 minuta e 3 sekonda në pjesën e dytë të përfshirë me monitorimin. Kundrejt kësaj, Koalicionit të udhëhequr nga LSDM i është përkushtuar vetëm 1 orë 47 minuta e 25 sekonda, në pjesën e parë, përkatësisht 57 minuta e 17 sekonda në pjesën e dytë. Për partitë dhe koalicionet e tjera TV Sitel ka raportuar me një minutazh tepër të ulët. Në të dyja rastet nuk ka kontribute për KND, Koalicionin "VMRO për Maqedoninë", PPD, Lëvizjen BESA dhe Koalicionin "Aleanca për Shqiptarët".

Kontributet e analizuara në pjesën e parë[134] të fushatës vënë në dukje se TV Telma kohën për katër subjektet me nga shtatë lista të kandidatëve e ka shpërndarë në këtë mënyrë: Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE i ka përkushtuar 36 minuta e 53 sekonda, Koalicionit të udhëhequr nga LSDM i ka përkushtuar 24 minuta e 41 sekonda, BDI-së i ka përkushtuar 11 minuta e 24 sekonda dhe Koalicionit "VMRO për Maqedoninë" ka përkushtuar 12 minuta e 17 sekonda. KND-së gjatë kësaj periudhe raportimi i janë përkushtuar 19 minuta e 10 sekonda. Është raportuar edhe për tre pjesëmarrësit me nga pesë lista të kandidatëve, PDSH-së i janë përkushtuar 10 minuta e 9 sekonda, Levica - 9 minuta e 5 sekonda, PL - 3 minuta e 4 sekonda. Koalicionit

133 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – TV Sitel, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/TV_Sitel_06.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017). Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – TV Sitel, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Sitel_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

134 Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 21 – 30 nëntor 2016 – Telma, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Telma_06.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

"Aleanca për Shqiptarët" i janë përkushtuar 5 minuta e 45 sekonda ndërsa Lëvizjes BESA i janë përkushtuar 2 minuta e 55 sekonda.

PDSH-së i janë përkushtuar vetëm 54 sekonda. Në pjesën e dytë[135] të fushatës, katër subjekteve me nga shtatë lista të kandidatëve më shumë kohë gjatë raportimit i është përkushtuar aktiviteteve të Koalicionit të udhëhequr nga LSDM - 22 minuta e 26 sekonda, pastaj Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE - 15 minuta e 25 sekonda, Koalicionit "VMRO për Maqedoninë" - 13 minuta e 57 sekonda dhe BDI-së 7 minuta e 17 sekonda. KND-së i janë përkushtuar 11 minuta e 46 sekonda. Partive me nga 5 lista të kandidatëve në periudhën e raportimit u është përkushtuar: PDSH (8 minuta e 52 sekonda), Levica (5 minuta e 30 sekonda) dhe PL (3 minuta e 2 sekonda). Pjesëmarrësve në fushatë me nga katër lista të deputetëve u është shpërndarë koha në këtë mënyrë: Lëvizjes BESA - 6 minuta e 53 sekonda dhe Koalicionit "Aleanca për Shqiptarët" - 3 minuta e 13 sekonda.

## REZULTATET E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË VITIT 2016[136]

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat u mbajtën më datë 11 dhjetor 2016, të drejtën e votës e shfrytëzuan gjithsej 1,191,852 votues nga 1,784,524 votues të regjistruar në Maqedoni dhe 20,629 votues jashtë vendit. Dalja në këto zgjedhje ishte 66,79% e që vë në dukje rritje në krahasim me zgjedhjet e kaluara parlamentare të vitit 2014 kur dalja ishte 63%.

Në këto zgjedhje morën pjesë gjithsej gjashtë parti politike dhe pesë koalicione me gjithsej 58 lista të kandidatëve, edhe atë, Koalicioni "Për një Maqedoni më të Mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, partia politike BDI, PDSH, Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë, partia PPD, Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët", PL, Koalicioni "VMRO për Maqedoninë", Lëvizja BESA dhe Levica.

Sipas të dhënave përfundimtare dhe zyrtare të KSHZ, më së shumti vota në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 11 dhjetor 2016 fitoi Koalicioni "Për një Maqedoni më të Mirë", i udhëhequr nga partia në pushtet VMRO-DPMNE ose 454,577, e që është 38,14% nga numri i përgjithshëm i votave. Kështu që Koalicioni fitoi 51 mandate deputetësh ose 10 mandate më pak se në zgjedhjet e kaluara parlamentare.

Në vendin e dytë është Koalicionit i udhëhequr nga partia opozitare LSDM e cila fitoi 17,596 vota më pak se partia në pushtet VMRO-DPMNE, përkatësisht gjithsej 436,981, e që është 36,66% nga numri i përgjithshëm i votave. Koalicioni fitoi 49 mandate të deputetëve kundrejt 34 mandateve të fituara në zgjedhjet e kaluara parlamentare. Kjo është hera e parë që në zgjedhjet parlamentare të zhvillohet një betejë kaq e ngushtë midis dy partive më të mëdha të bllokut maqedonas.

Në vendin e tretë është BDI, e cila deri më tani ka qenë pjesë e koalicionit qeverisës. Për listat e kandidatëve të saj kanë votuar 86,796 votues, e që është 7,28 % nga numri i përgjithshëm i votave, me çka fituan 10 deputetë në Kuvend. Në këto zgjedhje BDI fitoi mbështetje dukshëm më të vogël nga votuesit në krahasim me zgjedhjet parlamentare në vitin 2014 kur fitoi 19 mandate.

Në vendin e katërt, sipas numrit të fituar të votave, është Lëvizja BESA e cila në këto zgjedhje fitoi gjithsej 57,868 vota ose 4,86%. BESA për herë të parë do të përfaqësohet në përbërjen e re parlamentare të Kuvendit të RM edhe atë me 5 deputetë.

Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" gjendet në vendin e pestë, sipas numrit të votave të fituara. Për listat e kandidatëve të koalicionit votuan 35,121 votues, e që është 2,95% e numrit të përgjithshëm të votave. Koalicioni fitoi 3 mandate dhe për herë të parë do të ketë deputetë të vet në Kuvend.

[135] Raport me shkrim për mbikëqyrjen (monitorimin) e realizuar) 1 – 9 dhjetor 2016 – Telma, ASHMAAV. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Telma_16.12.2016.pdf (vizita e fundit: 10 janar 2017).

[136] Për të gjitha të dhënat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare është përdorur internet faqja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. E aksesshme në: https://rezultati.sec.mk/Parliamentary/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1&eu=All&m=All&ps=All (vizita e fundit: 29 dhjetor 2016).

Në vendin e gjashtë gjendet rivali më i madh i BDI, PDSH, e cila në këto zgjedhje arriti një rezultat konsiderueshëm më të dobët. Për këtë parti votuan 30,964 votues ose 2,60% nga numri i përgjithshëm i votave dhe fitoi vetëm 2 mandate në krahasim me 7 mandatet të cilat i fitoi në zgjedhjet paraprake parlamentare.

Partitë dhe koalicionet e tjera, përkatësisht Koalicioni "VMRO për Maqedoninë, Levica, KND - Blloku i Tretë, PL dhe PPD, nuk arritën të sigurojnë vende deputetësh në legjislaturën e re të Kuvendit. Për Koalicionin "VMRO për Maqedoninë" votuan 24,524 votues (2,06%), për Levica 12,120 votues (1,02%), për KND - Blloku i Tretë 10,028 votues (0,84%), për PL 3,840 votues (0,32%) dhe për PPD 1,143 votues (0,10%).

Në këto zgjedhje asnjë parti dhe koalicion nuk arriti të fitojë vota të mjaftueshme në NJZ 7 në mënyrë që të sigurojë deputet nga diaspora në Kuvend.




Sipas njësive zgjedhore raporti i partive/koalicioneve të cilat siguruan hyrje në Kuvend është, si vijon:

| Njësia zgjedhore | Votues të regjistruar në Listën e Zgjedhësve | Parti/ Koalicion | Gjithsej vota | Gjithsej vota % | Mandate të fituara |
|---|---|---|---|---|---|
| **NJZ 1** | 295 858 | LSDM e të tjerë | 92 247 | 42,35 % | 10 |
| | | VMRO-DPMNE e të tjerë | 72 842 | 33,44 % | 8 |
| | | BESA | 11 597 | 5,32 % | 1 |
| | | BDI | 12 890 | 5,92 % | 1 |
| Dalja | **217 823 (73,62 %)** | | | | |
| **NJZ 2** | 306 471 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 73 712 | 36,15 % | 9 |
| | | LSDM e të tjerë | 69 842 | 34,25 % | 8 |
| | | BDI | 16 868 | 8,27 % | 2 |
| | | BESA | 16 119 | 7,90 % | 1 |
| Dalja | **203 923 (66,54 %)** | | | | |
| **NJZ 3** | 280 727 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 102 829 | 50,36 % | 11 |
| | | LSDM e të tjerë | 81 204 | 39,77 % | 9 |
| Dalja | **204 193 (72,74 %)** | | | | |
| **NJZ 4** | 282 537 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 101 617 | 47,96 % | 10 |
| | | LSDM e të tjerë | 94 780 | 44,73 % | 10 |
| Dalja | **211 897 (75,00 %)** | | | | |
| **NJZ 5** | 290 433 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 72 340 | 38,51 % | 9 |
| | | LSDM e të tjerë | 71 020 | 37,81 % | 9 |
| | | Aleanca për Shqiptarët | 7 355 | 3,92 % | 1 |
| | | BDI | 13 982 | 7,44 % | 1 |
| Dalja | **187 824 (64,67 %)** | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **NJZ 6** | 307 817 | BDI | 40 547 | 25,67 % | 6 |
| | | VMRO-DPMNE e të tjerë | 26 193 | 16,58 % | 4 |
| | | BESA | 24 989 | 15,82 % | 3 |
| | | LSDM e të tjerë | 25 986 | 16,45 % | 3 |
| | | Aleanca për Shqiptarët | 17 946 | 11,36 % | 2 |
| | | PDSH | 16 162 | 10,23 % | 2 |
| Dalja | **157 960 (51,32 %)** | | | | |
| **NJZ 7** | 20 573 | VMRO-DPMNE e të tjerë | 5 044 | 61,27 % | / |
| | | LSDM e të tjerë | 1 902 | 23,10 % | / |
| | | BDI | 886 | 10,76 % | / |
| | | VMRO për Maqedoninë | 157 | 1,91 % | / |
| Dalja | **8 232 (40,01 %)** | | | | |

## MBROJTJA E TË DREJTËS SË ZGJEDHJES[137]

Kodi Zgjedhor e garanton mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes. Sipas Kodit Zgjedhor, çdo parashtrues i listës së kandidatëve dhe çdo zgjedhës ka të drejtë të paraqes kundërshtim deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nëse konsideron se e drejta e tyre është cenuar. Kundërshtimet, nga ana e parashtruesve të listave, mund t'i referohen procedurës së votimit, përmbledhjes dhe përcaktimit të rezultateve, ndërsa zgjedhësit mund të paraqesin kundërshtim nëse gjatë procedurës u është cenuar e drejta e zgjedhjes. Procedura e cila zhvillohet lidhur me të drejtën e zgjedhjes është urgjente, prandaj dhe paraqitja e kundërshtimit dhe padisë nuk mund të dërgohet me postë.

137 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), versioni jozyrtar i përpiluar nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/izboren-zakonik/ (vizita e fundit: 19 tetor 2016); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142 nga data 1 gusht 2016. I aksesshëm në: http://www.avmu.mk/images/Zakon_za_izmenuvanje_i_dopolnuvanje_na_izborniot_zakonik_28_juli_2016.pdf (vizita e fundit: 19 tetor 2016).



Kundërshtimet, të cilat parashtruesit e listave i paraqesin deri te KSHZ doemos duhet t'i paraqesin në afat prej 48 orësh, pas përfundimit të votimit, përkatësisht pas shpalljes së rezultateve preliminare, ndërkaq KSHZ e ka për detyrë në afat prej 48 orësh, pas pranimit të kundërshtimit, të merr vendim. Për vendimin të cilin e ka marrë, KSHZ e njofton parashtruesin e kundërshtimit përmes postës elektronike, ndërsa vendimi konsiderohet i dërguar në afat prej pesë orësh nga dërgimi përmes postës elektronike. Parashtruesi i kundërshtimit, për të cilin në kuadër të KSHZ është marrë vendim negativ, ka të drejtë në afat prej 24 orësh, pas pranimit të aktvendimit, të paraqes padi deri te Gjykata Administrative. Gjykata doemos duhet të miratoj vendim në afat prej 48 orësh pas pranimit të padisë. Gjykata Administrative mund ta konfirmoj ose ta modifikoj vendimin e KSHZ, me ç'rast vendimet e saj janë të plotfuqishme, përkatësisht kundër tyre nuk mund të paraqitet ankesë ose lloj tjetër i mbrojtjes juridike.

Në rast të cenimit të të drejtës së zgjedhjes të zgjedhësit, i njëjti mund të paraqes kundërshtim deri te KSHZ në afat prej 24 orësh, ndërsa KSHZ e ka për detyrë të miratoj vendim në afat prej 4 orësh pas pranimit të kundërshtimit. Vendimi i KSHZ mund të ankimohet, kështu që brenda 24 orësh, pas pranimit të aktvendimit, do të paraqes padi deri te Gjykata Administrative. Nëse afatet rrjedhin dhe mbivendosen gjatë procesit të votimit, ndërsa vendimi është pozitiv për zgjedhësin, të njëjtit do t'i mundësohet ta realizoj të drejtën e tij të votës.

Në kuadër të afatit ligjor partitë/koalicionet politike deri te KSHZ paraqitën gjithsej 16[138] kundërshtime. Një pjesë e kundërshtimeve kanë të bëjnë me procedurën e votimit, ndërsa një pjesë tjetër me procedurën e sublimimit dhe përcaktimit të rezultateve. Kundërshtime paraqitën LSDM dhe Lëvizja BESA. Lëvizja BESA paraqiti gjithsej 8 kundërshtime. Dy kundërshtime ishin për NJZ 6, përkatësisht për vendin zgjedhor (VZ): 1995, 1996, 1997, 1997/1, 1999, 2080, 2081 dhe 2083 në Komunën Tetovë dhe për VZ 0396/1 në Komunën Gostivar. Tetë kundërshtimet e tjera u paraqitën për NJZ 2 edhe atë për VZ 2333/1, VZ 2340 dhe VZ

138 Ky është numri preliminar. Pastaj LSDM vendosi t'i tërheqë dy kundërshtimet e paraqitura paraprakisht, kinse me shpjegimin se kundërshtimet nuk kanë mundur të kontribuojnë në ndryshimin e rezultatit zgjedhor. Në këtë mënyrë numri i kundërshtimeve të shqyrtuara është 14.

2339 në Komunën e Haraçinës, për VZ 1119/1 dhe 1120 dhe VZ 1105 në Komunën Likovë dhe për Komunën e Gazi Babës. LSDM paraqiti 8 kundërshtime për votimin në NJZ 6. Pesë kundërshtime ishin paraqitur për VZ në Komunën Tearcë, përkatësisht për VZ: 2011, VZ 2010, VZ 2025, VZ 2024 dhe VZ 2016 në Komunën e Tearcës. Tre kundërshtimet e tjera kishin të bëjnë me VZ 1978, VZ 1984 dhe VZ 1983 në Komunën e Tetovës. Pas paraqitjes së kundërshtimeve LSDM vendosi t'i tërheq dy kundërshtimet e veta, përkatësisht për VZ 1984 dhe VZ 1983.

Mbledhja e KSHZ, në të cilën vendosej për kundërshtimet zgjati tri ditë. Pas shqyrtimit të kundërshtimeve KSHZ i hodhi poshtë të gjitha kundërshtimet e LSDM, ndërsa e pranoi vetëm një kundërshtim të Lëvizjes BESA edhe atë për parregullsi në VZ 0396/1 në Komunën e Gostivarit. Paraprakisht, nga BESA deklaruan se për kundërshtimet nuk do të paraqesin asnjë padi deri te Gjykata Administrative për shkak të mospasjes besim ndaj institucioneve.[139] Menjëherë, pas kësaj, VMRO-DPMNE, si udhëheqëse e Koalicionit "Për një Maqedoni më të Mirë" paraqiti padi deri te Gjykata Administrative kundër aktvendimit të KSHZ me të cilin merret në konsideratë kundërshtimi i Lëvizjes BESA për VZ 0396/1 në Komunën e Gostivarit. Gjykata Administrative e mori në konsideratë padinë e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe me këtë e hodhi poshtë kundërshtimin e Lëvizjes BESA.

Koalicioni i udhëhequr nga LSDM nuk ishte i kënaqur nga vendimet e KSHZ për vendet zgjedhore në NJZ 6, me ç'rast në kuadër të afatit ligjor paraqiti tri padi deri te Gjykata Administrative. Gjykata Administrative tri paditë e LSDM i refuzoi si të pabazuara, ndërsa e mori në konsideratë padinë e paraqitur për VZ 2011 në Komunën e Tearcës dhe vendosi ta anuloj votimin në këtë vend zgjedhor. Si rezultat i këtij vendimi, KSHZ miratoi Aktvendim[140] për përsëritjen e votimit dhe mbajtjen e tij më datë 25 dhjetor 2016, përkatësisht 14 ditë nga dita e votimit.

Vendimi për rivotim hapi mundësi për ndryshimin e rezultateve të zgjedhjeve, për faktin se Koalicionit të udhëhequr nga LSDM i mungonin

139 LSDM paraqiti padi, BESA bojkotoi, VMRO-DPMNE mendohet, "24 vesti", 26 dhjetor 2016. I aksesshëm në: http://24vesti.mk/sdsm-podnesuva-tuzhbi-besa-bojkotira-vmro-dpmne-se-misli-0 (vizita e fundit: 30 dhjetor 2016).

140 Aktvendim, KSHZ, 21 dhjetor 2016. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zRWR1Sms1c3R0Mk0/view (vizita e fundit: 20 dhjetor 2016).



303 vota në NJZ 6 për të fituar edhe një mandat shtesë. Në votimin e datës 11 dhjetor në këtë vend zgjedhor fitoi VMRO-DPMNE me 91 vota të fituara, ndërsa LSDM me 87 vota të fituara. Në rivotimin e datës 25 dhjetor në VZ 2011 në Tearcë fitoi LSDM me 245 vota të fituara kundrejt 149 votave për VMRO-DPMNE. Megjithatë, edhe përkrah fitores së LSDM, rezultati zgjedhor nuk ndryshoi. Në këtë mënyrë, shpërndarja fillestare 51- 49 deputetë për VMRO-DPMNE, përkatësisht për LSDM mbeti e njëjtë.

## VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE NGA VËZHGUESIT

Për monitorimin e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të 11 dhjetorit 2016 u akredituan gjithsej 7,605 vëzhgues vendor, 642 vëzhgues të huaj, 354 përkthyes dhe 98 gazetarë të huaj.[141] Nga organizatat vendore në këto zgjedhje, një numër më të madh të vëzhguesve pati Asociacioni Qytetar MOST, përkatësisht 3,599. Shoqata për Aktivitete Humanitare SINERGJIA Shtip ishte misioni i dytë vëzhgues më i madh sa i përket numrit, me gjithsej 3,387 vëzhgues. Organizatat e tjera patën numër më të vogël të vëzhguesve të akredituar. Kështu, CIVIL - Qendra për Liri pati 308 vëzhgues, Shoqata Qendra Nacionale Rome (QNR) - Kumanovë kishte 143 vëzhgues, Instituti për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare Ohër 65 vëzhgues, Qendra Maqedonase për Kulturë dhe Zhvillim 52 vëzhgues dhe Qendra për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional Shkup - QMBI 51 vëzhgues.

Nga misionet vëzhguese të huaja në numër më të madh ishte Misioni i OSBE/ODIHR me 281 vëzhgues. Ambasada e Shteteve të Bashkuara kishte 51 vëzhgues, Asambleja Parlamentare e OSBE 27 vëzhgues, Misioni i OSBE në Shkup 24 vëzhgues, Asociacioni i Strukturave Studentore Evropiane – AEGEE Evropa - 24, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës 22 vëzhgues, Bashkimi Evropian dhe dhe Parlamenti Evropian – 16 vëzhgues. Nga 15 vëzhgues patën: Këshilli për Diplomaci Publike i Katalonisë - Diplokat, Qendra Ndërkombëtare e Studimit të Zgjedhjeve - Lituani dhe SILBA - Mbështetja e Iniciativës për Dialog dhe Demokraci -

141 Shih: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Zgjedhje të parakohshme për deputetë 11.12.2016, Vëzhgues të akredituar. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zR1FiS21IaTgwMlU/view (vizita e fundit: 03 janar 2017).

Danimarkë. Ambasada e Britanisë në Shkup kishte 12 vëzhgues, Ambasada e Francës 6, ndërsa Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë, Italia dhe Republika e Shqipërisë - 6 vëzhgues. Nga 2 vëzhgues patën secila nga ambasadat e Zvicrës, Austrisë dhe Republikës Çeke.

Procesin zgjedhor e monitoruan gjithsej 98 gazetarë të huaj. Në numër më të madh ishte ekipi i rrjetit televiziv Al Xhezaira Ballkan me 16 gazetarë. Pastaj vijon Radio Televizioni Shtetëror i Turqisë TRT me 8 gazetarë, RTV 21 Prishtinë me 7, Radio Televizioni i Kosovës me 6, Top Chanel Tirana dhe Agjencia Botërore Rojters patën nga 5 gazetarë.

Radio Televizioni i Serbisë, ENG - Shoqata për Lajme Elektronike Greqi, TV Klan Kosovë dhe TV KTV Koha Vizion - Republika e Kosovës kishin nga 4 gazetarë. Nga 2 gazetarë patën ORF - Austri, TV i Parë dhe B92 - Republika e Serbisë, Radio Televizioni i Vojvodinës, Zëri i Amerikës. Nga 1 gazetar patën ARD Televizioni Shtetëror i Gjermanisë, Radio Televizioni i Sllovenisë, Agjencia Evropiane Presfoto, Agjencia Pixsell – Republika e Kroacisë, Agjencia Gazetareske BETA PRES Serbi.

Në raportin e vet preliminar nga monitorimi, Misioni i OSBE/ODIHR[142] konstatoi se dita e zgjedhjes kaloi qetë dhe pa incidente të mëdha dhe me dalje të madhe të votuesve. U vlerësua pozitivisht edhe publikimi i rezultateve preliminare sipas njësive zgjedhore në ueb-faqen e KSHZ gjatë natës pas zgjedhjeve. Megjithatë, krahas vlerësimit pozitiv nga ana e vëzhguesve, në procesin zgjedhor u vërejtën parregullsi të caktuara procedurale, para së gjithash gjatë numërimit të votave. Një problem tjetër ishte numri i madh i personave të cilët ishin fshirë nga Lista e Zgjedhësve gjatë zbatimit të kontrollit të regjistrit të zgjedhësve dhe për këtë shkak këtyre qytetarëve nuk iu mundësua që në ditën e zgjedhjeve ta japin votën e tyre. Në ditën e zgjedhjeve u vërejtën raste të votimit grupor, frikësimit të votuesve, ndërhyrjes së personave të paautorizuar në punën e KZ (Këshilla Zgjedhor), vulosja joadekuate e kutive të votimit. Sa u përket KKZ (Komisionet Komunale të Zgjedhjeve) është vërejtur mospasja e hapësirës së mjaftueshme për punë, organizimit të keq, por edhe prezencës së turmës së madhe të njerëzve. Vërejtje plotësuese për më shumë se gjysmën e vendeve të monitoruara të votimit është mosekzistimi i kushteve për qasje të pavarur të votuesve me handikap. Ndërkaq, gjatë fushatës zgjedhore, janë regjistruar edhe raste të kryerjes së presionit mbi votuesit dhe familjet e tyre, kryerjes së presionit mbi nëpunësit shtetërorë, keqpërdorimit të resurseve administrative, blerjes së votave në komunitetin rom.

Vëzhguesit e OSBE, votimin e parakohshëm e vlerësuan në përgjithësi si pozitiv, pa incidente dhe tensione të më të mëdha. Disa probleme procedurale u vërejtën gjatë kohës së votimit të parakohshëm, më datë 7 dhjetor, në INK "Idrizovë" në lidhje me rastet e votuesve me letërnjoftime të vlefshme të cilëve nuk iu mundësua të votojnë për shkak se emrat e tyre nuk kanë qenë në Listën e Zgjedhësve. Përveç kësaj, mbi 500 të burgosur me letërnjoftime të skaduara nuk kanë qenë të regjistruar në Listën e Zgjedhësve. Në këtë kontekst, nga Misioni i OSBE gjithashtu, u potencua se nuk ekziston procedurë se si mund të vazhdohet afati i letërnjoftimeve të skaduara për të burgosurit.

Sipas raportit të OSBE/ODIHR, periudha parazgjedhore kaloi në atmosferë të respektimit të lirive themelore të pjesëmarrësve për bashkim, tubim, shprehje dhe zhvillim të lirë të fushatës zgjedhore. Megjithatë, nga Misioni theksojnë se procesi në përgjithësi është zhvilluar në atmosferë të mosbesimit të publikut në institucione dhe në rregullimin politik. Është vërejtur edhe përdorimi i retorikës negative, veçanërisht midis Koalicionit të VMRO-DPMNE dhe Koalicionit të udhëhequr nga LSDM. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, për të cilin zgjedhjet ishin referendum për shtet unitar dhe sovran, drejtuan akuza ndaj Koalicionit të udhëhequr nga LSDM se e dobëson identitetin nacional të Maqedonisë. Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, gjithashtu drejtoi akuza ndaj Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE të cilat kryesisht kishin të bënin me keqpërdorimin e autorizimeve shtetërore dhe zbatimin e aktiviteteve kriminale. Intensitet dhe retorikë e ngjashme është vërejtur edhe midis partive të bllokut shqiptar të cilat i drejtoheshin bashkësisë së tyre. Gjatë fushatës zgjedhore janë regjistruar incidente të dhunshme

142 Misioni Vëzhgues Ndërkombëtare i Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, Republika e Maqedonisë, Zgjedhje të parakohshme parlamentare, 11 dhjetor 2016, Deklaratë për të dhënat preliminare dhe konkluzionet. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/288296?download=true (vizita e fundit: 03 janar 2017).

siç është vandalizmi mbi shtabet e partive, dëmtimi i automobilave të anëtare partiak, bilbordeve të shkatërruar.

Sa i përket punës së KSHZ, disa nga vërejtjet kryesore ishin zvogëlimi i nivelit të transparencës së aktivitetit të tij. indikator për këtë ishte mbajtja e mbledhjeve me dyer të mbyllura, si dhe publikimi jo i rregullt i vendimeve të KSHZ në ueb-faqen e tij. Problem shtesë, i cili u regjistrua gjatë vëzhgimit ishte njëanshmëria e anëtarëve të KSHZ gjatë miratimit të vendimeve. Kështu, vëzhguesit kanë vërejtur se vendimmarrja për çështje kontestuese është bërë sipas linjave dhe interesave partiake nga ana e vet anëtarëve. Njëanshmëria gjatë vendimmarrjes është shfaqur si problem edhe në raste të tjera. Për shembull, gjatë përcaktimit të rendit të listave të kandidatëve në fletëvotimet përmes shortit, listat janë ndarë në dy grupe, me ç'rast vendet e para të fletëvotimeve u janë ndarë katër partive parlamentare të përfaqësuara në përbërjen e KSHZ - Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, BDI dhe PDSH. Veprimi i këtillë konsiderohet si diskriminues në raport me kandidatët e tjerë në procesin zgjedhor dhe rrjedhimisht me këtë është në kundërshtim me nenin 7.6 të Dokumentit të Kopenhagës[143] të OSBE nga viti 1990 dhe, para së gjithash, me standardet e Këshillit të Evropës.

Raportimi i mediave është edhe një aspekt i cili u mbulua nga Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR. Rezultatet e vëzhgimit e vunë në dukje ndarjen politike dhe etnike të skenës mediatike, si dhe dallimin sa i përket mbulimit mediatik nga ana e mediave publike dhe nga ana e disa mediave private. Së këtejmi, dy kanalet televizive publike RTM 1 dhe RTM 2 pjesëmarrësve, në procesin zgjedhor u mundësuan prezantim të balancuar, pozitiv dhe jokritik në lajme. Nga ana tjetër, tek disa mediume private, si *Sitel, Kanal 5* dhe *Alfa* hapësira mediatike është ndarë kryesisht midis VMRO-DPMNE dhe LSDM. Tek këto tri televizione, vëzhguesit kanë vërejtur raportim të pa-balancuar dhe të njëanshëm ndaj partisë në pushtet në llogari të partive opozitare. *Telma, Alsat-M* dhe 24 *Vesti* në emisionet informative kanë siguruar mbulim të shumëllojshëm dhe shpeshherë edhe kritik të pjesëmarrësve kryesorë në procesin zgjedhor. Misioni, po ashtu, ka vërejtur shqetësim për vetë-censurë dhe për mungesë të pavarësisë redaktuese tek mediat, për shkak të interesave politike dhe biznes-interesave të pronarëve. Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 2015 ndalohet reklamimi i financuar nga Qeveria dhe mbulimi i aktiviteteve të funksionarëve shtetërorë mbështetës të partive të caktuara politike gjatë zgjedhjeve, megjithatë, krahas kësaj janë vërejtur aktivitete të këtilla gjatë fushatës zgjedhore. Gjithashtu, nga vëzhguesit e OSBE u theksua se reformat e caktuara esenciale mediatike, të parashikuara me Marrëveshjen e Përzhinos, akoma nuk janë implementuar plotësisht.

Asociacioni Qytetar MOST[144] vlerësoi se në ditën e zgjedhjeve është vërejtur dalje e madhe e votuesve, por edhe parregullsi në procedurën e votimit dhe raste të incidenteve për ryshfet dhe presioneve mbi votuesit në disa vende zgjedhore. Gjithashtu, vëzhguesit e MOST kanë regjistruar edhe raste të votimit grupor/familjar, mosrespektim të fshehtësisë së votimit, fotografim të fletëvotimeve pas paravanëve, zgjedhës të cilët nuk kanë qenë të regjistruar në Listën e Zgjedhësve. Fushata zgjedhore është vlerësuar si mjaft dinamike, por me tone të shtuara negative dhe me retorikë më të ashpër. Edhe kësaj radhe keqpërdorimi i çështjeve ndëretnike ishte lartë në agjendën e pjesëmarrësve. Gjatë fushatës janë kryer presione mbi të punësuarit në sektorin publik për të qenë të pranishëm në mitingjet partiake, por edhe për t'ia dhënë votën e tyre partisë në pushtet. Po ashtu, është vërejtur edhe prezenca e funksionarëve në ngjarje të ndryshme partiake gjatë kohës së punës, keqpërdorim i resurseve publike, siç është përdorimi i automjeteve zyrtare për qëllime partiake, gjithashtu edhe raste të kundërligjshme të vënies në dispozicion të mjeteve buxhetore në formën e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objektit të financuar me mjete publike.

Ambasadori[145] i SHBA në Maqedoni, Xhes Bejli, gjithashtu, sikurse edhe OSBE/ODIHR, zgjedhjet i vlerësoi si të mira, me disa parregullsi procedurale. Në deklaratën e tij ai i bëri thirrje qeverisë së ardhshme

143 Dokumenti i Kopenhagës i OSBE nga viti 1990. I aksseshëm në: http://www.osce.org/odihr/elections/14304?download=true (vizita e fundit: 03 janar 2017).

144 Zgjedhjet Parlamentare 2016, Asociacioni Qytetar MOST. I aksesshëm në: http://www.most.org.mk/index.php?option=com_k2&view=itemlist&task=category&id=160:parliamentary-elections-2016&Itemid=326&lang=mk (vizita e fundit: 04 janar 2017).

145 Bejli për zgjedhjet: Anëtarësimi në BE dhe NATO është faktor bashkimi, NOVA TV, 12 dhjetor 2016. I aksesshëm në: http://novatv.mk/bejli-za-izborite-chlenstvo-to-vo-eu-i-nato-e-obedinuvachki-faktor/ (vizita e fundit: 04 janar 2017).

që edhe më tej të punojë në ndërtimin e kapaciteteve të KSHZ, por edhe t'i zgjidh çështjet juridike dhe strukturore sa i përket Listës së Zgjedhësve. Për Ambasadorin Bejli zgjedhjet e muajit dhjetor janë vetëm një hap që çon në drejtim të zgjidhjes së krizës, prandaj, ai u bën thirrje të gjitha partive, ato të cilat do të jenë në Qeveri dhe ato që do jenë në opozitë, së bashku të bashkëpunojnë dhe t'i realizojnë reformat e domosdoshme për integrimin euroatlantik të shtetit. Edhe për Euroambasadorin në Maqedoni, Samuel Zhbogar[146], zgjedhjet ishin të suksesshme, me ç'rast qytetarët patën mundësi ta shprehin vullnetin e tyre. Sipas tij, Parlamenti i ardhshëm dhe Qeveria e re do të duhej të vazhdonin me zbatimin e reformave të cilat janë të domosdoshme për ta çuar vendin përpara në rrugën euroatlantike.

## VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE NGA PARTITË POLITIKE

Më datë 11 dhjetor, disa orë pas mbylljes së vendvotimeve, numri i votave fillimisht të numëruara tregoi se zhvillohet betejë e ngushtë midis partisë në pushtet VMRO-DPMNE dhe partisë më të madhe opozitare LSDM. Rezultatet e këtilla ishin shkak që dy partitë më të mëdha të bllokut maqedonas të dalin me interpretime të ndryshme për rezultatet e zgjedhjeve dhe para kohe të shpallen për fituese të zgjedhjeve. Shtabi i LSDM u mbyll për një kohë të shkurtër, ndërsa anëtarët dhe simpatizuesit e partisë bashkërisht u drejtuan para objektit të Qeverisë ku e festonin fitoren. Pas pak iu drejtua lideri i LDSM, Zoran Zaev, i cili deklaroi: "Jini të lumtur dhe krenarë. E shkruat historinë. Do të keni çfarë t'u thoni fëmijëve dhe nipërve. Unë krenohem me ju. Maqedonia është vend krenar, vend i lumtur... I presim rezultatet, por trendi vetëm mund të rritet dhe jo të bie. Prandaj, gëzohuni, regjimi u rrëzua, fitoi jeta.[147] Megjithatë, edhe krahas kënaqësisë së mënyrës në të cilën votuan qytetarët dhe vullnetit për ndryshim, nga LSDM theksuan se në ditën e zgjedhjeve ka pasur edhe raste të presioneve, frikësimeve dhe blerjes së votave.[148]

146 Zhbogar: Marrëveshja e Përzhinos solli zgjedhje të suksesshme, Indeks 24, 15 dhjetor 2016. I aksesshëm në: http://index24.mk/index.php/vesti/makedonija/item/4602-zhbogar-przhinskiot-dogovor-donese-uspeshni-izbori (vizita e fundit: 04 janar 2017).
147 Mbrëmë VMRO-DPMNE dhe LSDM shpallën fitore dhe filluan të festojnë, Alsat M, 12 dhjetor 2016. I aksesshëm në: http://alsat.mk/News/299502/sinokja-vmro-i-sdsm-proglasija-pobedi-i-pochnaa-da-slavat (vizita e fundit: 22 dhjetor 2016).
148 Rezultatet dihen, pasiguria vazhdon, Radio Evropa e Lirë, 12 dhjetor 2016. I aksesshëm në: http://www.slobodnaevropa.mk/a/28171268.html (vizita e fundit: 22 dhjetor 2016).



Pas kësaj, shumë shpejtë VMRO-DPMNE thirri pres konferencë në të cilën Vllatko Gjorçev, njëri nga bartësit e listave, iu drejtua qytetarëve maqedonas, e komunikoi fitoi e VMRO-DPMNE dhe i thirri të gjithë të festojnë para shtabit të partisë. Gjorçev, gjithashtu, shtoi se zgjedhjet kanë qenë të ndershme, demokratike, transparente dhe inkluzive, si dhe thirri për bashkim dhe për përfundim të krizës.[149] Gjysmë ore pas mesnate u drejtua edhe lideri i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski, i cili partinë e tij e shpalli fituese në zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe njëkohësisht iu falënderua të gjithë qytetarëve të cilët dolën të votojnë në këto zgjedhje dhe atyre të cilët e kanë mbështetur partinë e tij. Sipas Gruevskit, mbështetja për partinë e tij ka qenë në kuadër të kufijve të pritshme. Fakti se Zaev ka fituar mbështetje edhe nga elektorati shqiptar është diçka të cilën partia në mënyrë plotësuese do ta shqyrtojë dhe do të nxjerrë mësim.[150]

Pavle Trajanov nga Lidhja Demokratike dhe Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi - Blloku i Tretë deklaroi se zgjedhjet treguan ndarje jashtëzakonisht të madhe midis vet qytetarëve, përkatësisht shumica prej rreth 612.000 qytetarë të cilët e kanë dhënë votën e tyre për ndonjërën nga partitë opozitare. Sipas Trajanovit, edhe këto zgjedhje nuk kaluan pa kërcënime, presione dhe klientelizëm të partive në pushtet. Ai thirri që në vend që kriza të thellohet edhe më tej, në një formë të protestave dhe presioneve mbi KSHZ, menjëherë pas rezultateve përfundimtare të konstituohet përbërja e re e Parlamentit me qëllim që të formohet shumica parlamentare e përbërë nga partitë dhe deputetët të cilët janë për ndryshime.[151]

Nga Koalicioni "VMRO për Maqedoninë" pas zgjedhjeve u paraqit edhe Stojançe Angellov, kryetar i "Dostoinsvto" i cili në fejsbuk profilin e tij shkroi se edhe krahas faktit se Koalicioni i tyre i humbi zgjedhjet,

149 Gjorçev: VMRO-DPMNE feston fitoren e zgjedhjeve, mandatar Nikolla Gruevski, Vest, 13 dhjetor 2016. I aksesshëm në: http://www.vest.mk/?ItemID=F503192513609A45B807E8910FAB7BA4&arc=1 (vizita e fundit: 22 dhjetor 2016).
150 Kush është fituesi i zgjedhjeve - pyetje për një milion dollar!, Dojçe Vele, 12 dhjetor 2016. I aksesshëm në: www.dw.com/mk/кој-е-победник-на-изборите-прашање-од-милион-долари/a-36730641 (vizita e fundit: 22 dhjetor 2016).
151 Lidhja Demokratike: Shoqëri e ndarë, Lidhja Demokratike, 15 dhjetor 2016. I aksesshëm në: http://www.demokratskisojuz.org.mk/vesti-ns_article-demokratski-sojuz-podeleno-opshtestvo.nspx (vizita e fundit: 22 dhjetor 2016).

megjithatë ka fituar vota të mjaftueshme për t'u imponuar si një opsion i tretë politik në Maqedoni. Angellov shtoi se edhe përkrah rezultatit të këtillë, pas këtyre zgjedhjeve në Maqedoni asgjë nuk do të jetë e njëjtë. Iu falënderua të gjithë qytetarëve të cilët kanë dalë në votime, si dhe atyre të cilët kanë votuar për Koalicionin "VMRO për Maqedoninë.[152] Po ashtu, ai potencoi se partitë e vogla vështirë do të mund të siguronin hyrje në Kuvend përderisa Maqedonia është e ndarë në më shumë njësi zgjedhore. Megjithatë, pavarësisht se kusht do ta krijonte Qeverinë e re, sipas Angellov, do të ishte pashmangshme kriza e thellë politike në Maqedoni.[153]

Dejan Lutovski, anëtar i Presidiumit të Levica, në ueb faqen e partisë shkruan se edhe në këto zgjedhje, mekanizmat e presionit dhe shantazheve ndaj trupit votues kanë luajtur rol të konsiderueshëm. Gjithashtu, ai shtoi se duke i pasur parasysh mjetet minimale financiare me të cilat është prezantuar partia në këto zgjedhje, si dhe me numrin e madh të kufizimeve me të cilat janë ballafaquar si parti, numri i votave të fituara të partisë është në nivel të pranueshëm edhe krahas pritshmërive për rezultat më të mirë dhe mandate të fituara për hyrje në Kuvend.[154]

Në bllokun shqiptar, qëndrimet e partive ishin të ndryshme. Për liderin e BDI, Ali Ahmeti, partia e tij është fituese në mesin e partive shqiptare. Sipas Ahmetit, zgjedhjet kanë kaluar qetë dhe pa probleme e që njëherësh ka qenë shenjë se vendi ka bërë progres të madh dhe ka treguar pjekuri për sa i përket organizimit të zgjedhjeve. Megjithatë, Ahmeti nuk e fshehu zhgënjimin dhe pakënaqësinë për shkak të mandateve të humbura, të cilat për të paraqesin vetëm humbje për shqiptarët, ndërkaq edhe një herë aludoi tek elektorati shqiptar të mos parcializohet në grupe të vogla por të jetë i bashkuar.[155]

152 Fejsbuk profil i Stojançe Angellov. I aksesshëm në: https://www.facebook.com/stojance.angelov?fref=ts (vizita e fundit: 26 dhjetor 2016).
